



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

T R A N S K R I P T

I MBLEDHJES PLENARE TË KUVENDIT TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS, TË
MBAJTUR MË 28 PRILL 2011

SA PLENARNE SEDNICE SKUPŠTINE REPUBLIKE KOSOVA, ODRŽANE
28. APRILA 2011. GODINE

PRILL – APRIL
2011

E enjte, 28.04. 2011, ora 10:00

Drejton seancën: Kryetari i Kuvendit të Kosovës, zoti Jakup Krasniqi

KRYETARI: Të nderuar deputetë,
I nderuar zëvendëskryeministër, ministra prezentë,
I nderuari kryeministër, që erdhe me vonesë,

I hap punimet e mbledhjes plenare të Kuvendit të Republikës së Kosovës.
Vazhdojmë me pikën e parë të rendit të ditës:

1. Koha për deklarime jashtë rendit të ditës

Në pajtim me nenin 47 të Rregullores së Kuvendit, koha për diskutime jashtë rendit të ditës është e kufizuar në 30 minuta. Diskutimet në emër të grupit parlamentar zgjatin deri në 5 minuta, ndërsa diskutimet e deputetëve deri në 3 minuta.

Në emër të Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike, fjalën e ka kërkuar kryetari i Grupit, Ismet Beqiri.

ISMET BEQIRI: I nderuar zoti kryetar i Kuvendit,
Të nderuar kolegë deputetë,

Unë, në emër të Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike të Kosovës shpreh shqetësimin tim për vazhdimin e veprimeve të paligjshme të Qeverisë dhe të zotit Thaçi. Vendimi i Qeverisë, i djeshmi, për ndryshimin e trasesë pa e paraqitur në Kuvend të Kosovës, dëshmon edhe një herë që zoti Thaçi konsideron që Kosova është pronë private e tij dhe mund të bëjë çfarë të dojë edhe me trase, edhe me projekte, të cilat e kanë obligim si Qeveri t'i qesë në Kuvend, për miratim. Lëre që nuk dihet edhe sot çmimi i autostradës, as traseja, por tash ajo gjatë rrugëtimit të saj po devijohet kah po ka dëshirë zoti Thaçi. Arsyeimi se kursehen 350 milionë euro duhet të vërtetohet në këtë Kuvend. Së pari do të duhej të dihej çmimi, pastaj të dihet traseja saktë kah ka qenë e paraparë të shkojë, e pastaj të bëhen kalkulime të tilla dhe ky Kuvend ta thotë fjalën e vet, sepse është organ kompetent.

Zoti kryetar i Parlamentit,

Mendoj që ky injorim që po i bëhet Kuvendit dëshmon edhe një herë ose, më mirë të themi, sikur po hymë në dilemë se s'di pse ekziston Kuvendi i Kosovës, kur Qeveria është, sipas tyre, edhe Qeveri, edhe Kuvend dhe bën me projekte të tilla madhore kombëtare çfarë të dojë dhe çfarë t'i teket. Thënë thjeshtë, nëse vazhdohet në këtë mënyrë, unë nuk e besoj që deri në përfundim të projektit traseja ka për të mbetur e njëjta, sepse si ia ka krijuar vetit mundësinë zoti Thaçi, ka për ta ndërruar kah t'i teket. Ajo që ne konsiderojmë, nuk po bisedojnë për komuna kah i bie traseja, por po problemi është i procedurave, i respektimit të organit më të lartë, në këtë rast, shtetëror, ligjdhënës, siç është Kuvendi i Kosovës.

Prandaj, e konsiderojmë një vendim të tillë të paligjshëm, të papërgjegjshëm dhe kërkojmë që ky projekt i autostradës të vijë në Kuvend të Kosovës dhe për të gjitha

çështjet të bisedohet këtu dhe të merret vendim, sepse është organi kompetent i caktuar me Kushtetutë që për vendimet e tilla të marrë vendim.

Prandaj, zoti kryetar, unë ju lus që ju të përdorni autoritetin tuaj dhe të kërkonit nga Qeveria e papërgjegjshme që për vendime të tilla të respektojë organin kompetent. Përndryshe, ne edhe me këtë rast, edhe njëherë e përsërisim atë që e keni thanë për të satën herë, se vazhdon një punë jo transparente, një punë e cila absolutisht s'ka lidhje me përgjegjësinë dhe përgjegjshmërinë në punën e tyre. Së këndejmi, e ngrejë shqetësimin dhe kjo s'ka të bëjë as me komuna, e as me qytetarë të pjesëve të caktuara, por ka të bëjë me mos respektimin e ligjit, të ligjshmërisë dhe të asaj që e përcakton Kushtetuta dhe Rregullorja e Punës së Kuvendit të Kosovës.

Sikundër që, në kontest të kësaj po e them, nëse vazhdohet kështu edhe me zgjerim të kabinetit, ne do të bëhemi qeveri e cila do të na ketë lakmi edhe shteti më i madh në botë me këtë numër megaloman që po vazhdon. Edhe kjo është pjesë e një vazhdimi të një papërgjegjësie të kësaj Qeverie dhe të zotit Thaçi. Faleminderit!

KRYETARI: Më vonë mund ta merrni fjalën, po urdhëro, merre fjalën! Më vonë ka qenë më mirë.

KRYEMINISTRI HASHIM THAÇI: Faleminderit, i nderuar kryetar Krasniqi!

KRYETARI: Regjia, minutat ndalen tani, minutat për deputetë nuk ia marrim kohën!

KRYEMINISTRI HASHIM THAÇI: Të nderuar zëvendëskryeministra, Kabinet qeveritar,

Të nderuar deputetë,

Unë e dëgjova me vëmendje qëndrimin e shefit të Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike të Kosovës, zotit Ismet Beqiri. Mendoj se ajo çka është me rëndësi, është se autostrada apo projekti i vullnetit dhe ëndrra e qytetarit të Kosovës po implementohet në tërësi, ai i ndërtimit të autostradës Vërmicë – Merdare, do të thotë autostrada “Ibrahim Rugova”. Është shqetësuese qëndrimi i juaj i vazhdueshëm kundërshtues ndaj ndërtimit të kësaj autostrade dhe unë e kam theksuar edhe më herët, e ritheksoj edhe sot, unë e kam një vendlindje, një atdhe, ajo është Kosova dhe për mua çdo cep i territorit të Kosovës është atdheu im dhe jo vetëm mëhalla, fshati apo lokaliteti prej nga vjen një deputet i caktuar.

Të sqaroj para qytetarëve, para së gjithash, dhe juve deputetë të nderuar, se ky është projekti më transparent i mundshëm në rajon dhe ky projekt po implementohet para kohe, pikërisht falë qeverisjes së mirë, sundimit të ligjit, transparencës maksimale dhe bashkëpunimit të ngushtë të Qeverisë së Kosovës dhe konzerciumit Behtel & Enka. E ritheksoj edhe një herë se nuk ka qenë i lehtë fillimi i kësaj autostrade dhe është dashur punë e madhe, në veçanti para se të fillohet të punohet, por autostrada ka filluar, është vullneti i qytetarëve të vendit, është e vërtetë ka qenë premtimi i imi elektorale dhe ndihem shumë krenar që ai projekt po realizohet dhe do të përmbyllet në Merdare. Të tri

seksionet e para janë duke u përmbyllur para kohe, 3 muaj seksioni i parë, i dyti gjithashtu dhe 11 muaj seksioni i tretë, ndërsa i katërti ka filluar punimet.

Unë në vend të kritikave dhe kundërshtisë, juve kolegë të nderuar të LDK-së, ju ftoj dhe të gjithëve ta vizitoni këtë projekt madhështor që do t'i jep dinjitet dhe krenari secilit prej neve.

Prandaj, Qeveria e Kosovës do të vazhdojë me projektet e tyre, projektet tona të cilat janë shumë të rëndësishme, është projekt i zhvillimit ekonomik, të rritjes së mirëqenies sociale të qytetarëve, projekt i integritimeve kombëtare, i tejkalimit të kufijve rajonal dhe i integritimeve euro-atlantike.

Kuvendi i Kosovës kurrë nuk ka marrë vendim për këtë autostradë. Vendimi për këtë autostradë ka qenë premtimi im elektorale, ka qenë vendimi i Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe sot po implementohet.

Prandaj, vendimet janë të Qeverisë së Kosovës transparente plotësisht para të gjithë qytetarëve të vendit. E kemi theksuar edhe më herët dhe gjithçka është studiuar mirë prej ekspertëve vendorë dhe atyre ndërkombëtarë edhe sa i përket kostos. E kam theksuar edhe më herët se nuk do të kursejmë asgjë për ndërtimin e kësaj autostrade, por garantoj edhe një herë se çdo centë do të jetë transparente, siç ka qenë edhe marrëveshja. Por, jam i gatshëm për debat kur ju dëshironi, qoftë për aeroportin, qoftë për autostradën, qoftë për autostradën Vërmicë – Merdare, qoftë për autostradën e re që do të fillojë së shpejti prej aeroportit në drejtim të Ferizajt, Kaçanikut deri në Shkup, qoftë për projekte të tjera të privatizimit të Brezovicës apo të fillimit të punimeve për “Kosovën e re” dhe projekteve të tjera madhore.

Prandaj, dëshiroj të theksoj edhe një herë se me vendimin e djeshëm të Qeverisë së Kosovës që autostrada të kalojë nga Qafa e Dulës në drejtim të Orllatit, lidhja e magjistrale Prishtinë – Pejë kursehen 350 milionë euro, ndërsa do t'i kemi 7 minuta më tepër për të udhëtuar dhe për shtetin tonë të ri 350 milionë euro nuk janë luks, por janë nevojë dhe kërkesë e qytetarëve të Kosovës për të investuar në projektet e tjera.

Të jeni të bindur dhe i siguroj qytetarët e Kosovës se nuk ka qenë e lehtë të vazhdohet ky projekt, në veçanti kur u rritën edhe rrogat për 50% për mësuesit, 40% për policët, 30% për shërbyesit civilë, 30% për punëtorët e shëndetësisë, për zjarrfikësit, 50% për familjet e dëshmorëve, për invalidët e luftës, natyrisht jo për dezertet. Prandaj, dëshiroj të theksoj se gjërat janë duke shkuar në drejtim të duhur, prandaj jam i gatshëm kur dëshironi të diskutojmë për autostradën Vërmicë – Merdare dhe për të gjitha projektet që ju mendoni që janë të nevojshëm por, ju lutem, mos i kundërshtoni, se janë në interesin e të gjithëve. Faleminderit!

(Ndërhyrje nga salla)

KRYETARI: Shikoni, ju e dini, lexojeni Rregulloren, nenin 47 dhe 48 dhe e keni të qartë!

Në emër të Grupit Parlamentar të “Vetëvendosjes”, deputeti Rexhep Selimi e ka fjalën.

(Ndërhyrje nga salla)

KRYETARI: Nuk ka pasur, po ia dhamë fjalën.

REXHEP SELIMI: I nderuar kryetar,
Të nderuar deputetë të zgjedhur të Parlamentit të Kosovës,

Janë dy tema që unë dua t’i trajtoj sot këtu, dy tema që kanë shumë të përbashkëta. Njëra ka të bëjë me Policinë multietnike të Mitrovicës dhe tjetra ka të bëjë me Policinë speciale të EULEX-it.

Të përbashkëta kanë: urdhëresat për dhunë, mbiemrin speciale, aktualitetin, mllëfin antishqiptar, dhunën kundër atyre që duan sport e festë, respektivisht liri e demokraci, shkeljen e rregullave profesionale dhe etike e tjera.

Qytetarëve të Kosovës iu rikthye edhe një herë skena e tmerrshme kur policët serbë i rrahnin ata kur festonin, kur këndonin dhe kur luanin.

Kështu ndodhi në njërën nga netët e javës së kaluar, këtu në Prishtinë, në palestrën sportive pas ndeshjes basketbollistike Prishtina – Bambi, kur tifozët “Plisat” u dhunuan nga Njësia mbështetëse operative nga Mitrovica, si njësi multietnike, e njohur edhe dikur si RSU.

Kjo njësi, e kërkuar me urdhërese të veçantë nga niveli më i lartë i Policisë së Kosovës, që të sillet nga Mitrovica në Prishtinë, me dijeni edhe të udhëheqjes politike, gjegjësisht të Mistrisë së Punëve të Brendshme, u përdor qëllimshëm kundër tifozëve “Plisat”, të cilët po e festonin fitoren e ekipit të tyre.

Kjo ndërhyrje dhe urrejtje e disa policëve serbë e çka do qofshin ata, në kuadër të NjMO-s nga Mitrovica, e sidomos e urdhërdhënësve të tyre eprorë kundër tifozëve “Plisat” dhe të rinjve shqiptarë, sa është e pakuptueshme, si fakt, po aq është edhe e padurueshme, si dhunë.

Për më shumë, këtë ngjarje dhune dhe tmerri në Shtëpinë e Sportit e bën më irituese dhe neveritëse edhe reagimi i njeriut me përgjegjës për këtë dhunë, ministrit të Brendshëm në Qeverinë e Kosovës, zotit Bajram Rexhepi, i cili i fajëson “Plisat” duke deklaruar që, citoj: “Tifozët kanë qenë të dhunshëm” me ç’rast ka shtuar se “do të hetohet nëse”, e theksoj, “nëse Policia i ka tejkaluar kompetencat e saj kur ka vepruar”. Ai dhunën

policore e quan veçse veprim, kurse “Plisat” praktikisht i shpall fajtor para çfarëdo hetimi.

Lëvizja “Vetëvendosje” kërkoi publikisht që ministri Rexhepi të japë dorëheqje për shkak të kësaj ngjarjeje dhe për shkak të këtyre deklaratave të papërgjegjshme, mirëpo ai u kundërpërgjigj me fjalët se atij i hyjnë dhe i dalin fjalët në trurin e tij pa lënë fare gjurmë. Kjo veç se tregon karakterin injorant dhe të papërgjegjshëm të këtij ministri. Ai, në vend që të jetë i shqetësuar se u rrahën brutalisht të rinjtë shqiptarë, në vend që të reflektojë së paku me keqardhje për ngjarjen e cila fyen duke përdhosur flamurin shqiptar në tribuna sportive, në vend që t’i vijë keq për gjithë ata të rinj që padrejtësisht u dhunuan nga policia e tij, në vend që t’ju kërkojë falje atyre të cilëve ua ka borxh sigurinë, dhe tek e fundit në vend që të ofrojë dorëheqje së paku morale, ai pa fije keqardhje e fyen intelektin dhe shpirtin e tyre sportdashës, duke i dënuar ata paraprakisht.

Prandaj, edhe njëherë, në emër të Grupit Parlamentar të lëvizjes “Vetëvendosje”, në emër të gjithë atyre të rinjve që u dhunuan nga urdhrat politikë mbi Policinë e Kosovës dhe në emër të gjithë atyre që u ndien keq kur panë skena të tilla dhune ndaj të rinjve shqiptarë duke u dhunuar dhe duke u maltretuar, kërkojmë me ngulm që të vihen para përgjegjësisë dhe para drejtësisë të gjithë ata që e shkaktuan këtë dhunë të shfrenuar etnike mbi të rinjtë shqiptarë, duke filluar nga ushtruesit e drejtpërdrejtë të dhunës policore, nga urdhërdhënësit e tyre të drejtpërdrejtë në zinxhirin komandues dhe duke përfunduar te ministri i Brendshëm.

Për ministrin e Punëve të Brendshme kërkojmë përgjegjësi dhe dorëheqje, së paku morale. Nëse jo, na falni, nëse e paskemi gabuar adresën e kërkesave tona për përgjegjësi dhe moral.

Tema e dytë, ka të bëjë me vendimin apo emërimin e komandantit rumun mbi Forcat e Policisë Speciale të EULEX-it.

Lëvizja “Vetëvendosje” reagon ashpër ndaj këtij emërimi të kolonelit rumun, si komandant i Njësisë speciale të EULEX-it.

Lëvizja “Vetëvendosje” e kundërshton praninë e EULEX-it në Kosovë, sepse ai nuk jep përgjegjësi para popullit të Kosovës, shkel të drejtat e tij demokratike dhe sovranitetin e Kuvendit të Republikës.

Derisa kreu i misionit të EULEX-it është përgjegjës për veprime disiplinore ndaj personelit të EULEX-it, në këtë rast është vendi i tyre, Rumania, ajo që mban të drejtën

për ndërmarrjen e çfarëdo veprimi ndaj personelit që e ka deleguar këtu. Bashkimi Evropian është duke kërkuar nga ne që të kemi besim tek një zyrtar që i jep llogari vetëm Qeverisë rumune. Ne kemi përvojë të hidhur me këtë lloj llogaridhënieje. Për më tepër, Bashkimi Evropian ka emëruar si shef të Policisë speciale të EULEX-it një përfaqësues të një pjese të shteteve anëtare të BE-së që as nuk e njohin pavarësinë tonë.

Lidhur me këtë, ne i kemi shkruar letër baroneshës Catherine Ashton, nga e cila kemi kërkuar që ky vendim të anulohet...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYETARI: Faleminderit! Koha është e juaja, edhe një minutë!

REXHEP SELIMI: Lidhur me këtë ne i kemi shkruar letër baroneshës Catherine Ashton, nga e cila kemi kërkuar që ky vendim të anulohet, ndërsa Qeveria rumune të bashkëpunojë me OKB-në në një hetim të pavarur të krimeve të kryera më 10 shkurt 2007, dhe në gjykimin e policëve specialë që janë autorë të këtij krimi.

Pra, këto dy tema që i trajtuam sot, përveç se kanë shumë të përbashkëta, e kanë edhe një të përbashkët tjetër. Të përbashkët e kanë dhe do ta kenë gjithmonë reagimin e vendosur të lëvizjes “Vetëvendosje” në mbrojtje të të drejtave të qytetarëve të Kosovës, në mbrojtje të vlerave tona njerëzore e kombëtare, në mbrojtje të jetëve tona, qoftë kur UNMIK-u apo rumunët apo kushdo tjetër vrasin të rinjtë shqiptare që duan vetëvendosje dhe demokraci. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit!

A ka në emër të grupit ndonjë të interesuar, në emër të grupit kush nuk e ka shfrytëzuar? Në emër të grupit, deputeti Daut Haradinaj e ka fjalën.

DAUT HARADINAJ: Faleminderit, i nderuar kryetar!

Fillimisht desha t’i them kryeministrit që nuk po flasim kundër autostradës, por po i tregojmë që je kah e çon Merdarë – Orllat dhe jo siç e tha më herët, dhe nëse është transparente, është transparente vetëm për atë dhe Kabinetin e tij dhe jo për qytetarët e Kosovës. Nuk e di a e kanë pa njerëzit, hala domethënë nuk e kemi parë ne. Të paktën, mendoj që kryeministri e ka për detyrë t’i informojë qytetarët se çka ka në atë kontratë.

Por, unë e kam një temë tjetër, e kam për varrezat e Koshares, kryetar, ke qenë personalisht edhe i ke parë vetë në çfarë gjendje janë, por unë do ta lexoj atë çka e mendoj unë në emër të grupit parlamentar.

Në këtë pranverë po bëhen 12 vjet prej se Kosova e gëzon lirinë. Nuk do të ishte e tepërt po që se me këtë rast do t'i kujtonim vuajtjet dhe vullnetin, punën dhe djersën, plagët dhe gjakun, martirët dhe heronjtë, mijëra e mijëra vajza e djem, motra e vëllezër që dhanë çdo gjë për lirinë tonë. T'i kujtonim edhe ata të cilët akoma nuk i kemi gjetur dhe që janë të zhdukur. Në këto 12 vjet të pasluftës ne kemi qenë dhe, për fat të keq, ende jemi dëshmitarë të shumë e shumë dështimeve në realizimin e ëndrrës së të rëndëve tanë. Ka pasur përparime dhe ecje, por është një fakt që e shohim dhe e prekim çdo ditë gjithë andej nëpër Kosovë. Shkaku u mungesës së lidërshiptit dhe vizionit, në Kosovë edhe sot e kësaj dite shkelen vlerat e luftës dhe amaneti i të rëndëve tanë. Zakonisht dhe jo rrallë për këtë mungesë lidërshipti dhe pune konkrete për të kujtuar të kaluarën, për të punuar për të ardhmen apo edhe për të ndërtuar të ardhmen, faji u hidhet edhe miqve tanë ndërkombëtarë. Po le të jemi të sinqertë dhe të mos i ikim as vetes, as të tjerëve. Shumë gjëra, prej atyre më të voglave e deri tek më të mëdhatë, mund dhe duhet të bëhen edhe pa miqtë tanë ndërkombëtarë. Ata jo vetëm që nuk na pengojnë, por jam i bindur që edhe do të na ishin mirënjohës po që se e marrim përsipër vetë t'i kryejmë shumë punë pa këshillat, vendimin e tyre.

Më lejoni që me këtë rast të shtroj vetëm një çështje, e cila është e dhimbshme, por është edhe krenare. Në Koshare, në kufirin shqiptaro- shqiptar, në vendin e ..., një popull i tërë para 12 vitesh shikonte me ethe dhe gëzim për sukseset e luftës dhe ecjen përpara në aspiratën tonë kombëtare, edhe sot e kësaj dite janë trupat e 114 të rënëve, të motrave dhe vëllezërve tanë dhe të 3 vullnetarëve të tjerë të cilët iu bashkuan luftës tonë për liri nga popuj tjerë liridashës, të cilët ranë për atë që ne sot të jemi këtu, që fëmijët tanë ta gëzojnë lirinë dhe të ëndërrojnë si të gjithë bashkëmoshatarët e tyre nëpër gjithë Evropën. Atje kufirin ndarës midis shqiptarëve e rrëzuan trimat që nuk njohën ndarjen nuk njohën kufi. Mos ndërtimi, mos kujdesia e shtetit tonë për varrezat e këtyre dëshmorëve në Koshare duhet të rëndojë ndërgjegjen tonë, duhet t'i skuq nga turpi të gjithë bartësit e institucioneve të shtetit tonë që i lanë ata dëshmorë në baltë e në dhe, në pluhurin e harresës.

Me këtë rast apeloj dhe kërkoj që ne si parlamentar, në përgjithësi, dhe pa dallim partie, por edhe Qeveria, në veçanti, të marrë masa urgjente jo vetëm për ngritjen dhe mirëmbajtjen e varrezave për të rënë në Koshare, por edhe për ngritjen e një trupi koordinues dhe drejtues, i cili në mënyrë të përhershme permanente do të mirëmbante dhe do t'i kujdesej për të rënë tanë, e në mënyrë të veçantë për komplekset memoriale, siç është Jasharajt, siç është Reçaku, siç është Kosharja, sepse kjo është nderi dhe krenaria jonë.

Për fund, një vend i cili nuk përkujdeset për vlerat e luftës, për të rënë për liri, nuk mund dhe nuk do të ketë as të ardhme. Andaj, është detyrimi yni moral e kombëtarë, politik e njerëzor që t'i kujtojmë me dinjitet dhe t'u japim vendin e merituar atyre që dhanë shumë për ne. Këtë punë, këtë detyrë duhet ta nisim nga këtu dhe pa humbur kohë, për këtë edhe jemi të mandatar. Po e them këtë, pa dashur ta fyej askënd, por si një njeri që bashkëndiej me të gjithë ata që i kanë dhënë vëllezërit dhe motrat e tyre pikërisht në Koshare. Ju faleminderit, zoti kryetar!

KRYETARI: Faleminderit!

A ka të tjerë në emër të grupit? Urdhëro, Bekim Haxhiu e ka fjalën, në emër të Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike.

BEKIM HAXHIU: I nderuar kryetar,

I nderuar kryeministër, Kabinet qeveritar,

Të nderuar deputetë,

Flas në emër të grupit parlamentar,

Të nderuar deputetë,

Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike, në seancën e fundit, në fillim të saj ka parashtruar një iniciativë për nxjerrjen e një rezolute me qëllim të dënimit të të gjitha krimeve të pas luftës, me qëllim që t'u jepet mbështetje organeve të hetuesisë dhe të prokurorisë për zbardhjen e këtyre rasteve shpeshherë të klasifikuara edhe si politike.

Iniciativa jonë ka qenë shumë legjitime dhe konform Kushtetutës, nenit 65.1, Rregullores së Kuvendit, neni 15.2 dhe 8, dhe neni 42 të kësaj Rregullore. I falënderoj në emër të grupit parlamentar të gjithë ata që mbështetën këtë nismë dhe më befason qëndrimi i AAK-së dhe i LDK-së dhe kërkoj që me këto çështje të mos bëhet politikë dhe qëllimi i Partisë Demokratike ka qenë që këto çështje shumë të ndjeshme dhe të përfolura deri më tani të marrin një zgjidhje juridike. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit!

Më lejoni edhe unë t'i them 2 – 3 fjalë.

Të nderuar deputetë të të gjitha grupeve parlamentare,

Kërkoj nga ju që ta kuptoni drejt se Parlamenti i ka tri detyra: është institucion përfaqësues, institucion ligjvënës dhe institucion monitorues ose kontrollues i institucioneve të pavarura dhe të ekzekutivit që e zgjedh. Kush ka lëndë dhe fakte për të akuzuar këtë apo atë, është prokuroria, është gjyqësia dhe, ju lutem, t'iu drejtoheni atyre dhe mos ta shndërroni parlamentin as në trup policor, as prokurorial dhe as gjyqësor.

Vazhdojmë me deputetët e mbeturit nga seanca e kaluar.
Fjalën e ka deputeti Nait Hasani.

NAIT HASANI: Faleminderit, kryetar!

Përshëndetje, Kabinetit qeveritar!

E pamë që u ngritën shumë tema, po asnjë nuk foli për zhvillimin apo për dëmet që janë shkaktuar në Kosovë për shkak të...

Unë dhe Komisioni kemi qenë në Rahovec dhe bujqit e Rahovecit janë mjaftë të shqetësuar, zoti kryeministër, sepse ministri po mungon këtu, ku ta dimë ku është tash. Neve na duhet t'ju dalim në ndihmë këtyre bujqve, që atje ka ndodhur një katastrofë natyrore, ku bora që ka rënë iu ka prishur banorëve, diku rreth 78 mijë banorë të Rahovecit që merren me vreshtari apo të rrethit të Dukagjinit, ku 63% të vreshtave janë dëmtuar dhe neve na duhet që Qeveria, Kuvendi të gjejnë mundësi, të gjejnë hapësirë që këtyre banorëve t'ju dalin në ndihmë. Kjo është e vetmja mundësi që atyre njerëz të punës që me vullnetin e vet, me dashurinë e vet janë të gatshëm të sakrifikohen për ndërtimin dhe zhvillimin e vendit të vet dhe të vendit tonë, ne t'ju dalim në ndihmë e t'ju ikim atyre që nuk punojnë, t'ju ikim atyre që flasin, po ne t'i kthehemi punës, t'i kthehemi ndërtimit dhe zhvillimit të vendit tonë. Këtu, me 63% dëmeve që iu kanë shkaktuar vreshtarëve, kjo është një dëm dhe një katastrofë natyrore, që mund të thuhet për rrethin e Rahovecit dhe atë pjesën ku bora e ka shkaktuar këtë dëm. Ministri i Financave, kryeministri, ministri i Bujqësisë duhet të dalin në vendin e ngjarjes, që ne e kemi edhe në CD, mund t'ju ofrojmë si dëshmi e prishjeve që ka shkaktuar atje dhe t'ju dalim në ndihmë, t'ju ndihmojmë. Nëse ne nuk e bëjmë këtë, e legjitimojmë papunësinë tonë, mosgatishmërinë tonë, e legjitimojmë që ne i vlerësojmë dhe i ndihmojmë ata që nuk e duan punën. Nëse ne kemi thënë dhe themi vazhdimisht që jemi për njerëzit e punës, atëherë rasti është që ta dëshmojmë në praktikë, sepse ata janë njerëz të punës, me punën e tyre i kanë ndërtuar ato vreshtari dhe jetën e tyre. Ju faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit!

Fjalën e ka deputeti Haki Demolli.

HAKI DEMOLLI: I nderuari kryetar i Kuvendit,

I nderuar Kabinet qeveritar,

Të nderuar deputetë të Kuvendit të Kosovës,

Gjatë vitit të kaluar qytetarët e Kosovës kanë pasur mundësinë të dëgjojnë prej zyrtarëve të EULEX-it, ndër të tjera, edhe fjali të këtilla, citoj: Ky është fillimi i shtrëngimit të muskujve të Prokurorisë së EULEX-it ndaj krimit të organizuar". Pastaj, fjalinë: "Së shpejti do të arrestohen peshqit e mëdhenj". Kurse në një konferencë për mediat të

mbajtur në Çagllavicë, në të cilën isha pjesëmarrës edhe unë dhe kryeprokurori i Kosovës, shefi i prokurorisë së EULEX-it pati paralajmëruar projektin e pastrimit të tubave të mbushur me korrupsion dhe krim të organizuar. Ndërsa, në një intervistë tjetër, i njëjti zyrtar pati premtuar se janari i vitit 2011 do të jetë muaji i korrjeve në luftë kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar. Kurse marsi do të jetë muaji kur do të jetë i gatshëm që të japë përgjegjësi për punën e misionit të EULEX-it në këtë rrafsh.

A thua, çka u përmbush nga të gjitha këto premtime dhe deklarime mediale? Sa rëndë u godit krimi i organizuar dhe korrupsioni nga këta muskuj të fortë, sa peshq të mëdhenj të korrupsionit u arrestuan? Në vend të raportimit të premtuar mbi punën dhe rezultatet e misionit në muajin mars, zyrtarët e EULEX-it në fillim të muajit prill përgatitën befasinë e radhës për popullatën kosovare, duke dënuar më 30 ditë burgim kryetarin e komunës së Therandës, zotin Blerim Kuçi, për shkak të refuzimit të dëshmitit për një rast që ka ndodhur në fillim të vitit '99. Të aktvendim të gjyqtarit të EULEX-it, dënimi i zotit Kuçi arsyetohet kështu: “Dëshmitari nuk ishte në gjendje të paraqesë arsye ligjore përse nuk ju përgjigj pyetjeve të prokurorit”? Është e dituar se sipas Kodit të procedurës penale të Kosovës, për dëshmitarët që refuzojnë të dëshmojnë burgimi zgjatë derisa dëshmitari nuk pranon të dëshmojë ose derisa procedura të përfundojë, por më së shumti një muaj. Pra, është e pakontestueshme se si të jetë shëndosh e mirë zoti Kuçi, gjë që ne të gjithë dëshirojmë, ai pas 30 ditëve do të lirohet dhe do t'i kthehet familjes, obligimeve të tij të punës dhe jetës së tij të përditshme. Mirëpo, vetvetiu shtrohet pyetja: Sa është i arsyeshëm dënimi dhe arrestimi i dëshmitarëve në një vend ku peshqit e mëdhenj të korrupsionit dhe të krimit të organizuar jo vetëm që notojnë lirshëm, por edhe janë shndërruar në peshkaqenë dhe rrezikojnë mirëqenien sociale dhe jetën e lirë të të tjerëve.

Andaj, me këtë rast do t'ju drejtohem zyrtarëve të EULEX-it me kërkesën që mos të humbin kohë dhe të mos krijojnë spektakle mediale me dëshmitarët, sepse kjo nuk është dëshirë dhe synim i popullatës së Kosovës, por forcën e muskujve të tyre le ta demonstrojnë aty ku duhet, ndaj kokave dhe qendrave të korrupsionit dhe të krimit të organizuar.

Në të njëjtën kohë, kërkoj nga përfaqësuesit e Qeverisë së Kosovës që këtë çështje ta ngrisin dhe diskutojnë në bordin e sundimit të ligjit dhe t'ua bëjnë me dije përfaqësuesve të EULEX-it se qytetarët e ndershëm, si zoti Blerim Kuçi, nuk duhet dënuar, se nuk

(Ndërprerje nga regjia)

KRYETARI: Përfundoje, deputet, regjia!

HAKI DEMOLLI: Pra, se qytetarët e ndershëm, si zoti blerim Kuçi, nuk duhet dënuar, se nuk janë të rrezikshëm për krijimin dhe sforcimin e shtetit të Kosovës, po le të angazhohen më shumë dhe të jenë me agil dhe këmbëngulës ndaj atyre që keqpërdorin taksat e qytetarëve të Kosovës, me çka rrezikohen dhe dëmtohen seriozisht themelet e shtetit të Kosovës. Faleminderit!

KRYETARI: Kush ka dëshmi për peshkaqenë të mëdhenj, le t'i çojë në prokurori!
Vazhdojmë. Fjalën e ka deputetja Aurora Bakalli.

AURORA BAKALLI: I nderuar kryetar i Kuvendit,
Kabinet qeveritar,
Të nderuar deputetë të Kuvendit të Kosovës,
Në emër të farmacistëve kosovarë dua të shpreh shqetësimin e tyre për, siç thonë ata, denigrimin e imazhit të farmacistëve në Kosovë pas ngjarjeve të fundit.

Inspektimet që u bënë kohë më parë në barnatore dhe depo të barërave, rezultuan me konfiskim të barërave të pa doganuara dhe gjobitje në vlerë prej 5000 eurosh. Para syve të qytetarit të rëndomtë kjo nënkuptoi se në barnatore paskan blerë barërat të cilësisë së dyshimit, të cilat kanë rrezikuar shëndetin e tyre. Ndërkaq, farmacistët shpjegojnë se barërat e pa doganuara në barnatoret e tyre kanë qenë pikërisht ato të cilat përshkruhen nga mjekët dhe kërkohen nga qytetarët por, fatkeqësisht, nuk janë të regjistruara nga Agjencioni Kosovar për Produkte Medicinale.

Duke parë kërkesën kërkesën e qytetarëve dhe për të qenë në shërbimin e tyre, farmacistët ishin të detyruar për t'u pajisur edhe me këto barëra, përndryshe qytetarët do të jenë të shtyrë të gjejnë zgjidhje nëpër enklava apo jashtë vendit. Nga bisedat me farmacistë kanë kuptuar se ndër barërat e paregjistruara janë Nitroglicerina, Dopamina, Dobutamina, Diamoksi, Vitamina C, Vitamina B dhe të tjera, preparate këto shumë të rëndësishme për shëndetin e të sëmurit.

Në Kosovë janë të regjistruara rreth 500 preparate medicinave, ndërsa shtet përreth kanë së paku dyfish më shumë barëra të regjistruara, edhe pse sëmundëshmëria konsiderohet të jetë e ngjashme.

Ndërkaq, dilemat e mia personale janë disa: Si janë përzgjedhur barnatoret që janë inspektuar? Pra, cilat kanë qenë ata farmacistë që pos gjobës së majme, është dashur të përballen edhe me petkun e kontrabanduesit.

Përfaqësuesit e doganave thonë se këtë përzgjedhje e ka bërë Njësia e Inteligjencës. Ndërkaq, mendja më thotë se nëse farmacistët ishin unik për të hyrë në grevë, atëherë ky problem ka qenë i të gjithëve.

Dilemë tjetër është se pse aksione të tilla nuk janë ndërmarrë tash e 12 vite, ani pse shumica e barërave të përegjistruara kanë qarkulluar tërë këtë kohë në tregun tonë. Barërat e konfiskuara një kohë janë dërguar për shfrytëzim në Qendrën Klinike Universitare të Kosovës dhe prej këtu del edhe dilema tjetër e imja, si këto barëra nuk paskan qenë të sigurta për t'ju shitur pacientëve, por megjithatë paskan qenë mjaftë të mira për t'ju dhënë falas atyre.

Dua të ritheksoj edhe një herë se greva e farmacistëve nuk pati për qëllim t'i dilte krah kontrabandës, por ajo kishte për qëllim që të bëjë tryzni në organet gjegjëse që të gjendej sa më shpejtë rruga ligjore për t'u futur në treg këto preparate.

Konsideroj se sa më parë duhet të përpilohet lista prioritare e barërave të përegjistruara dhe përmes një udhëzimi administrativ të lejohet importimi i tyre me doganë, derisa të regjistrohen nga AKPM-ja. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit!

Deputeti Niazi Idrizi e ka fjalën.

NIAZI IDRIZI: I nderuar kryetar i Kuvendit,
Të nderuar zëvendëskryeministra, ministra,
I nderuari kryeministër,
Të nderuar deputetë,

Dëshiroj ta shpreh shqetësimin e një numri të qytetarëve të ndjekur nga Kosova Lindore dhe nga Maqedonia në kohën e luftës, të cilët aktualisht jetojnë në Kosovë dhe po përballen me problemin e dëshmisë së identitetit të tyre. Këta njerëz që nga dëbimi i tyre në Kosovë, para 11 vjetëve, janë gjysmë legal për shkak të pamundësisë së pajisjes me dokumente identifikimi as në Kosovë, e as në Serbi. Nga kjo fatkeqësi më së shumti po pësojnë të rinjtë, të cilët kanë nevoja të shumta të udhëtimit që lidhen me shkollimin dhe punësimin, por këto nevoja i kanë të mëdha edhe pleqtë, të cilët kanë nevojë për shërim.

Problemi qëndron te Ligji për shtetësinë e Republikës së Kosovës, i cili kërkon certifikatë nga aplikuesit për të dëshmuar se ata nuk janë nën hetime në shtetin prej nga vinë, pra në

shtetin që i ka përzënë nga vatrat e tyre. Këtë kusht të vetëm qytetarët e Luginës së Preshevës nuk mund ta plotësojnë dhe për pasojë nuk mund ta fitojnë shtetësinë e Republikës së Kosovës, sepse këtë dokument ata duhet ta marrin në organet e gjyqësisë së Republikës së Serbisë. Për ta marrë këtë dokument kanë probleme, posaçërisht ish pjesëtarët e UÇPMB-së, të cilët realisht mund të përballen me dënime sikur shokët e tyre, të cilët para pak muajsh u patën dënuar madje me 101 vjet burg. Ky problem mund të zgjidhet nëse ndryshohet neni 9 dhe 10 i Ligjit për shtetësinë e Republikës së Kosovës, i cili përcakton mënyrën e fitimit të shtetësisë.

Duhet të theksohet fakti se shumica e këtyre qytetarëve të gjitha obligimet e veta si taksapagues i përmbushin në buxhetin e Kosovës. Ministria e Punëve të Brendshme e Republikës së Kosovës duhet të ndërmarrë iniciativën për amendamentimin e këtij ligji për plotësimin e kërkesës së kësaj kategorie në hall të qytetarëve.

Në Kosovën e re, të lirë dhe demokratike nuk duhet të kenë vend ligjet diskriminuese. E drejta e posedimit të dokumentacionit të identifikimit është e drejtë themelore e njeriut. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit!

Deputeti i fundit, deputeti Sabri Hamiti e ka fjalën.

SABRI HAMITI: Zoti kryetar, i nderuari Krasniqi,

Unë në të vërtetë jam paraqitur që të deklaroj këtu që ju sot e keni shkel Rregulloren e Kuvendit, sepse dihet shumë mirë që kjo është një rubrikë e deklaratave, ku nuk ka replika të kujt do qoftë. Kjo, nën një.

Nën dy, po kjo rubrikë shtesë ekziston për deklarata të Kabinetit qeveritar dhe anëtarët e kabinetit e kanë po ashtu të drejtën të deklarojnë për problemet e tyre. Prandaj, unë vet s'dua ta shkel, kam çka të them replikë, s'dua të replikojë me askënd, vetëm se duhet të kërkoj që kjo mos të ndodhë. Herëve të tjera kjo do të bëhet mandej pjesë debati në Parlament. Nëse ju e lejoni, atëherë unë jam i gatshëm. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit!

Jo, koha është harxhuar. Ju lutem, merruni vesh mes grupeve, unë s'do t'i lexoj emrat, janë edhe 11 – 12 deputetë, merruni vesh, janë 30 minuta, ndani nga pak kohë dhe mos u paraqitni sikur të jetë debat. Këtu po ngrehni çështje, që shumë më mirë është ta bëni kërkesën për debat, për mocion, se sa ta harxhoni kohën për 3 minuta, për të mos thënë asgjë. Kjo është vetëm për të bërë politikë. Janë do tema shumë të mira, që unë jam

dakord me ato që u shtruan, siç është ajo e profesor Demollit, deputetit Demolli, por realisht nuk janë tema që duhet trajtuar për 2 – 3 minuta. Kështu që koha jonë u harxhua. Është një vërtetë, nuk është dashur për t'ia dhënë në kohën e deputetëve fjalën kryeministrit, por ia dhashë, por koha që ka folur kryeministri nuk është në kohën e deputetëve, nuk është llogaritur fjala e kryeministrit në kohën e deputetëve. Kjo është kështu. Qeveria e ka kohën e vet. Zëvendëskryeministri Hajredin Kuçi e ka fjalën.

HAJREDIN KUÇI: Faleminderit, i nderuar kryetar!

Të nderuar anëtarë të Qeverisë, kryeministër,

Të nderuar deputetë,

Më lejoni që të jap, pasi u bë një traditë për të dhënë përgjigje të tillë, të japim edhe ne atë që ka të bëjë me Qeverinë.

Fillimisht, më lejoni të them që rregulla 47 e Rregullores, që keni para vetes, lejon që të flitet në këta 30 minuta, por me një marrëveshje paraprake me kryetarin e Kuvendit dhe për tema të cilat janë të pa shtyshme dhe jo për tema të cilat mund të jenë që i përngjan pak - Hajt pak. Po, sido që të jetë, unë mendoj që është mirë ta lexoni Rregulloren, numër 47, ai që ka durim të dëgjojë, është mirë. Unë besoj që mund të vazhdojmë tash.

Sa i përket çështjeve që u përmendën këtu, e përmendi zoti Rexhep Selimi një çështje që ka të bëjë me intervenimin e policisë, e di zoti Selimi që në mbledhjen e kaluar në Kuvend kam thënë që do të ketë hetime ndaj policisë dhe po ashtu e dini që janë marrë veprime tilla, janë suspenduar njerëzit dhe do të shkohet me përgjegjësi në cilindo nivel që mund të ketë. Ndërsa, për dorëheqje dhe çështje të tjera, do të matet përgjegjësia.

Sa përket çështjes që e ngriti zoti Haradinaj, për çështjen e kompleksit në Koshare, unë e kam dhënë një premtim publik që do të ketë intervenim atje, do të ketë ndërtim të kompleksit edhe në Koshare, edhe në Gllogjan, edhe në vende të tjera që nuk janë ndërtuar ende, por po ia kujtoj zotit Haradinaj dhe të tjerëve, në qeverisjen tonë kemi marrë një intervenim për rregullimin e rrugës në atë pjesë, e cila rrugë nuk ka karakter ekonomik, por ka vetëm një karakter dhe ai karakter ka qenë më shumë moral dhe kombëtar.

Sa i përket çështjes që lidhet po ashtu me Kosharen, për informimin tuaj, besoj jeni të informuar, unë si ministër i Drejtësisë kam marrë vendim që të themelohet çmimi për drejtësi me emrin “Heroi Sali Çekaj”, dhe atë do ta bëjë shumë shpejt tani edhe për ndarje.

Profesori Demolli e përmendi çështjen e bordit, unë pajtohem plotësisht zoti profesor, por besoj ju edhe unë pajtohem që ligji duhet të vlejë ndaj secilit individ dhe secilën pjesë territorit të Republikës. Këtu duhet të ketë reagime edhe nga vendorët, edhe nga ndërkombëtarët. Kur dëshirojmë t'i ikim paksa përgjegjësisë, edhe prokurorët, edhe gjyqtarët tanë e bartin te ndërkombëtarët. Duhet t'i ngrehin kapacitetet të dy palët, të funksionojnë në cilindo rast dhe sipas kompetencave ligjore që i kanë. Unë e kam ngritur këtë çështje edhe në bord, bashkë me ju disa herë dhe do ta ngrejë prapë. Unë jam i bindur që veprimi që mund të jetë për rendin dhe drejtësinë, veprimi që u përmend këtu, e dini që është bërë një kërkesë nga Kryesia e Kuvendit, kam përgatitur një raport për Kuvendit dhe jam i gatshëm që të marrë pjesë në diskutime, por gjithmonë duke ditur që kompetencat e mia janë jo në sferën e gjyqësorit, por vetëm në sferën ekzekutive dhe nuk marrë të drejtë as liri që të përzihem në punët e prokurorisë apo të gjykatave. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit!

Pika e rendit të ditës - Deklarimet jashtë rendit të ditës, u harxhuan.

Janë lajmëruar 9 deputetë, 8 deputet tani janë, regjia le t'i regjistrojë.

Vazhdojmë me pikën e dytë të rendit të ditës:

2. Koha për pyetje parlamentare

Në pajtim me nenin 45.1 të Rregullores së Kuvendit, koha për pyetje të deputetëve për Qeverinë është e kufizuar në 60 minuta. Deputeti për një mbledhje mund të parashtojë më së shumti 2 pyetje.

Tani kemi dy pyetje të parashtruara nga deputeti Lutfi Haziri, edhe pse ky i ka parashtruar nja 12, po 2 mund t'i parashtojë brenda një seance. Kështu që fjalën e ka deputeti Lutfi Haziri, pyetje për kryeministrin, zotin Hashim Thaçi. Fjalën e ke, deputet.

LUTFI HAZIRI: Faleminderit, zoti kryetar!

Pyetja e parë për kryeministrin ka të bëjë me rishikimin e aneksit të ... për procesin e decentralizimit. Paragrafi i fundit i këtij aneksi thotë që institucionet e Kosovës kanë të drejtë ta rishikojnë në tërësi funksionalitetin e procesit pas periudhës kohore tre vjeçare. Jemi në periudhën kohore që ka kalua 3 vjet, ky proces duhet të rishikohet nga brenda, duhet të rishikohet edhe me komitetin ndërkombëtar drejtues dhe pyetja ime është: Kur planifikoni ta rishikoni, zoti kryeministër, këtë proces, që del si pjesë e obligimeve nga pakoja e Ahttisarit?

KRYETARI: Fjalën e ka kryeministri.

KRYEMINISTRI HASHIM THAÇI: I nderuari deputet Haziri,

Fillimisht ju falënderoj për pyetjen e besimin tuaj për procesin e reformimit të pushtetit lokal apo decentralizimit. Gjithashtu, më lejoni t'ju falënderoj për punën tuaj të mirë që e keni bërë edhe ju personalisht në këtë drejtim edhe si zëvendëskryeministër dhe si ministër i Pushtetit Lokal, edhe në procesin e Vjenës, natyrisht bashkërisht. Pa dashur të zgjatem në arritjet që janë shënuar në kuadër të procesit të decentralizimit me formimin e komunave të reja të suksesshme dhe kompetencat e reja që ka marrë komunat, si rezultat i këtij procesi, më lejoni të sqaroj për ju edhe për gjithë qytetarët e Republikës së Kosovës se procesi i decentralizimit është në rrugë të mbarë të përmbyllet shpejt.

Në përputhje me planin gjithëpërfshirës të presidentit Ahttisari, që është pjesë integrale e Kushtetutës së Republikës së Kosovës, decentralizimi dhe formimi i komunave të reja po thuaj se është përmbyllur, me përjashtim të formimit të komunës së re në Mitrovicën veriore. Në këtë aspekt, ne jemi përkushtuar që të formojmë edhe komunën e Mitrovicës veriore, ashtu siç parashihet të mbajmë zgjedhje të lira në këtë komunë dhe në komunat e Zubin Potokut, Zveçanit, Leposaviqit, në mënyrë që të përmbyllem në tërësi këtë proces.

Përkundër kësaj, ju jeni në dijeni se gjatë periudhës së pavarësisë së mbikëqyrur nga Zyra Ndërkombëtare Civile, që gjithashtu po i vije fundi do të thotë kësaj faze dhe, natyrisht, për një kohë të përshtatshme ne bashkërisht do të duhet të shikojmë edhe procesin e decentralizimit. Por, natyrisht, shumë çka i takon vendimit të Kuvendit, pastaj Qeveria implementon.

Procesi i rishikimit të decentralizimit do të mund të bëhet kur t'i kemi të dhënat e sigurta për numrin e banorëve dhe të ekonomive familjare në tërë territorin e Kosovës.

Procesi i regjistrimit të popullsisë zyrtarisht ka përfunduar, mirëpo ky proces ende nuk u përmbyll në pjesën veriore të Kosovës, mirëpo ne jemi të bindur se komuniteti ndërkombëtar do të na ndihmojë me këshillat e tyre përkatëse ...

Të nderuar deputetë,

Kuvendi i Republikës së Kosovës ka krijuar Komisionin për ndryshime kushtetuese, e kam theksuar edhe më herët, jo vetëm për zgjedhjen e drejtpërdrejtë të presidentit të Republikës së Kosovës apo reformën zgjedhore, por edhe për ndryshime substanciale,

thelbësore që do ta përmbyllin njëherë e përgjithmonë pavarësinë e mbikëqyrur edhe do ta fuqizojë apo edhe konsolidojnë shtetin tonë, si shtet i pavarur sovran.

Kështu, unë konsideroj se në një kohë optimale dhe realiste do të fillojë rishikimi edhe i procesit të reformimit të pushtetit lokal apo decentralizimit. Ju faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit!

Deputeti Lutfi Haziri, pyetje për zëvendëskryeministren, Edita Tahiri.

LUTFI HAZIRI: Nuk më dhatë kohë për pyetjen shtesë, por ...

KRYETARI: Më fal, se pyetje shtesë ke!

LUTFI HAZIRI: Faleminderit!

Pyetje shtesë për kryeministrin. Ky proces ka qenë pjesë e procesit të definimit të statusit dhe, natyrisht, kompromiset që janë bërë në atë kohë për akomodimin e komunitetit etnik serb në Kosovë e kanë lehtësuar vetëm në pjesën që kërkohet rishikim. Ky vit është vit i rishikimit. Ju e pranuat që është pjesë e ndryshimeve në kushtetutë. Procesi nuk është i detyrueshëm për ata që s'e pranojnë. Për komunitete, qoftë shumicë, qoftë pakicë që nuk e pranojnë, nuk është i detyrueshëm. Qeveria nuk detyrohet t'ua japë me zor. Duhet të rishikohet dhe të shihet se si kjo duhet të ndodhë, por duhet të balancohet, sepse kemi shqiptarë apo shumicë shqiptare që kanë mbetur jashtë këtij procesi. Ju kisha lutur që në këtë rishikim ta sqaroni - a do ta mbështetni projektin e pritjes, çka po ndodh me procesin e statusit të Mitrovicës, në veçanti të pjesës veriore, apo do ta mbështetni projektin e rishikimit dhe balancimit me popullatë. Për shembull, qytetarët e Zhegrës që 3 vjet presin për t'u bërë komunë. Ata janë shkëputur territorialisht na Gjilani dhe problemi është praktik. Ata e kanë bërë kërkesën, ekziston dosja për ta, kurrë nuk është biseduar me ta, kështu që duhet bërë, të gjendet një mënyrë, një mënyrë për balancimin...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYETARI: Urdhëro, kryeministri e ka fjalën!

KRYEMINISTRI HASHIM THAÇI: Ne kemi vlerësuar, i nderuari deputet Haziri, që në fund të këtij viti apo në fillim të vitit të ardhshëm të ndodhë kjo, por do të punohet paralelisht edhe për pjesën veriore, edhe për pjesën tjetër të Republikës së Kosovës. Natyrisht, ka shumë kërkesa për formimin e komunave të reja, të cilave duhet dhënë përgjigje bashkërisht. Faleminderit, shumë!

KRYETARI: Tani, pyetja e dytë, zoti deputet Lutfi Haziri, për zëvendëskryeministren Edita Tahiri.

LUTFI HAZIRI: Faleminderit!

Desha në çështje, kërkoja fjalën më herët për të diskut një çështje që lidhet me këtë proces. Meqë kryeministri e ka deleguar këtë të drejtë të përfaqësimit në biseda të një zëvendëskryeministri dhe meqë e kemi prezencën e saj këtu, kisha dashur të kem përgjigje konkrete.

Më lejoni të them edhe një herë që unë jam kundër bisedimeve në këtë kohë në këtë proces, sepse nuk fitojmë asgjë dhe kjo po shihet. Dy çështje janë konkrete që duhet dhënë përgjigje: Cili është opsioni, propozimi ynë që në biseda teknike, të ashtuquajtura teknike për energji, Kosova e merr qëndrimin. Po përmend energjinë, sepse Kosova po vazhdon të duplikohet. Nëse nënoperatori është zgjidhje dhe Kosova e ka një histori të ashtuquajtur të bisedave teknike më 2006, zonja zëvendëskryeministre, Serbia na ka ofruar më 2006 librat katastral, kopje, na ka afrua nënoperatorin, kjo Qeveri ka nënshkruar protokoll me qeverinë e Serbisë, janë ratifikuar me kabinet qeveritar për lëvizjen e lirë dhe për kthim. Ju keni bërë një shpërndarje totale të këtyre çështjeve dhe pyetja ime konkrete - Çka dhe cili është opsioni që do ta mbron në emër të këtij vendit, duke pasur parasysh se shumica politike këtu është kundër, por ekziston një rezolutë e votuar, cili është qëndrimi i juaj në çështjen e energjisë, në veçanti, sepse po shihet, ne nuk kemi fakte, por është thënë se nënoperatori është zgjidhje që është ofruar dhe ju keni arsyetuar librat kadastral, që realisht është në kundërshtim me vullnetin tonë, këto janë ofruar. Domethënë, janë disa zgjidhje që prej 2006 Kosovës iu kanë ofruar, por janë refuzuar. Cila është qëndrimi juaj tash dhe çka parashikoni, cila është rruga që ta zgjidhni këtë çështje?

KRYETARI: Fjala është për zëvendëskryeministren, Edita Tahiri.

ZËVENDËSKRYEMINISTRJA EDITA TAHIRI: Faleminderit!

I nderuar kryetar i Kuvendit,

I nderuar kryeministër, Kabinet qeveritar,

Deputetë të nderuar,

I nderuar deputet Haziri,

Në dialogun teknik ndërshtetëror midis Republikës së Kosovës dhe Republikës së Serbisë të ndërmjetësuar nga BE dhe të mbështetur nga SHBA-të, pala e Kosovës ka për bazë

Kushtetutën e Republikës së Kosovës, Rezolutën e Kuvendit të Kosovës në mbështetje të dialogut dhe parimet euro-atlantike.

Për sa i takon çështjeve të energjisë, pozicioni ynë është bazuar në këto parimet kryesore: në respektimin e ligjeve të Republikës së Kosovës për fushën e energjisë, në respektimin e Traktatit të Athinës për Energji dhe në përkushtimin e qeverisë së Kosovës për të kontribuar në stabilitetin energjetik rajonal.

Kërkesat konkrete mes tjerash përfshinë:

1. Një marrëveshje ndërshtetërore në fushën e transmissioinit të energjisë midis Kosovës dhe Serbisë, me qëllim të rregullimit të bashkëpunimit në këtë fushë
2. Kompensimi nga Serbia për shfrytëzimin e linjave të transmissioinit të Kosovës, për periudhën prej vitit 2004 deri më sot
3. Kompensimi nga Serbia për kongestionet e shkaktuara në linjat e transmissioinit të Kosovës, për periudhën 1999 deri më sot
4. Kontributi për bashkëpunime rajonale në funksion të stabilitetit energjetik rajonal dhe mospengimi i pjesëmarrjes së barabartë të të gjitha vendeve të rajonit në Komunitetin e Athinës për energji dhe iniciativa tjera rajonale
5. Ndalja e veprimtarisë së operatorëve ilegal të Serbisë në Kosovë në fushën e energjisë
6. Ndalja e çfarëdo ndërhyrje tjetër ilegale në sistemin energjetik të Kosovës
7. Largimi i ndikimeve negative të Serbisë te një pjesë e konsumatorëve serb të cilët vazhdojnë të mos paguajnë për shërbimet e energjisë së KEK-ut, që nga fundi i luftës.

Për çështjen e lëvizjes së lirë, pozicioni i Kosovës është bazuar në parimin e reciprocitetit midis dy shteteve për lëvizjen e lirë si një nga parimet fundamentale të Bashkimit Evropian.

Ndërsa kërkesat konkrete kanë qenë:

1. Njohja e dokumenteve të udhëtimit të Republikës së Kosovës nga ana e Serbisë, pra njohja e pasaportave, lejes së njoftimit, lejes së vozitjes dhe targave të automjeteve me qëllim që tu mundësohet qytetarëve të Kosovës lëvizja e lirë.
Duke qenë se Kosova zbaton parimet evropiane për lëvizjen e lirë me të gjitha vendet e rajonit përfshirë Serbinë, që donë të thotë se qytetarët e Serbisë udhëtojnë lirshëm në Kosovë pavarësisht historisë së hidhur, atëherë kemi kërkuar që reciprociteti të vlejë edhe për qytetarët e Kosovës dhe jemi të vendosur për implementimin e këtij parimi.
2. Shuarja e strukturave paralele serbe në Kosovë dhe ndërprerja e dhënies së dokumenteve nga këto struktura ilegale.

3. Sundimi i ligjit në fushën e targave të automjeteve dhe ndërprerja e përdorimit të targave ilegale të automjeteve në Republikën e Kosovës.

Në takimin e fundit në Bruksel, po ashtu është shtruar kërkesa për njohjen e diplomave shkollore dhe universitare të Republikës së Kosovës nga ana e Serbisë, mbi po të njëjtin parim të reciprocitetit.

Ju faleminderit!

KRYETARI: A keni pyetje shtesë, deputet, pyetjen shtesë le ta bëjë pastaj nëse ke kohë, e vazhdon. Deputet, pyetje shtesë a ke?

LUTFI HAZIRI: Faleminderit!

Ju e përmendët në fjalën tuaj, zonja zëvendëskryeministre, Kosova është nënshkruese e Traktatit të energjisë, pse s'kanë arritur të mbrojnë të drejtat në kuadër të kësaj marrëveshjeje, atëherë askush s'ka të drejtë të dalë jashtë asaj që ligji veç e përcakton, Ligji për energjinë e përcakton të drejtën dhe kompetencat tona. Nënoperatori është tendencë për ta ndarë Kosovën, për ta duplikuar Kosovën. Territorialisht, de fakto është problem. Tash po vazhdohet me energji, do të vazhdohet me probleme tjera. Atëherë, ky është qëllimi im, që të përmbahet, në kuptim teknik të mos lejohet, sepse de fakto nënoperatori është nxjerrë në tavolinë, stenogramin që e ka lypur Albin Kurti, si kryetar i Komisionit, s'po na vjen, po presim edhe më tutje. Pyetja ime shtesë ka të bëjë me të drejtën tonë që të mos lejoni që pjesa apo sektori....

(Ndërprerje nga regjia)

KRYETARI: Faleminderit!

Zonja zëvendëskryeministre, e ke fjalën, e vazhdon fjalën që e ke lënë gjysmë!

ZËVENDËSKRYEMINISTRJA EDITA TAHIRI: Zoti Haziri, vetëm shpejt t'ju them që kërkesat për çështjen e lëvizjes së lirë janë: njohja e dokumenteve të udhëtimit të Republikës së Kosovës nga ana e Serbisë, shuarja e strukturave paralele serbe në Kosovë dhe ndërprerja e dhënies së dokumenteve nga këto struktura ilegale, sundimi i ligjit në fushën e targave të automjeteve dhe ndërprerja e përdorimit të targave ilegale të automjeteve në Republikën e Kosovës. Për këtë reciprocitet, ne jemi të vendosur plotësisht si Qeveri e Republikës së Kosovës. Për sa i takon pjesës tjetër, pra të faktit që shtetet janë nënshkruese të Traktatit të Athinës, është e vërtetë që edhe Kosova është nënshkruese, por ja që rajoni po ballafaqohet me shtete të caktuara që edhe nënshkruajnë, edhe e shkelin, siç është Serbia. Faleminderit!

KRYETARI: Ju faleminderit! Përfundoi edhe kjo pikë e rendit të ditës.

Pika e tretë është:

3. Miratimi i Procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 22 prill 2011

Të nderuar deputetë,

Prezent kemi 79 deputetë, mund ta vazhdojmë punën.

Pyes, nëse keni vërejtje në këtë procesverbal? Nuk ka. Atëherë, konstatoj se Kuvendi miratoi Procesverbalin e mbledhjes plenare të mbajtur më 22 prill 2011.

Vazhdojmë me pikën e katër të rendit të ditës:

4. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për noterinë

Në bazë të nenit 56 të Rregullores së Kuvendit, komisioni funksional ka shqyrtuar projektligjin dhe Kuvendit ia ka paraqitur raportin me rekomandime, andaj janë përmbushur kushtet për shqyrtim në parim të këtij projektligji.

Ftoj ministrin e Drejtësisë dhe zëvendëskryeministrin, zotin Hajredin Kuçi, që në emër të Qeverisë së Republikës së Kosovës para deputetëve të Kuvendit të prezantojë dhe arsyetojë projektligjin.

MINISTRI HAJREDIN KUÇI: Faleminderit, zoti kryetar!

Të nderuar anëtarë të Qeverisë,

Të nderuar deputetë,

Më lejoni që në emër të Ministrisë së Drejtësisë të paraqes para jush për aprovim Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03L/010 për noterinë.

Ky projektligj është si rezultat i tendencës tonë për të kompletuar infrastrukturën ligjore në sektorin e noterisë, pasi që legjislacioni aktual që rregullon këtë fushë nuk e mbulon në nivel të duhur dhe është në funksion të përmirësimit të klimës së bizneseve në Kosovë.

Në fillim, më lejoni të theksoj se ky projektligj është në harmoni të plotë me dispozitat e legjislacionit të BE-së dhe të shteteve të tjera të zhvilluara, për çka flitet edhe në deklaratën e pajtueshmërisë nga legjislacioni i BE-së.

Me këtë projektligj synohet të krijohet një bazë ligjore për një ambient më të favorshëm për biznesin në Republikën e Kosovës, i cili është nevojë e domosdoshme duke pasur parasysh faktin se në disa dispozita të Ligjit aktual për noterinë kanë paraqitur pengesë administrative për ambientin e biznesit në Republikën tonë.

Me këtë projektligj shfuqizohen dispozitat që konsiderohen se janë pengesa administrative për mjedisin e favorshëm afarist, harmonizohen dispozitat e këtij projektligji me Kushtetutën e Republikës së Kosovës dhe ligjet tjera, si dhe harmonizohet terminologjia juridike me ligjet në fuqi.

Ky projektligj është përgatitur nga Ministria e Drejtësisë në bashkëpunim me ekspertët e vendit dhe ata të huaj me qëllim të krijimit të një sistemi funksional për zhvillimin e biznesit në Republikën e Kosovës.

Me përfshirjen e këtij projektligji në sistemin juridik të Kosovës do të ndikonte drejtpërdrejt në avancimin e legjislacionit në këtë fushë dhe do të krijohej një sistem funksional për ambient afarist dhe kushte më të favorshme për biznesin në përgjithësi.

Të nderuar deputetë,

Ju ftoj që ta mbështetni në parim këtë projektligj, t'i jepni vërejtjet dhe sugjerimet e tuaja, në veçanti komisionit funksional, por natyrisht edhe ekspertët tuaj, do ta bënim një projektligj i cili ndihmon funksionalitetin e sistemit të noterisë, i cili brenda këtij viti do të jetë funksional.

Më lejoni që të falënderoj punën paraprake që ka qenë edhe nga ministrat për funksionalizimin e këtij sistemi, i cili këtë vit do të jetë edhe praktik në Republikën e Kosovës. Ju faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit!

Në emër të komisionit, në emër të grupit, Armend Zemaj e ka kërkuar fjalën.

ARMEND ZEMAJ: I kalove këta të PDK-së, po hidhërohen.

KRYETARI: Unë thashë në emër të komisionit një herë, një herë komisioni është. Kryetari i komisionit a e do fjalën? Arben Gashi e ka fjalën!

ARBEN GASHI: faleminderit, i nderuar kryetar!

Komisioni i ka shqyrtuar propozimet dhe ka rekomanduar që Kuvendi ta trajtojë këtë çështje, mirëpo realisht janë identifikuar shumë probleme në këtë ligj edhe ligji konsiderohet si vështirë i implementueshëm dhe kemi problematikë me zbatimin e tij, besoj edhe ministria është e vetëdijshme. Rekomandimet që kanë ardhur për ndryshime, janë rekomandime që nuk e përmirësojnë ligjin në tërësinë e tij, mirëpo ne besojmë që

gjatë punës në komision do ta shqyrtojmë edhe në bashkëpunim me Ministrinë e Drejtësisë dhe do të arrijmë që ta përmirësojmë me amendamente aty ku është vlerësuar se ka pasur probleme në zbatimin e tij.

Neni 30, i cili rekomandohet të hiqet, është një rekomandim në lidhje me çështjet, praktikat ekonomike dhe transferimin e pronësisë brenda kompanive që, normalisht, kish për të krijuar një parakusht për rangimin e Kosovës në ndonjë biznes pak më mirë, por nuk është qëllimi i këtij ligji për me ranguar ndonjë biznes, po është qëllimi për të krijuar një noteri efikase në Kosovë.

Prandaj, komisioni ka vlerësuar që ligjit duhet trajtohet dhe besoj që duhet të japim përkrahje që të trajtohet ky ligj dhe me të gjitha komisione tjera pastaj ta trajtojmë sa më mirë që është e mundur. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit!

Në emër të Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike, kush e do fjalën? Deputeti Halit Krasniqi e ka fjalën.

HALIT KRASNIQI: Në emër të Grupit parlamentar të PDK-së, në parim e përkrahim.

KRYETARI: E kreve, a? Mirë, faleminderit!

Armend Zemaj, në emër të Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike.

ARMEND ZEMAJ: Faleminderit, shumë, kryetar!

Edhe Grupi Parlamentar i LDK-së i ka shqyrtuar këto nene apo amendamente të cilat paraqiten për ndryshim dhe plotësim të ligjit nr. 03L/010 për noterinë dhe ne mendojmë apo unë do të mundohem t'i paraqes në pika të shkurtra ato që i tha edhe kryetari i Komisionit, sepse ne dëshirojmë që ta kemi një noteri efikase, edhe pse ligji ka hyrë në fuqi që nga viti 2008, akoma nuk është funksionalizuar noteria. Sipas informatave që kemi, janë në procedurë e sipër, po siç po shihet, ky proces është ngadalësuar. Prandaj, vërejtjet tona konkrete kanë të bëjnë me nenin 5, kur propozohet që të fshihet paragrafi 1.4, ne mendojmë se kjo ka të bëjë me eliminimin e atyre të cilët kanë kryer fakultetet juridike në Republikën e Kosovës. Kjo ndoshta do të duhej të ishte edhe në bashkëpunim me Ministrinë e Arsimit, sepse të gjithë ata studentë nuk janë fajtorë pse i takojnë universiteteve private apo këtij sistemi arsimor, i cili është 3+2. Andaj, mendoj që kjo duhet të rishikohet dhe duhet të trajtohet si temë e veçantë, sepse këtu është paraqitur që të fshihet paragrafi 1 i nenit 30, paragrafi 1, nënparagrafi 1.4.

Neni 6, kemi të bëjmë me çrregullim të ligjit, sepse propozohet të fshihet ... dhe janë dhënë propozime të vazhdojmë me numra përkatës, sepse ky është ligj bazik dhe mendoj që nëse një nen fshihet, ashtu dhe mbetet sipas procedurës dhe këtu do ta përmirësojmë ne në Komision.

Ndërsa brengosës është neni 8, i paraqitur këtu, neni 76, paragrafi 10, i cili kërkohet të ndryshohet, si vijon: Në ligjin bazik edhe në vitin 2008 është dhënë propozimi që brenda një viti të bëhen ndryshime në Ligjin për trashëgiminë e Kosovës dhe Ligjin për kërkesat

jokontestimore. Ndërsa, Ligji për procedurën jokontestimore ka hyrë në fuqi më 12.01.2009 dhe i pari veç ka qenë në fuqi, andaj mendojmë që këtë afat duhet shkurtuar, nëse duam ta vëmë në funksionalizim komplet Ligjin për noterinë dhe çështjet që kanë të bëjnë me të.

Grupi Parlamentar i LDK-së do të japë kontributin e vet në komisionin funksional dhe propozimi ynë ndoshta ka qenë më adekuat që të rishikohet në tërësi Ligji për noterinë. Faleminderit, shumë!

Drejtimin e seancës e merr nënkryetari i Kuvendit, zoti Xhavit Haliti

KRYESUESI: Faleminderit!

Grupi Parlamentar “Vetëvendosje, Albulena Haxhiu.

ALBULENA HAXHIU: Kryesues i Kuvendit,

Të nderuar deputetë,

Një ndër qëllimet kryesore të themelimit të Shërbimit të noterisë ka qenë shkarkimi i gjykatave nga punët jashtë-gjyqësore dhe ofrimi i shërbimeve më efikase për qytetarët. Megjithatë, edhe pse themelimi i këtij shërbimi ka implikime të drejtpërdrejta sistimore në sistemin gjyqësor dhe si i tillë kërkon ndryshimin e një vargu të ligjeve, ka munguar debati rreth themelimit të këtij shërbimi dhe mënyrës së themelimit.

Unë dua të ndalem pak në provimin e noterisë. Pas një trajnimi të mbajtur nga dy deri në tre ditë në muaj, në një periudhë nëntë mujore nga dy ekspertë zviceranë, më 20 dhe 21 nëntor 2010 është mbajtur provimi me shkrim për 157 kandidatë.

Provimet janë korrigjuar nga komisioni i themeluar nga Ministria e Drejtësisë, dhe ky komision ka deklaruar se detyrat në provim janë përpiluar gabimisht nga ekspertët zviceranë, prandaj edhe përgjigjet e kandidatëve kanë qenë të gabuara. Si rezultat i kësaj, komisioni përmes një njoftimi të publikuar me datën 15.12.2010, ka njoftuar kandidatët se për arsyet e latëpërmendura është bërë anulimi i provimit me shkrim. Menjëherë ka pasuar demanti i Ministrisë së Drejtësisë, që në atë kohë nuk ka pasur ministër, duke njoftuar kandidatët se publikimi i rezultateve të provimit do të shtyhet, siç kane thënë ata, deri atëherë kur Ministria e Drejtësisë do të jete e kompletuar me staf politik.

Tani, javën e kaluar, kur kjo Ministri më në fund u kompletua me staf politik, i njëjti komision që e kishte anuluar provimin, ka publikuar rezultatet e provimit, ku nga 157 kandidatë, thuhet se vetëm 10 kandidatë e kanë kaluar provimin me shkrim.

Në një situatë të këtillë, në një proces të udhëhequr nga stafi politik, ne nuk do të ndërtojmë një shërbim noterial të pavarur që do të kontribuojë forcimit të sundimit të ligjit, por do të kontribuojmë në ndërtimin e një noterie politike dhe të varur.

Ligji mbi noterinë, i cili është miratuar në Kuvend më 17 tetor 2008, dhe më pastaj është shpallur në “Gazetën zyrtare” më 25 nëntor 2008, ende nuk ka filluar të zbatohet, pasi që Shërbimi noterial ende nuk është themeluar. Sidoqoftë, ne para vetes e kemi propozimin për ndryshim dhe plotësim të një ligji, që ende nuk zbatohet. Ndoshta kjo tingëllon e palogjikshme, por arsyeja për një ndryshim të këtillë nuk qëndron në problemet eventuale në zbatimin e ligjit, por në arsyen se legjislatura e kaluar e ka aprovuar këtë ligj, të hartuar nga konsulentët e huaj, pa debat dhe shqyrtim të mirëfilltë. Për të dëshmuar këtë, unë do të përmend vetëm dy shembuj nga ligji;

Në nenin 4, paragrafi 1, pika 1.1, si kusht për të ushtruar detyrën e noterit kërkohet që ai ose ajo të jetë banor i përhershëm i Kosovës, formulim i zbuluar në kohën e administrimit nga UNMIK-u, për t’i ikur kushtit që ekziston në çdo shtet tjetër, e që është - të jetë shtetas i Kosovës, ashtu siç tani propozohet me këtë ndryshim.

Në nenin 76, paragrafi 10, thuhet se “Në afat prej një (1) viti, pas hyrjes në fuqi të këtij ligji, institucionet e përkohshme të vetëqeverisjes dorëzojnë te Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm ndryshimet në Ligjin për Trashëgimi të Kosovës dhe Ligjin për procedurën jashtë kontestimore, që paraqitet e nevojshme nga ky ligj. Siç e thashë në fillim, ligji është miratuar në tetor të vitit 2008, domethënë pas shpalljes së pavarësisë, por për shkak të mungesës së debatit dhe shqyrtimit nga Komisioni për Legjislacion dhe Gjyqësi, si dhe nga Kuvendi në seancë plenare dhe, në fund, nga zyra e Presidentit, ky ligj i hartuar nga konsulentët e huaj në kohën e UNMIK-ut ka kaluar me referenca për IPVQ-të dhe PSSP-në, edhe pas shpalljes së pavarësisë.

Të dy këto nene tash kërkohen me propozimin e parashtruar para neve që të ndryshohen. Përveç këtyre ndryshimeve, në nenin 12 kërkohet ndryshimi i shprehjes “president i gjykatës” me “kryetar i gjykatës”. Shprehja president ka mbetur ashtu nga anglishtja dhe është edhe një dëshmi shtesë se ligji aktual është përkthim nga anglishtja dhe nuk është hartuar në Kuvend.

Me gjithë mangësitë që i përmenda, Lëvizja “Vetëvendosje” do ta votojë në parim këtë projektligj, pasi që konsiderojmë se Shërbimi i noterisë do të lehtësojë procedurat burokratike me të cilat ballafaqohen qytetarët që janë sot në nevojë për këto shërbime. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit!

Grupi Parlamentar i AAK-së, deputeti Ardian Gjini e ka fjalën.

ARDIAN GJINI: Faleminderit, zoti kryesues!

Në Komision për Legjislacion kemi vendosur që ky ligj t'i procedohet seancës plenare, se i plotëson kushtet dhe se në parim mendojmë që duhet të kalojë, kështu do të veprojë edhe Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës, mirëpo mendojmë se me gjithë këtë punë të hartimit dhe kalimit të legjislacionit në Kuvend, të aprovimit, po ndërtohet një kulturë jo e mirë e punës. Prej nesh sot kërkohet që të shqyrtohet ndryshimi i ligjit, do të thotë që të ndryshohet ligji i cili nuk ka filluar të zbatohet, ka hyrë në fuqi, po nuk është zbatuar hiq. Edhe ministri, i cili në legjislaturën e kaluar ka qenë po ashtu zëvendëskryeministër dhe shef i ish ministres, nuk na tregoi pse nuk është zbatuar, domethënë ka gati 3 vjet që ka kalua ligji në Kuvend do të thotë dy vjet e gjysmë që është operacional ose i vlefshëm ligji dhe nuk është zbatua dhe në vend se të na thuhet pse nuk është zbatua ligji, pse nuk ka fillua të funksionojë sistemi i noterisë në Kosovë, po na thuhet se duhet përmirësuar edhe pak ligjin. Do të thotë, krejt e qartë se ka terminologji e cila ka mbetur në projektligj prej vitit 2007, ndoshta, që nuk ka qenë dashur të kalohet në legjislaturën e kaluar, por ka kaluar me shumicë të votave, mirëpo esenca është këtu - a po funksionon sistemi i noterisë, që është përgjigja - jo, pse nuk po funksionon, cilat janë problemet e mosfunksionimit, do të thotë, a është faji i ligjit, apo është faji i administratës apo i kujtdo tjetër, ose i cili do problem tjetër struktural që mund të ekzistojë në Kosovë. Këtu duhet ta dimë ne, cili është ky problem?

Mendoj se prapë ardhja e këtij projektligji kësi soji, nuk ka ardhur, nuk është pasojë ose rrjedhojë e një studimi të mirë, u tha më përpara nga parafolësja, shumë saktë, mirëpo prapë ka ardhur si një punë e thjeshtë e çorientuar e administratës, të cilën e përcjell Qeveria në Kuvend dhe prapë pas aprovimit të këtij ligji kemi drojë se do të hasim në probleme të njëjta. Sidoqoftë, ne mendojmë se ligji duhet të kalojë, në parim, për shkak se është prapë e saktë ajo që u tha më përpara, qëllimi ka qenë shkarkimi i gjykatave tona, të cilat ashtu - ashtu s'po mund t'i kryejnë punët e veta. Dhe, ne si Kuvend duhet të provojmë që t'i krijojmë këto kushte që të arrijmë deri në atë pikë. Prapë po them, nuk mendojmë se problemi bazë i mosfunksionimit ka qenë te ligji, mirëpo ka qenë te diçka tjetër që edhe u përmend më herët. Mendojmë se kemi hyrë në fazën e politizimit edhe të këtij sektori të zgjedhjes së njerëzve të cilët kanë për t'i kryer këto punë dhe detyrimisht po llogaritet edhe si sistem i punësimit edhe i krijimit të të hyrave për njerëz të caktuar.

Mendojmë se tani po kalon, në parim, gjithnjë duhet të jemi shumë të kujdesshëm që në procedurat e mëtutjeshme, jo vetëm të kalimit të ligjit, të amendamentimit nëpër

komisione, por edhe të operacionalizimit të funksionimit të noterisë në Kosovë të mos vijmë në situatën në të cilën do të kemi prapë një, më mirë është të them nepotizëm ose klientelizëm të skajshëm për shkak se mendojmë se një ndër arsyt pse kemi ardhur deri në këtë ditë, është se ka pas synime të ndryshme të çuditshme gjatë gjithë këtij procesi. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit!

Në emër të Koalicionit Kosova e Re, deputeti Ibrahim Makolli e ka fjalën.

IBRAHIM MAKOLLI: Faleminderit, zoti kryesues!

Edhe në kohën kur është miratuar ligji, që tash po i nënshtrohet një ndryshimi, është vlerësuar i një rëndësie të veçantë dhe me plotë të drejtë. Në Komision për Legjislacion e kemi trajtuar këtë projektligj dhe kemi vlerësuar që, përkundër sida mangësive që i ka, e vlen që të procedohet më tutje. Në parim, Grupi Parlamentar i Koalicionit për Kosovë të Re e mbështet këtë projektligj dhe, natyrisht, kontributin tonë do ta japim në procedurat e më tutjeshme në komisione. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit!

Grupi Parlamentar SLS, a e do fjalën? Sasha Rashiq, deputeti Rashiq e ka fjalën.

SAŠA RAŠIĆ: Hvala, gospodine predsjedavajući!

Parlamentarna grupa Samostalne liberalne stranke je razmotrila Zakon o izmeni i dopuni Zakona o beležništvu i shodno tome ovaj zakon je ispunio osnovne uslove da bude danas na razmatranje u Skupštini. Mi ćemo zakon podržati u načelu i sigurno svoj doprinos dati kroz funkcionalnu komisiju. Hvala!

KRYESUESI: Faleminderit!

Grupi Parlamentar “6+”, deputetja Duda Balje e ka fjalën.

DUDA BALJE: Parlamentarna Grupa „6+“ je razmatrala Nacrt zakona za izmenu i dopunu Zakona za notarstvo. Podržavamo Nacrt zakona jer ga smatramo vrlo potrebnim za stvaranje pogodnog okruženja za poslovanje u Republici Kosovo, koja je i osnovna suština ovog 9 - članog Nacrta zakona i ako smatramo da njegova implementacija neće biti ni malo laka.

KRYESUESI: Faleminderit!

Deputetë tjerë të paraqitur për të marrë fjalën lidhur me ligjin nuk ka. Përfaqësuesi i Qeverisë e ka të drejtën e vet dhe kohën e rezervuar. Urdhëroni, zoti Kuçi!

MINISTRI HAJREDIN KUÇI: Faleminderit, zoti nënkryetar i Kuvendit!

Të nderuar deputetë,

Faleminderit shumë për sugjerimet dhe vërejtjet. Që në fillim dua të them se ju falënderoj për mbështetjen në parim, por pajtohem me ndryshimet që mund të jenë më shumë se sa ato që janë paraparë në këtë projektligj. Natyrisht që ne do të marrim pjesë në mënyrë aktive në këto ndryshime dhe do të tentojmë që bëjmë sa më funksional këtë sistem, i cili është për herë të parë në Republikën e Kosovës, i cili krahas ndërmjetësimit të arbitrazhit, këtë vit do ta lehtësojë punën e gjykatave.

Më lejoni të jap edhe 2 – 3 sqarime lidhur me procesin e noterisë deri më tani. Unë pajtohem plotësisht që e tha zonjusha Haxhiu, ka pasur edhe telashe në mes të komisionit vendor dhe ndërkombëtar, këto telashe i kam vërejt që në ditët e para që jam bërë ministër dhe për këtë qëllim e kam ftuar Unioni Ndërkombëtar të Noterisë, që ka qenë në Kosovë kryetari i Unionit me sekretarin dhe dy anëtarë dhe vlerësimet për tekstet finale i kanë bërë ata dhe vlerësimet e tyre i kam njohur. E kam thënë publikisht dhe po e them, unë nuk do të nënshkruaj licenca për noteri ato që nuk i pranon Unioni Ndërkombëtar i Noterisë dhe kjo me qëllim, zoti Gjini, që t'i ikim nepotizmit, ndikimeve politike apo tjetër. Po ashtu ju njoftoj se unë nuk e kam ndryshuar komisionin vendor, me përjashtim të një anëtareje, e cila ka dhënë dorëheqje para se unë të bëhem ministër dhe e kam plotësuar. Nuk ka qenë qëllimi im që të ndryshoj, por ta bëjë funksional një sistem të tillë.

Unë pres shumë që ju të jepni mbështetjen tuaj, angazhimet dhe ta bëjmë funksional këtë sistem brenda këtij viti. E di që ligji dhe dinamika s'ka shkuar ashtu sikur kemi menduar në fillim të vitit 2008, ka pasur nevojë për trajnime, ka pas nevojë për seleksionime, por unë jam i bindur që këtë vit së paku do të fillojmë në 7 qendrat kryesore të Republikës së Kosovës dhe unë jam i bindur më pastaj do të kemi edhe në qytete të tjera. Jam shumë i vetëdijshëm që në fillim do të ketë lëshime, këto kanë ndodhur edhe me vendet e tjera, por jam shumë i vetëdijshëm që do ta kemi një kontroll të rreptë të sistemit të noterisë dhe për çdo lëshim eventual, ju lus edhe në ligj ta parashihni mundësinë e marrjes së licencës për ndonjë noter. Natyrisht që është një praktikë e re, por do të mundohemi ta marrim praktikën edhe nga vendet tjera. Për njoftimin tuaj, ju them se në komision është edhe kryetarja e Komisionit të Noterisë së Shqipërisë, duke dashur që të marrim një sistem të përafërt. Do të mundohemi dhe unë besoj që me këtë ligj, me plotësimet që i bëni ju, do të jetë më funksional. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit!

Tani radha është e deklarimit të deputetëve me votim për miratimin në parim të Projektligjit për ndryshimin dhe plotësim e Ligjit për noterinë.

Në sallë janë 82 deputetë.

Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim, votojmë tani:

Konstatoj që me 76 vota “për”, 6 “kundër” dhe asnjë abstenim, Kuvendi miratoi në parim Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për noterinë.

Kërkohet nga komisioni funksional dhe komisionet e përhershme që në afatin e paraparë me Rregulloren e Kuvendit, të shqyrtojnë Projektligjin dhe Kuvendit t’i paraqesin raportet me rekomandime.

Vazhdomë me pikën e pestë të rendit të ditës:

5. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për shërbimet e sigurisë private

Në bazë të nenit 56 të Rregullores së Kuvendit, komisioni funksional ka shqyrtuar projektligjin dhe Kuvendit ia ka paraqitur raportin me rekomandime, andaj janë përmbushur kushtet për shqyrtimin në parim të këtij projektligji.

Ftoj ministrin e Punëve të Brendshme, zotin Bajram Rexhepi, që në emër të Qeverisë së Republikës së Kosovës para deputetëve të Kuvendit ta prezantojë dhe arsyetojë projektligjin. Zoti Rexhepi, e keni fjalën!

MINISTRI BAJRAM REXHEPI: I nderuari kryesues i Kuvendit,

Zëvendëskryeministra, ministra,

Të nderuar deputetë,

Më lejoni të prezantoj para jush Projektligjin për shërbime të sigurisë private. Fillimisht ju njoftoj se edhe ky projektligj ka qenë në Kuvend, mirëpo me shpërbërjen e Kuvendit të Kosovës, i njëjti është kthyer edhe një herë për të siguruar miratimin e Qeverisë së re.

Nevoja për nxjerrjen e këtij projektligji është e një rëndësie të madhe për faktin se bën rregullimin ligjor të ushtrimit të veprimtarisë së sigurisë private dhe përcakton kushtet dhe kriteret për të ushtruar këtë veprimtari.

Në hartimin e këtij projektligji kanë qenë të përfshirë përfaqësues të shoqatave për sigurinë private, përfaqësuesit e misionëve ndërkombëtare në Kosovë, ku interesim të veçantë kanë shprehur përfaqësuesit e UNDP-së, ICO, EULEX-it dhe CITAP-it.

Projektligji adreson çështjet që kanë të bëjnë me subjektet afariste që merren me ushtrimin e veprimtarisë së sigurisë private. Format e ushtrimit të veprimtarisë së sigurisë private, dhënia dhe marrja e licencave për kompanitë private të sigurimit dhe punëtorët e sigurimit, standardet profesionale për ushtrimin e kësaj veprimtarie, trajnimet themelore të specializuara për punëtorët e sigurimit, mbajtjen e evidencave të subjekteve afariste dhe punëtorëve të sigurimit, si dhe kushtet për mbikëqyrjen dhe zbatimin e tij.

Projektligji ka 10 kapituj, me gjithsej 53 nene. Projektligji për shërbimet e sigurisë private ka implikime buxhetore, që vlerësohen të jenë përafërsisht rreth 36.700 euro për dy vite, pra 2011 deri 2012.

Të hyrat vetjake nga licencimi i kompanive private të sigurimit dhe punëtorëve të sigurimit vlerësohen të jenë rreth 40.000 euro për vitin 2011 dhe rreth 12.000 euro për vitin 2012.

Projektligji krijon stabilitet legjislativ për veprimtarinë të cilën e rregullon. Nga arsyet e lartcekura, propozoj që Kuvendi i Kosovës ta miratojë në parim Projektligjin për shërbimet e sigurisë private, në mënyrë që i njëjti t'iu nënshtrohet procedurave të mëtutjeshme. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zoti ministër!

Të nderuar deputetë,

Pas prezantimit të projektligjit, hapi debatin për diskutim, në parim.

Sipas radhës dhe rregullores, raportuesi i Komisionit funksional për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrjen e Forcës së Sigurisë së Kosovës, deputeti Rexhep Selimi e ka fjalën.

REXHEP SELIMI: I nderuar kryesues,

Komisioni për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrje të Forcës së Sigurisë së Kosovës, në bazë të nenit 56, paragrafi 2 të Rregullores së Kuvendit, në mbledhjen e mbajtur më 19 prill të vitit 2011, ka shqyrtuar në parim Projektligjin për shërbimet e sigurisë private dhe rekomandon që Projektligji për shërbimet e sigurisë private të miratohet, në parim. Sigurisht që projektligji ka nevojë të plotësohet dhe të amendamentohet gjatë procedurës së mëtutjeshme, por si komision vlerësojmë se i plotëson kushtet në miratim në lexim të parë dhe ju ftojme që ta procedoni duke e miratuar parimisht. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit!

Tani, sipas renditjes, kryetarët ose përfaqësuesit e grupeve parlamentare. Në emër të Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike të Kosovës, deputeti Fatmir Xhelili e ka fjalën.

FATMIR XHELILI: I nderuar kryesues,
Kabinet qeveritar,
Të nderuar kolegë deputetë,

Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike e ka shqyrtuar mirë këtë projektligj për shërbimin e sigurisë private dhe ka paraparë se ky projektligj i rregullon të gjitha aktivitetet në fushën e sigurisë private, me përjashtim të aktiviteteve të cilat përcaktohen me ligj për policinë dhe aktivitetet tjera të sigurisë që janë caktuar për institucione shtetërore. Ky projektligj rregullon mënyrat e ushtrimit të veprimtarisë të kompanive private, obligimet, detyrat, fushat e sigurisë si edhe normimet për pjesëtarë të saj. Gjithashtu, përcakton edhe relacionin me organin mbikëqyrës të zbatimit të normimeve me rastin e licencimit, por edhe ushtrimeve të aktiviteteve pas licencimit e më tutje. Ligji ka disa lëshime teknike, ka të meta në përkthim edhe në lekturim.

Grupi Parlamentar e përkrah në parim këtë projektligj, duke u obligua që në komisionin parlamentar do të kontribuojmë për t'i evituar këto të metat teknike dhe të tjera. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit!

Në emër të Grupit parlamentar të Lidhjes Demokratike, deputeti Anton Quni, e ka fjalën.

ANTON QUNI: Faleminderit, zoti kryesues!

Ne, deputetët e Lidhjes Demokratike të Kosovës, si anëtarë të Komisionit për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrje të FSK-së, në takimin e fundit të komisionit për çështjen në fjalë i kemi shprehur vërejtjet tona të cilat kanë të bëjnë me emërtimin e veprimtarisë për kufizimin më specifik të deficioneve kryesore, kategorizimin dhe radhitjen më të natyrshme të neneve, terminologjinë e veprimtarisë, organizimin e hierarkisë, përdorimin e pajisjeve adekuate, të drejtat dhe kompetencat e personelit, sanksionimin e shkeljeve dhe parregullsive, bashkëpunimin me institucione tjera të sigurisë, organizimin e shoqatave të shërbimit të sigurisë dhe të sindikatave e të tjera.

Ne, si Lidhje Demokratike e Kosovës do të ofrojmë ekspertizën tonë në këtë fushë që ky ligj të jetë funksional, i zbatueshëm dhe me standarde më të larta të Konfederatës Evropiane për shërbimet e sigurisë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit!

Në emër të Grupit Parlamentar “Vetëvendosje”, deputeti Rexhep Selimi.

REXHEP SELIMI: I nderuar kryesues,
Të nderuar deputetë,

Do të fokusohem në dy tema të veçanta, duke qenë bashkë me të gjithë kolegët tjerë në punë e sipër në komisione për këtë çështje, por do të fokusohem që të jap sugjerimet apo

vërejtjet tona në dy çështje kryesore, me këtë rast, siç është trajnimi dhe armatimi për këto kompani.

Numri i punëtorëve të sigurimit themelor, si quhet me ligj tani, aktualisht është rreth 4000 apo saktësisht 3992 punonjës, por ky numër do të rritet pas miratimit të këtij ligji, sepse do të përfshihen edhe ata që tani janë të regjistruar apo punojnë nëpër institucione tjera si, për shembull, nëpër depo të ndërtimtarisë, nëpër supermarkete, nëpër objekte hoteliere, pastaj edhe si sigurim në aeroport, postë e të tjera. Pra, ligji parasheh që punëtorët e licencuar, pavarësisht nga kompanitë, si dhe përcakton se të gjithë punëtorët e sigurimit duhet të kalojnë nëpër një trajnim themelor, mirëpo ky ligj nuk përcakton se ku duhet të kryhet ky trajnim. Aktualisht janë mbi 90 kompani të sigurimeve të regjistruar në Kosovë, apo saktësisht 45 të licencuara, shumica e tyre nuk kanë as zyrë, e lëre më ndonjë hapësirë për trajnim të punëtorëve. Shumica e kompanive ua marrin punëtorëve të hollat për kinse trajnimin e tyre, por në fakt nuk u ofrojnë asgjë konkrete, as aftësim dhe as aftësi për vetëmbrojtje. Nëse kjo praktikë vazhdon, organet kompetente do të kenë problem me zbatimin e detyrimit për testim profesional, sepse do të jenë mbi 60 lloje të trajnimeve veç e veç.

Punëtorët e shërbimeve të specializuara të sigurisë, siç janë: truprojat, rojet e transportit të parave të gatshme apo të gjërave me vlerë duhet të kryejnë trajnim në qendrat e specializuara, mirëpo numri i këtyre punëtorëve është shumë i ulët për të ndikuar në nivelin e përgjithshëm të cilësisë së trajnimeve.

Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë është organ kompetent për licencimin e institucioneve për trajnime profesionale, siç thuhet këtu, për shkolla profesionale, ndërsa Ministria për Punë të Brendshme do të jetë e ngarkuar, sikur parasheh ky ligj, për miratimin e programeve për trajnim. Në këtë mënyrë do të garantohej cilësia e trajnimit, sepse Ministria e Arsimit do të miratojë infrastrukturën, nivelin akademik të trajnimeve, kushtet e mësimin e të tjerë, kurse Ministria e Punëve të Brendshme do të miratonte përmbajtjen e këtyre programeve. Përveç kësaj, mbikëqyrja dhe organi kompetentë do ta kenë më të lehtë, sepse do të ketë adresë për mbikëqyrje, do të ketë adresë për të ndikuar në përmbajtjen e teksteve, mënyrës së trajnimeve e të tjera.

Sa i përket armatimit për këto kompani, Ligji për armët, si dhe Ligji për sigurinë private lejojnë armë gjysmë automatike vetëm për sigurinë e afërt trupor, siç janë truprojat dhe për transportin e parave. Por, ky trajnim le të pambrojtur objektet e rëndësisë së lartë për sigurinë kombëtare, për shembull, pendën e Batllavës, e cila nëse shkatërrohet, do të ketë pasoja të paparashikueshme, apo pendën e Badovcit, e cila qëndron mbi Graçanicë dhe fshatra tjera, apo objekte të Forcës së Sigurisë së Kosovës, apo objekte të institucioneve qeveritare, që sipas ligjit, këtij ligji, do të duhej të sigurohen nga kompanitë private për të lejuar policinë dhe FSK-në që të merret me punët e tyre profesionale, apo depot e armatimit dhe të municionit, të cilat licencohen sipas Ligjit për armë, të cilat sipas këtij ligji do të sigurohen me roje të paarmatosura, pra depot e armëve të sigurohen me personel të paarmatosur, kjo nuk qëndron. Apo objekte të tjera, siç janë termocentralet, të cilat në rast sabotimi mund të paraqesin rrezik të përgjithshëm për vendin. Të gjitha këto objekte për momentin janë duke u siguruar me personel të paarmatosur. Mendoj që ky

ligj duhet të parashihet që këto objekte të rëndësishme të veçantë të sigurohen me personel të armatosur, të përgatitur dhe të licencuar. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit!

Në emër të Grupit parlamentar të AAK-së, deputeti Burim Ramadani, e ka fjalën.

BURIM RAMADANI: Faleminderit, kryesues!

Të nderuar deputetë,

Projektligji për shërbimet e sigurisë private vlerësohet prej Grupit Parlamentar të AAK-së si prej më të rëndësishmit gjatë kësaj periudhe, edhe pse e dimë që ka pasur një odisejadë të gjatë të kthimit dhe rikthimit të këtij projektligji në periudhën e kaluar. Ky projektligj i paraqitur sot, normalisht, do të përkrahet në parim nga Grupi Parlamentar i Aleancës, megjithëse shohim një varg të metash, të paqartësive dhe të mungesës së kufizimeve të nevojshme brenda projektligjit. Në përgjithësi, vërejtjet tona kanë të bëjnë me qartësimin e mekanizmave mbikëqyrës, licencimin e punëtorëve, me Komisionin për Ankesa, përkatësisht me përbërjen e Komisionit për Ankesa, pra duhet që neni 8 në këtë rast të precizohet dhe të largohet Ministria e Punëve të Brendshme edhe nga licencimi, edhe nga shqyrtimi i ankesave. Po ashtu, duhet të ketë mbikëqyrje tjetër ose më precize të zbatimit të standardeve profesionale për kompanitë e sigurimeve private, por po ashtu edhe punëtorët e atyre kompanive. Duhet të ketë patjetër edhe përkufizim të moshës së punëtorëve në këto kompani, pra ka vetëm përcaktim të moshës, të moshës 18 vjeçare, por nuk ka përkufizim se deri në çfarë moshe mund të jenë aktiv, pra nuk duhet të lihet e pakufizuar, pra neni 16 duhet të ketë riformulim. Pa dashur t'i përsëris ato që kolegët tjerë i thanë, po dalë te neni 29, përdorimi i forcës, që vërtetë është një përkufizim ose formulim jo fortë i pranueshëm, ku flitet për përdorimin e forcës fizike, pajisje të sigurisë edhe armës së autorizuar, por thuhet që kjo nuk kufizohet vetëm me këto, ka mundësi edhe tjera edhe megjithatë ka dilema se cilat janë mundësitë tjera të përdorimit të forcës.

Tek uniforma, po ashtu duhet të ketë riformulim dhe ajo që është tepër me rëndësi, të përcaktohet më qartë koordinimi i punës mes këtyre kompanive dhe agjencive tjera të zbatimit të ligjit, në rend të parë me Policinë e Kosovës, por po ashtu duhet të ketë koordinim ose përcaktim të koordinimit edhe me Agjencinë Kosovare për Inteligjencë, që mund të futet brenda kësaj fushe.

Grupi Parlamentar do ta votojë, në parim, dhe normalisht do të vazhdojmë me kontributin tonë në përmirësim e këtij projektligji. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit!

Grupi Parlamentar Koalicioni Kosova e Re, sipas radhës, deputeti Gëzim Kelmendi.

GËZIM KELMENDI: Faleminderit!

I nderuar kryetar,

Kryesues i nderuar,

Zëvendëskryeministra dhe ministra,

Kolegë deputetë të nderuar,

Duke ju kursyer nga koha e juaj e çmuar, unë nuk do të ndalem, do të thotë në këto, ku veç kolegu i nderuar paraprak i shtjelloi rreth çështjes, por do të ndalem më shumë te neni 18, ku parashihet përvoja trevjeçare për t'u specializuar në fushën e sigurimit. Mendojmë që kjo përvojë trevjeçare është pak sa e gjatë dhe më shumë e kufizon apo e limiton numrin, ritjen e kuadrove të specializuara në çështjen e sigurisë private. Përveç kësaj, do të thotë te neni 18 dhe te paragrafi 4, ku shihet se emërimi i operatorit në fushën elektronike, duhet të jetë mbi moshën 21 vjeçare. Edhe këtë rast, pasi që mosha në këtë fushë nuk është relevante, kërkojmë që deri në shqyrtimin e dytë, Komisioni për Punë të Brendshme dhe Siguri t'i marrë parasysh sugjerimet dhe vlerësimet tona dhe në parim në si grup parlamentar, e kalojmë këtë projektligj.

KRYESUESI: Ju faleminderit!

Në emër të Grupit Parlamentar SLS, deputeti Goran Marinković.

GORAN MARINKOVIĆ: Poštovani gospodine predsjedavajući!

Poslanička grupa Samostalne liberalne stranke u načelu podržava Zakon usluga privatne bezbednosti i daće svoj doprinos u radu preko funkcionalnih komisija u kojima učestvuje. Hvala!

KRYESUESI: Ju faleminderit!

Në emër të Grupit Parlamentar "6+", Rasim Demiri.

RASIM DEMIRI: Poštovani predsjedavajući,

Parlamentarna grupa „6+“ je vršila razmatranje Nacrta zakona o uslugama privatnog obezbeđenja i smatra ga za potrebnim i daće svoj doprinos za njegovo usvajanje i implementiranje.

KRYESUESI: Ju faleminderit!

Në emër të grupeve parlamentare u deklaruan të gjithë, tani radha është e deputetëve. I paraqituri i parë është deputeti Haki Demolli.

HAKI DEMOLLI: Ju faleminderit!

I nderuar kryesues i Kuvendit,

I nderuar Kabinet qeveritar,

Të nderuar deputetë,

Në esencë mendoj se Projektligji për shërbimet e sigurisë private është një projektligj mjaft mirë i strukturuar sikurse në aspektin përmbajtjesor, ashtu edhe në aspektin tekniko-juridik.

Kur lexohet me vëmendje ky projektligj, atëherë shihet se ai thjesht është një përkthim i drejtpërdrejtë nga gjuha angleze dhe të vetmet mangësi që paraqiten në këtë projektligj, kanë të bëjnë me terminologjinë e përdorur, respektivisht me disa formulime të cilat vërtet kanë qenë të vështira për t'u përkthyer nga gjuha angleze në gjuhën shqipe si dhe me përdorimin e disa shprehjeve të cilat nuk janë aq profesionale. Kështu për shembull, në nenin 10 dhe 15 të projektligjit, përdoret shprehja "*kontrolli i së kaluarës*" ndërsa në nenin 11, për të njëjtën çështje, përdoret shprehja "*verifikim i së*

kaluarës” që personalisht mendoj se më e qëlluar është shprehja: “verifikim i së kaluarës, andaj kërkoj që, në sesionin e dytë, respektivisht në dëgjimin e dytë, i tërë ligji ta ketë një terminologji të njëjtë për çështje të njëjta. Ndërsa, në nenin 34, përdoret shprehja: “nëse ka ndodhur një veprë penale”, e ne e dimë se veprat penale nuk ndodhin, por ato kryhen, kurse në një nen tjetër paraparak ka shprehjen: “kryerja e veprës penale”, prandaj mendoj se edhe këtu duhet të harmonizohet terminologjia dhe të kemi shprehje të njëjta për çështje të njëjta.

Dhe, në fund mendoj se në rastet kur kemi përkthime të ligjeve nga gjuhët e tera cilado qofshin ato, mirë është që të përdoret terminologjia unike, respektivisht mos të shkohet në përkthimin të ashtuquajtur bukval, sepse mund të ndodhë që të jetë i pakuptimtë siç është rasti me nenin 29, pika 5, të cilin në njëfarë mënyre e përmendi edhe kolegu Burim Ramadani. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit!

Shpresoj që gjatë amendamentimit do të jepet kontributi për amendamentimin e ligjit. Deputeti Imri Ahmeti e ka fjalën.

IMRI AHMETI: Ju faleminderit, kryesues!

Kabinet qeveritar,
Kolegë deputetë,

Fillimisht mbetem në qëndrimin e Grupit Parlamentar të LDK-së që mbështet në parim a këtë projektligj, megjithatë më lejoni shkurtimisht vetëm disa çështje të cilat mendoj t’i jap kontribut në drejtim të harmonizimit të disa neneve të cilat vlerësoj që janë në kundërshtim njëri me tjetrin brenda vetë ligjit, por edhe me ligjet dhe dispozitat tjera.

Fillimisht te neni 7, te kompetencat e Divizionit, janë të përziera me kompetencat e Agjencionit për Standardizime, kështu që neni 7, pika 1.5 është në kundërshtim me nenin 9, pika 2, ku thuhet se: “standardet aprovohen nga Agjencioni Kosovar për Standardizime”, ndërkah, në nenin 7, pika 1.5 thotë: “këtë e bënë Divizioni pranë Ministrisë së Punëve të Brendshme”, do të thotë është në kundërshtim njëra me tjetrën.

Në nenin 22, pika 2 thotë: “organi kompetent” (kjo është shumë me rëndësi mendoj) organi kompetent këtë autorizim e jep apo e refuzon mbështetur në vlerësimin e kërcënimit që kryhet nga organi kompetent përmes njësisë të vlerësimit të kërcënimit nga Policia e Kosovës, që është krejt në rregull, por menjëherë neni 7, te kompetencat e Divizionit, pika 1, pika 14 thuhet: “Divizioni siguron kryerjen e vlerësimit të sigurimit të kërcënimit për personat që sigurohen. Mendoj që neni 7, pika 1.14 duhet të fshihet në tërësi.

Te nenet 46, 45 dhe 47, cilësohen shkeljet si kundërvajtje. Është praktikë që me ligj nuk mund të determinohen as të kualifikohen as të cilësohen asnjë lloj shkelje, qoftë si veprë penale, qoftë si kundërvajtje apo dënim me gjobë, sepse kjo është e përcaktuar me ligjet bazike dhe në procedurat e mëtutjeshme të ankimimit përmes organeve të gjyqësorit, përcaktohet niveli i shkeljes, a është veprë penale apo është dënim me gjobë apo kundërvajtje.

Në të njëjtën kohë e vlerësoj që nenet 49 dhe neni 52 janë në kundërshtim njëri me tjetrin. Neni 49 thotë se pas hyrjes në fuqi të këtij ligji nuk lëshohet asnjë licencë me Rregulloren e UNMIK-ut që është në fuqi, ndërsa neni 52 thotë: me hyrjen në fuqi të këtij ligji, çdo legjislacion tjetër sekondar që është në fuqi dhe që rregullon kompanitë e licencuara për sigurim, nuk duhet të zbatohet. Do të thotë është e duplikuar një normë njëra me tjetrën, e rregullojnë të njëjtën materie.

Llogaris që edhe një praktikë duhet të ndërpret tek përpilimi i ligjeve dhe kështu që janë sjellë, sepse nga 53, në 23 nene përmendet një pikë e njëjtë dhe thuhet kështu: “Organi kompetent, me aktet nënligjore rregullon procedurat e materies në vijim e tjera e tjera. Ndërsa, krejt tek neni i fundit, thuhet në nenin 50, te dispozitat kalimtare i lihet afati gjashtëmujor Ministrisë që të nxjerrë aktet nënligjore për zbatimin e këtij ligji. Mjafton neni 50 dhe nuk ka pasur nevojë që në 20 pika të neneve, të përmendet e njëjta formulë, prej a, domethënë e saktë e njëjta formulë.

Unë për të mos marrë kohë më tutje, besoj që edhe ne do të japim kontributin brenda komisioneve funksionale dhe e mbështesim në parim këtë projektligj. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit!

Fjalën e ka deputetja Hykmete Bajrami.

HYKMETE BAJRAMI: Ju faleminderit, zoti kryesues!

Unë dua ta shpreh një kërkesë e cila u përmend nga shumë parafolës, por nuk është specifike vetëm me këtë projektligj që po e diskutojmë tani, por në të gjitha projektligjet që vijnë për të kaluar në këtë Kuvend.

I kam lexuar të gjitha projektligjet që i kemi sot për diskutim dhe në shumë raste, domethënë kur lexoj, lexoj versionin në gjuhën shqipe, në shumë raste po të mos e kisha konsultuar versionin në gjuhën angleze apo gjuhën serbokroate, ka vështirësi në kuptimin e asaj se çka është dashur të thuhet. Kështu që unë kërkoj nga sponzorizuesi i ligjeve, që është Qeveria në rastin tonë që të investojë më shumë kohë dhe resurse në përpunimin gjuhësor të ligjeve. Kuvendi, të mos jetë Kuvendi ai i cili merret me korrekte gjuhësore. Është turp kur e lexon një ligj në gjuhën shqipe dhe nuk e din se çka është domethënia e tij në nene apo në paragraf të ndryshëm. Kështu që kjo bëhet një praktikë nga ana e Qeverisë dhe të mos merremi ne me korrekte gjuhësore, por ta japim kontributin tonë në përmbajtje të ligjeve. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit!

Deputeti Gjini e ka fjalën!

ARDIAN GJINI: Ju faleminderit, zoti nënkryetar i Kuvendit!

Vetëm sa për të mos kaluar pa u shënuar, kemi diskutuar për këtë temë edhe në legjislaturën e kaluar, por po thuhet vazhdimisht dhe po përmendet edhe prej deputetëve se titulli i ligjit është Projektligji për shërbimet e sigurisë private. Tani ne e kemi fjalën për shërbime private për siguri edhe qysh kemi diskutuar edhe më përpara, mendoj se

duhet filluar të jemi pak më të saktë, edhe pse nuk është çështja më e rëndësishme ndoshta për projektligj, por prita që po e thotë dikush në pjesë tjera, do të thotë kemi të bëjmë me Projektligjin për shërbime private të sigurisë. Shërbimi i sigurisë private mundet të nënkuptojë diçka tjetër, prapë po them edhe nuk është më e rëndësishmja, ndoshta dikush në Ministri ka qenë dashur, pasi që e kanë lexuar 50 herë, t'i bjerë në fije. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit!

Nuk ka tjerë të paraqitur. Përfaqësuesi i Qeverisë e dëshiron fjalën.

Zoti Rexhepi e ka fjalën.

MINISTRI BAJRAM REXHEPI: Desha t' i falënderoj të gjithë deputetët edhe në emër të grupeve parlamentare, të Komisionit funksional për sugjerimet që i bënë për këtë projektligj, me qëllimin më të mirë që ky ligj me të vërtetë të jetë sa më funksional, sa më praktik dhe më i zbatueshëm. I dëgjova një varg sugjerimesh dhe nuk e kam ndërmend këtu tash të bëjë sqarimet e duhura për arsye se ekipi ynë nga Ministria do të jetë pjesëmarrës i drejtpërdrejtë me komisionet funksionale që autorizohen që të punojnë në përgatitjen për leximin e dytë, po të them një se ish ministri, deputeti Demolli ne të gjithë e dimë se shumica e ligjeve janë të përkthyer, as ne nuk jemi imun si shtet dhe aq më parë kur duhet t' i harmonizojmë me asquis communautaire, pra shumica janë të përkthyer nga anglishtja dhe nganjëherë çdo shtet i adapton pak specifikat e veta, përndryshe asnjë shtet nuk i prodhon prej fillimit këto ligje, ndërsa lëshimet gjuhësore, kjo është dobësi e të gjithëve. Është mirë që të kemi lektorë e të kemi njerëz që dinë t' i rregullojnë, mirëpo mundësitë buxhetore tonat nuk janë të tilla, e më mirë t' i koncentrojmë këtu në Kuvend t' i korrigjojmë.

Sa i përket trajnimeve, për momentin e kemi vetëm Qendrën për Siguri Publike, Edukim dhe Zhvillim në Vushtrri, që mund të ofrojë edhe si objekt, por edhe si kapacitet njerëzor, por në të ardhmen edhe nëse është ndonjë kompani private që mund të ofrojë trajnime që kërkojnë në bazë të ligjit, mund të bëjë një gjë të tillë dhe nëse ka nevojë, mund të angazhojnë edhe ekspertë nga jashtë për këtë. Ndërsa, po ashtu është shqetësimi për objekte të karakterit strategjik nacional siç është penda e ato tjera, sigurisht që duhet të mendohet se a mund të jenë kompanitë private të sigurimit ato që mund ta bëjnë mbikëqyrjen apo duhet institucionet shtetërore. Këto janë çështje që Këshilli për Siguri Kombëtare mund të merr qëndrimin lidhur me atë. Edhe një herë falënderohem për të gjitha sugjerimet që janë bërë dhe qëllimi ynë është që ta kemi një ligj sa më funksional dhe më praktik të zbatueshëm. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit!

Në vazhdim kërkohet deklarimi me votim për miratimin në parim të Projektligjit për shërbimet e sigurisë private.

Në sallë janë prezentë 84 deputetë. Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim. Votojmë, tani. Ju faleminderit!

Konstatohet që me 80 vota "për", 1 abstenim, Kuvendi miratoi në parim Projektligjin për shërbimet e sigurisë private.

Kërkohej nga komisioni funksional dhe komisionet e përhershme, që në afatin e paraparë me Rregulloren e Kuvendit, ta shqyrtojnë Projektligjin dhe Kuvendit t'i paraqesin raportet me rekomandime.

Vazhdojmë me pikën e gjashtë të rendit të ditës:

6. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për shoqëritë tregtare

Në bazë të nenit 56 të Rregullores së Kuvendit, komisioni funksional ka shqyrtuar Projektligjin dhe Kuvendit i ka paraqitur raportin me rekomandime, andaj janë përmbushur kushtet për shqyrtimin në parim të këtij projektligji.

Ftoj ministren e Tregtisë dhe Industrisë, zonjën Mimoza Kusari -Lila, që në emër të Qeverisë së Republikës së Kosovës, para deputetëve të Kuvendit ta prezantojë dhe arsyetojë projektligjin.

MINISTRJA MIMOZA KUSARI- LILA: Ju faleminderit!

I nderuar kryesues,

I nderuar zëvendëskryeministër,

Të nderuar ministra,

Të nderuar deputetë,

Më lejoni që shkurtimisht të paraqes qëllimin, rëndësinë, fushën e rregullimit dhe përmbajtjen e Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 02-L-123 për shoqëritë tregtare. Arsyeja për ndryshimin e ligjit, është e objektivave të Qeverisë së Kosovës, në lehtësimin e procedurave në fushën e regjistrimit dhe fillimit të punës së bizneseve, si dhe bërjen e këtij ligji më praktik dhe të zbatueshëm. Ky projektligj është harmonizuar me ligjet tjera në fuqi, andaj edhe ndryshimet dhe plotësimet në këtë ligj u janë përshtatur legjislacionit të avancuar, sa i përket shoqërive tregtare.

Ndryshimet themelore të cilat janë propozuar për ndryshim në ligjin aktual janë:

- Me Rregulloren e UNMIK-ut, nr. 2008/26, të nënshkruar nga PSSP, me të cilin është bërë shpallja e këtij ligji, në dispozitat shfuqizuese, është shkaktuar konfuzion se cili ligj është në fuqi, duke marrë parasysh se kjo rregullore ka mbajtur në fuqi edhe dispozitat e Rregullores së UNMIK-ut, 2001/6 si ligji i parë në këtë fushë, ndërsa janë në kundërshtim me ligjin aktual.

- Janë hequr taksat për regjistrimin fillestar të biznesit dhe janë shpejtuar dhe thjeshtësuar procedurat e regjistrimit të biznesit,
- Janë harmonizuar afatet kohore procedurale në harmoni me Ligjin mbi procedurën administrative dhe në disa raste, me qëllim ekspeditiviteti janë përcaktuar afate shumë të shkurtra dhe optimale me qëllim të efikasitetit në punë edhe ndaj palëve.

- Është përcaktuar mosha minimale e personave fizik që kanë të drejtë të jetë themelues apo edhe agjentë tregtar, e që nuk ka qenë e paraparë më herët.
- Është bërë përcaktimi i saktë i përkufizimit - person juridik dhe anëtar i ngushtë i familjes,
- Janë përcaktuar të drejtat e palëve të pakënaqura në rastet ndaj zyrtarëve të Agjencionit në procedurë të ankesave,

Te shoqatat me përgjegjësi të kufizuar kemi shlyer obligimin për kapital fillestar të shoqëritë aksionare nga 25.000 euro, e kemi zvogëluar në kapitalin në 10.000 euro, duke hequr obligimin që pagesa t'i dëshmohet Agjencisë e cila ka qenë një barrierë e panevojshme. Kemi hequr obligimin e dorëzimit të raporteve vjetore pasi që bizneset kanë obligim të dorëzojnë raporte financiare dhe kjo është kompetencë e institucioneve tjera dhe rregullohet me ligje tjera, siç është Ligji për raportimin financiar të ndërmarrjeve.

Me rastin e përfundimit të regjistrimit, shpërbërjes vullnetare apo bashkimit, kemi inkorporuar obligimin që të dëshmohet me dëshmi nga Administrata Tatimore se subjekti ka përmbushur të gjitha obligimet tatimore.

Regjistrimi i ndërmarrjeve publike, të cilat kanë përfunduar procedurën e korporatizimit të cilat janë transformuar në korporata dhe regjistrimin e kooperativave bujqësore në bazë të nenit 2 të Ligjit nr. 2003/9, Ligji për kooperativat e bujqve dhe Rregullores së UNMIK-ut, nr. 2003/21.

Në nenin 184 të ligjit në fuqi, pas paragrafit 184.4, me propozimin e USAID-it, shtohen edhe 4 paragrafë të tjerë, neni 17, paragrafi 3 i Projektligjit për shoqëritë tregtare.

Ndryshimet dhe plotësimet në Ligjin për shoqëri tregtare dhe rregullimi juridik i tij, është në të njëjtën kohë edhe një premisë për rritjen e besueshmërisë së qytetarëve, mbështetjen e fuqishme të biznesit kosovar si dhe lehtësime për investitorë nga jashtë për të ushtruar biznese nga jashtë për të ushtruar biznese në Kosovë.

I nderuar kryesues,

Të nderuar deputetë,

Duke qenë të vetëdijshëm për rëndësinë e këtij projektligji dhe duke pasur parasysh nevojën e avancimit të kuadrit ligjor në lëmin e ekonomisë në përgjithësi dhe nevojën e krijimit të një mjedisi më të favorshëm afarist në Republikën e Kosovës, ngritjen e pozitës së Kosovës në nivel më të lartë ndërkombëtar në bërjen biznes, ju rekomandoj që këtë projektligj ta shqyrtoni dhe miratoni në këtë seancë plenare. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit!

Të nderuar deputetë,

Tani e hapi debatin për diskutim, në parim.

Kryetari i Komisionit funksional për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri, deputeti Zenun Pajaziti e ka fjalën!

ZENUN PAJAZITI: Ju faleminderit, zoti kryesues!

Kabinet qeveritar,

Të nderuar deputetë,

Komisioni për Zhvillim, Ekonomi, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri, në bazë të nenit 56, paragrafi 2 të Rregullores të Kuvendit, në mbledhjen e mbajtur me datë 26.4.2011 e ka shqyrtuar në parim këtë projektligj për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit, nr. 2-L-123 për shoqëritë tregtare dhe ju njoftoj se nuk kemi arritur të bëjmë një rekomandim pozitiv për ta votuar tani këtë ose për ta çuar përpara këtë projektligj.

Po ashtu, më lejoni t'ju njoftoj që ky propozim ose projektligj për ndryshimin e ligjit në fjalë, i ka plotësuar të gjitha kushtet tjera pra në aspektin formal-juridik. Po ashtu kemi pasur një rekomandim pozitiv nga Divizioni për Standardizim, Harmonizim Ligjor të Kuvendit dhe po ashtu është në procedurë pozitive ose si t'i thuash në përputhje me Raportin e progresit të Komisionit Evropian. Megjithatë, dëshiroj t'ju përsëris se nuk kemi arrit të bëjmë një rekomandim pozitiv nga ana e Komisionit. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit!

Tani është radha e përfaqësuesve të grupeve parlamentare, përkatësisht kryetarëve ose të ngarkuarve. Ju lus që të paraqiten në elektronikë ata që e kërkojnë fjalën, që të mos ngatërrohen.

Në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së, fjalën e ka prapë Zenun Pajaziti.

ZENUN PAJAZITI: Ju faleminderit, zoti kryesues!

Meqenëse, siç u thashë, në emër të Komisionit nuk kemi arritur të bëjmë rekomandim pozitiv, ka qenë votim i barabartë, më lejoni t'ju them që në gjithë këtë debat dhe në punën që e kemi bërë edhe në bashkëpunim me Ministrinë, e falënderoj ministrin që ka gjetur kohë në takimin përkatës të Komisionit, të vijë dhe të jap sqarime të nevojshme, nuk kemi arritur të gjejmë ndonjë arsye që ky projektligj në esencë është në kundërshtim me principet themelore të tregut të lirë ose të kriterëve të BE-së, ose të ndonjë agjende që ka për bazë zhvillimin ekonomik të vendit. Është konstatuar se ndryshimet eventuale që janë paraqitur, nuk janë të nevojshme nga disa deputetë. Ne plotësisht mendojmë që në leximin e dytë të ketë hapësirë të mjaftueshme dhe ne ofrojmë bashkëpunimin e plotë të gjithë deputetëve edhe në Komision edhe në bashkëpunim të plotë edhe me përfaqësuesit e Ministrisë dhe ministren vetë, në mënyrë që në leximin e dytë të bëjmë ndryshime edhe më të mëdha, nëse janë të nevojshme në mënyrë që ta procedojmë përpara këtë projektligj.

Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike të Kosovës, në parim i mbështet këto ndryshime, këtë projektligj dhe po ashtu i fton të gjithë deputetët që ta mbështesin ose ta aprovojnë këtë projektligj. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit!

Në emër të Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike të Kosovës, deputeti Lutfi Zharku.

LUTFI ZHARKU: I nderuar kryesues,
Zëvendëskryeministra,
Të nderuar ministra,
Kolegë deputetë,

Më lejoni që shkurtimisht të paraqes disa nga vërejtjet tona në Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për shoqëritë tregtare. Së pari dua t'ua përkujtoj se ashtu siç e tha edhe kryetari i Komisionit, plot 11 muaj më parë, gjegjësisht në seancën plenare të 27 majit 2010, ky projektligj ka kaluar, ky projektligj plotësisht i njëjtë me këtë që po e shqyrtojmë sot, është aprovuar në lexim të parë nga Kuvendi i Kosovës. Më pastaj Komisioni funksional ka punuar në plotësimin e këtij ligji, me vërejtjet e deputetëve nga leximi i parë si dhe në bashkëpunim me MTI, me rekomandimet e dhëna në bazë të studimeve dhe raporteve të ndryshme mbi ambientin e biznesit e posaçërisht raportin e Bankës Botërore të bërit biznes 2010, e që kanë të bëjnë posaçërisht me indikatorin e fillimit të biznesit si dhe mbrojtjen e investitorëve të cilët e renditin vendin tonë në pozitë tejet të pavoritshme. Për shkak të zhvillimeve politike që dihen, projektligji ka mbetur pa u shqyrtuar në lexim të dytë.

Duke pasur parasysh rëndësinë e këtij ligji për ekonominë në përgjithësi, e posaçërisht për përmirësimin e ambientit për biznes, ne kemi pritur që ky projektligj të pasurohet me vërejtjet e deputetëve që janë dhënë gjatë leximit të parë në mandatin e kaluar si dhe plotësimet e bëra nga Komisioni funksional. Por ne sot po e përsërisim të njëjtën punë që e kemi kryer para një viti, sepse projektligji që po e shqyrtojmë sot, nuk përmban pothuajse asnjë dispozitë më shumë se ai para një viti.

Ne i përkrahim propozimet e mëhershme që kanë të bëjnë me heqjen e taksave për regjistrimin e bizneseve, shpejtimin dhe thjeshtimin e procedurave për regjistrimin e bizneseve, heqjen e obligimit për deponimin e kapitalit fillestar për regjistrimin e shoqërive në epërsi të kufizuar, harmonizimin e afateve kohore me Ligjin mbi procedurën administrative si dhe shkurtimin e tyre, përcaktimin e moshës minimale për themelimin e biznesit, përcaktimin e obligimit ligjor, për autorizimet e legalizuara, saktësimin e përkufizimeve të personit juridik dhe anëtari i ngushtë i familjes, të drejtat e palëve, kundër vendimeve të ARBK-së, zvogëlimin e kapitalit fillestar për themelimin e shoqërive aksionare si dhe heqjen e obligimit për dorëzimin e raporteve vjetore në ARBK.

Megjithatë, ne mendojmë se projektligji i propozuar nuk përmbush nevojat për përmirësimin substancial të ambientit të biznesit e posaçërisht atë të mbrojtjes së investitorëve, gjegjësisht mbrojtjes së aksionarëve të vegjël. Duke marrë parasysh se në këtë fushë vendi ynë radhitet në pozitë të palakueshme plotësimi i këtij projektligji me dispozitat të cilat rregullojnë këtë materie, është i pashmangshëm. Këto plotësime duhet të përfshijnë aprovimin nga ana e aksionarëve të transaksioneve që përmbajnë konflikt të interesit, obligimin e menaxhmentit për bërjen publike për aksionarët të informatave mbi blerësit dhe furnitorët, të drejtën e aksionarëve të vegjël për caktimin e

një auditori të jashtëm për rishikimin e transaksioneve nga të cilat janë dëmtuar, përfshirë mundësinë për anulimin e tyre si dhe kërkimin e përgjegjësisë nga Bordi i drejtorëve për të gjitha transaksionet të cilat i kanë dëmtuar aksionarët e vegjël.

Plotësimi i projektligjit me dispozita që rregullojnë fushën e mbrojtjes së investitorëve është i domosdoshëm para se mjeti të procedohet më tutje. Duk i marrë parasysh të gjitha këto vërejtje si dhe bazuar në debatin brenda Komisionit funksional dhe rekomandimin e tij, ne propozojmë që projektligji të kthehet në ripunim dhe të plotësohet me vërejtje dhe rekomandime të deputetëve.

Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit!

Në emër të Grupit Parlamentar Vetëvendosje, deputeti Visar Ymeri e ka fjalën!

VISAR YMERI: I nderuar kryesues,

Të nderuar deputetë,

Për mos ta zgjatur shumë për shkak se këtu edhe disa vërejtje u thanë nga parafolësit, unë desha ta ngre edhe një çështje që ka të bëjë me këtë ligj, e që është domethënë kryesisht përqendrohet në këto ndryshime që kanë ardhur nga Ministria për Tregti dhe Industri, e që ka të bëjë me shkurtimin e afateve. Them një prej ndryshimeve substanciale të këtij ligji, është shkurtimi i afateve, qoftë për regjistrimin e biznesit apo edhe për shqyrtimin e ankesave që mund të kenë bizneset e vogla apo të mesme drejtuar organeve të Qeverisë së Kosovës, që e trajtojnë këtë fushë.

Edhe në Komisionin për Zhvillim Ekonomik e kam ngritur këtë çështje si në formë të pyetjeje ministres, nëse këto afate janë realiste, pra ky shkurtim i afateve është realist dhe, nëse Ministria i ka kapacitetet, qoftë të ndërtuara apo në ndërtim e sipër për t'i përmbushur këto afate, për shkak se konsiderojmë që ligji duhet doemos, jo vetëm ky por secili ligj që ka për qëllim ta përmirësojë mjedisin, qoftë për të bërë biznes në Kosovë, apo mjedisin ku jetojnë qytetarët, duhet të jetë doemos i zbatueshëm. Dhe, zbatimi i këtij ligji, natyrisht që garantohet përmes ndërtimit të mekanizmave nga aspekti i ekzekutivit, në mënyrë që t'i zbatojnë ato ligje. Kosova nuk ka nevojë që të miratojë ligje vetëm sa për sy e faqe apo ne nuk kemi nevojë që të miratojmë ligje për shkak që t'i përmbushim disa kërkesa që vijnë nga raportet që shkruhen jashtë, por vërtetë kemi nevojë që të miratojmë ligje të cilat e kanë një efekt pozitiv në jetën e qytetarëve dhe në këtë drejtim, përgjigja e cila është dhënë nga ministrja në Komision, nuk ka qenë e kënaqshme. Pra përgjigja e saj ka qenë që shpresojmë se do të mund t'i arrijmë këto afate, kështu që nuk ka rrezatuar një garanci dhe një siguri nga ana e ekzekutivit që ky ligj është i zbatueshëm. Dhe, për këtë arsye konsideroj që një ligj i cili nuk është i zbatueshëm, nuk ka nevojë që të miratohet.

Natyrisht që shkurtimi i afatit të regjistrimit dhe lehtësirat tjera të regjistrimit të biznesit, do të kishin qenë të dobishme dhe të mira për zhvillimin e afarizmit në Kosovë, mirëpo po ashtu duhet ta kemi parasysh që shkurtimi artificial i këtyre afateve po qe se nuk kemi mekanizma të mirë mbikëqyrës të zbatimit të ligjit dhe përgjithësisht të zbatimit të obligimeve dhe përgjegjësisë që një biznes mund të ketë për shoqëri, atëherë kjo

mund të na kthehet në bumerang dhe nga një e mirë potenciale mund të na kthehet në një e keqe potenciale dhe një dëmtues të jetës së qytetarit. Prandaj, konsideroj që duhet ta kemi parasysh këtë çështje para se ta miratojmë ligjin, pra që Ministria të jetë e vetëdijshme që e mban një përgjegjësi që këto afate do të jenë të zbatueshme, ky shkurtim i afateve do të jetë i zbatueshëm dhe se ky shkurtim afatesh do t'i sjellë dobi ekonomisë dhe afarizmit në Kosovë. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit, zoti deputet!

Nga Grupi Parlamentar i AAK-së, deputeti Ardian Gjini e ka fjalën!

ARDIAN GJINI: Ju faleminderit, zoti nënkryetar i Kuvendit!

Prapë mendoj se shumë u thanë nga ajo që ka qenë dashur të thuhet. Çdo ndryshimi i projektligjit pasqyron njëfarë vullneti politik të njerëzve që kërkojnë ndryshimin për të bërë diçka ndryshe, për të punuar ndryshe, për të sjellë diçka të re. Dhe, mendoj se, qysh thanë edhe parafolësit, nuk ka diçka të re që na sillet këtu, këto janë çështje të cilat janë diskutuar më herët. Edhe Kuvendi edhe Administrata kanë pasur debate edhe më përpara edhe nuk sjell diçka të re, do të thotë, përpos faktit që edhe vetë Qeveria e din që mund të ketë problem me zbatim të këtij ligji.

Tani, unë personalisht kam pritur pak më tepër prej ministres, kam menduar se na sjell diçka të re e jo një format që e kemi në tri vjetët e fundit të paraqitjes të projektligjeve, të na tregoj nën për nën se çka paraqesin ata, gjërat të cilat ane i lexojmë. Thotë, ministrat po na tregojnë diçka që ne munde t' i lexojmë vetë e nuk po na tregojnë cili ka qenë procesi i të menduarit për projektligjin para se të vijë projektligji këtu. Tani po vij te procesi i të menduarit edhe i punës. Do të thotë, nëse është punuar në projektligj, edhe është sjellë e njëjta gjë, atëherë këta që kanë punuar nuk dinë ama bash hiq. Mirëpo, nëse nuk është punuar, atëherë mund t' i arsyetoj se ndoshta dinë, por nuk kanë punuar se e kanë sjellë të njëjtën gjë. Mund t' ju them që po më vjen keq se kam pritur pak më shumë në paraqitje në të paktën dhe materialin e kemi pasur përpara edhe e kemi lexuar, se edhe Grupi Parlamentar i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës nuk mund ta votojë këtë projektligj dhe mendon se këtë projektligj për ndryshim të ligjit në fund të fundit dhe mendon se duhet të kthehet në ripunim dhe të ketë një proces më të gjatë të menduarit dhe të vetë punës, të ketë më shumë orë pune para se të na vijë materiali për ta votuar këssoj. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit!

Në emër të Grupit Parlamentar të Koalicionit Kosova e Re, Myzejene Selmani e ka fjalën.

MYZEJENE SELMANI: Ju faleminderit, zoti kryesues!

Përshëndetje për Kabinetin qeveritar!

Duke marrë parasysh se edhe në mandatin e kaluar ka ardhur ky projektligj, dhe duke pasur parasysh se edhe në mandatin e kaluar projektligjet kanë ardhur jo në formatin e duhur, mirëpo për çështje shumë me rëndësi të vendit kah kalon në këto procese shteti ri i ri i Kosovës, atëherë është e rrugës që pikësëpari raporti i sfidave të dalë raport pozitiv. Dhe, e dyta, nuk është hera e parë që në Kuvend të Kosovës mund të vijnë ligje

të cilat nuk janë të përkryer, mirëpo prapëseprapë duke marrë parasysh se ish ministri i kaluar i këtij dikasteri i dha vërejtjet e veta dhe deputetët e këtij Kuvendi kanë të drejtë t'i paraqesin rekomandimet e veta, atëherë mbetet që Komisioni Parlamentar, me gjitha vërejtjet e deputetëve të cilët janë sot këtu prezent, të bëjë amendamentimin që ambienti biznesor në Kosovë të ndryshojë dhe strategjia e cila është miratuar, ndoshta në Qeveri e jo në Kuvend që të ndryshojë në të mirë të Kosovës. Edhe një herë unë e potencoj që çdoherë ligjet nuk vijnë të mira në Kuvend të Kosovës.

Grupi Parlamentar i AKR-së, do ta japë kontributin e vetë në Komision Parlamentar, me të gjitha vërejtjet të ish ministrit i cili e ka pasur në dorë këtë projektligj në mandatin e kaluar dhe ka mundur të miratohet edhe atëherë, mirëpo ka qenë si ka qenë situata. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit!

Në emër të Grupit Parlamentar SLS, Deputeti Rashiq e ka fjalën. Regjia, deputeti Rashiq fjalën!

SAŠA RAŠIĆ: Hvala, gospodine predsjedavajući!

Parlamentarna grupa je razmotrila i ovaj Nacrt zakona i preporuke koje su stigle, ali one su negativne, koliko smo mi uvideli, međutim ono što smo uočili tokom razmatranja, jeste da su pravne forme zadovoljene. Ovaj Nacrt zakona nije u koliziji sa našim zakonodavstvom, ispunjava evropske standarde. Suštinski je bitan i zbog suštine koja u principu omogućava ekonomski razvoj Kosova. Parlamentarna grupa Samostalne liberalne stranke će u načelu podržati ovaj zakon i svoj doprinos će dati na funkcionalnoj komisiji. Hvala!

KRYESUESI: Ju faleminderit!

Grupi Parlamentar „6+“. Fikrim Danko e ka fjalën!

FIKRIM DANKA: Teşekkür ederim sayın Meclis Başkanı, değerli başbakan yardımcıları ve bakanlar değerli milletvekillerim

6+ Grubu adına ticari şirketler kanunundaki değişim ve tamamlamalara ilişkin Önerileri incelediğimizi eksikliklere rağmen artıların da olduğunu gözetledik. Özellikle sermaye miktarının azaltılması ve şirketlerin kurulmasına ilişkin sürenin düşürülmesi şikayetlere ilişkin sürenin düşürülmesi, olumlu olarak incelenmektedir, olumlu görülmektedir ve komisyonda gerekli destekleri sunarak, teklifleri sunarak bu yasanın daha iyi bir şekilde uygulanmasına çaba göstereceğiz.

6+ Grubu adına desteklediğimiz ifade etmek istiyorum, teşekkür ederim.

KRYESUESI: Ju faleminderit! Nuk ka deputetë të paraqitur. Përfaqësuesi i Qeverisë, a e dëshiron fjalën? Zonja ministreshë!

MINISTRJA MIMOZA KUSARI-LILA: Ju faleminderit shumë! E falënderoj kryetarin e Komisionit Parlamentar, shefat e grupeve dhe deputetët për komentet dhe vërejtjet e tyre.

Kisha dashur t'i adresoj edhe përgjithësisht. Por edhe në veçanti vërejtjet. Sa i përket komenteve të ish ministrit, mendoj se është zbatuar dhe e keni parë ministër edhe në implementim në fakt të ligjeve, që një ligj i mirë mund të jetë, por zbatimi i atij ligji, nëse nuk realizohet si duhet, mund ta lërë Ministrinë në gjendjen në të cilën është sot.

Pra, gjendje jo e kënaqshme e cila, zoti Ymeri për të cilin ngriti vërejtjet e tij lidhur me shkurtimin e afateve. Zoti Ymeri shkurtimin e afateve ne nuk mund ta zbatojmë nëse nuk është në ligj. Domethënë, ne nuk mundem të kërkojmë llogari nga përfaqësuesit as të Agjencisë së Regjistrimit të bizneseve as të tjerët nëse ky shkurtim i afatit nuk parashihet në ligj për arsye se nuk ka obligim ligjor i cili një shërbyesi civil duhet t'i thotë se duhet të veprojë konform shkurtimit të afateve.

Ndërsa e falënderoj zotin Gjini shumë për një koment politik më tepër ndoshta se sa profesional në raport me ligjin. Ajo çfarë është prezantuar, është domosdoshmëri për një përmirësim të ambientit të biznesit në Kosovë. Ne duhet të fillojmë me zbatimin e drejtpërdrejtë të shkurtimit të afateve të zbatimit të funksionimit të agjencive, të cilat veprojnë me bizneset në Kosovë, me gjithat nëse pritet një revolucion në kuadër të një ligji ose amendamentimit të një projektligji, atëherë koha e revolucioneve ka mbaruar, koha e evuliconeve është në proces, kështu që ky është një proces evolutiv për të cilin ju kisha ftuar të gjithëve ta votoni në parim dhe natyrisht komente, të nderuar deputetë dhe vërejtjet, mund të jenë të inkuadruar në leximin e dytë të këtij projektligji. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit, ministreshë!

Për replikë janë paraqitur Lutfi Zharku dhe Ardian Gjini. Keni të drejtë dy minuta. Deputetit Zharku, replikë.

LUTFI ZHARKU: Ju faleminderit, kryesues!

Në realitet, unë nuk e di qysh është Ministria sot, veç e di qysh e kam lënë. Ne e përdorim në Kaçanik një shprehje "cakum pakum" e kam lënë, e sot qysh është, nuk e di unë ajo punë, kurse mendoj se aprovimi a mos aprovimi i ligjit, nuk ka të bëjë me Ministrinë, por ka të bëjë me ekonominë. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit! Zoti Gjini, e ka fjalën për replikë.

ARDIAN GJINI: Ju faleminderit, zoti nënkryetar!

Një përkujtues miqësor, krejt çka flitet në Kuvend është politikë edhe nuk e di pse po i duket keq të jetë në politikë, se politikë është, në politikë ka hyrë vetë, edhe tjetra sa na mban ligjërata për revolucion e kontrarevolucion, evolucion, më mirë ta bëjë ligjin e mirë, pak të punojë atje në profesion të vetin. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit!

Zoti Visar Ymeri. Ky për replikë e ka fjalën.

VISAR YMERI: Desha shkurt, pasi mu përmend emri aty. Në përgjigje, unë nuk pajtohem me këtë që e thotë ministrja se nuk mund të bëhet, domethënë shkurtimi i afateve po që se nuk është dispozitë ligjore. Natyrisht që dispozita ligjore kur e mundëson ato, mirëpo ligji nuk e ndalon që përgjigja apo regjistrimi i biznesit të bëhet për një afat më të shkurtër po që se Ministria e ka atë mundësi. Pra, nëse dikush aplikon për regjistrim apo e paraqet një vërejtje në Ministri, ligji nuk thotë që doemos duhet të pritët 30 ditë. Ligji thotë që nuk bën të tejkalohen 30 ditë, pra ti ke mundësi ta trajnosh personelin për këtë çështje para se të bëhet ajo me ligj. Pra, brenga ime kryesore që ka qenë edhe në Komision edhe që e përmenda këtu, është te zbatueshmëria e ligjit dhe për këtë as këtu nuk morëm përgjigje. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit!

Deputeti Sabri Hamiti, replikë. Ti nuk ke diskutuar dhe për diskutim mendoj, zoti Hamiti, është shkelje e Rregullores në qoftë se do të bësh diskutim. Ka përfunduar debati. E ka marr fjalën sipas Rregullores ministrja, e fundit. Kanë pasur disa replika.

(Sabri Hamiti, reagon nga salla, nuk dëgjohet)

KRYESUESI: Jo, jo, unë nuk po dua ta marr fjalën, por sipas praktikës, kështu shkon...

(Sabri Hamiti, nga salla, nuk dëgjohet)

KRYESUESI: Pas ministres, jo. Mirë, mirë. Unë si nënkryetar i Kuvendit, unë mundem t'ia jap dhjetë herë edhe pesëmbëdhjetë herë, por të kishte përfunduar kjo, ia kisha dhënë fjalën pastaj...

(Sabri Hamiti, nga salla, nuk dëgjohet)

KRYESUESI: ...Çka po bëj? Nuk ke të drejtë në fjalë, nuk je paraqitur. Normalisht, nuk je paraqitur në kohë. Është dashur të paraqitesh kur ka qenë koha e paraqitjes. Është shkelje e Rregullores dhe nuk dua ta shkel Rregulloren unë. Tash, pasi po do kështu, nuk e shkel Rregulloren.

(Sabri Hamiti, nuk dëgjohet për transkriptim)

KRYESUESI: Unë jo, unë jo. Unë nuk e shkel. Ke të drejtë kur e ke hapësirën kohore me Rregullore.

SABRI HAMITI: Shiko, unë kam të drejtë të flas për temë në çdo moment...

KRYESUESI: Ju njoftoj që në mbledhje janë prezentë 75 deputetë. Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim. Votojmë, tani.

Konstatohet se me 46 vota “për”, 44 “kundër”, Kuvendi miratoi në parim Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për shoqëritë tregtare.

Kërkohej nga komisioni funksional dhe komisionet e përhershme, që në afatin e paraparë me Rregulloren e Kuvendit, ta shqyrtojnë Projektligjin dhe Kuvendit t’ia paraqesin raportet me rekomandime.

Pika e shtatë e rendit të ditës:

7. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për akreditim

Në bazë të nenit 56 të Rregullores së Kuvendit, Komisioni funksional ka shqyrtuar Projektligjin dhe Kuvendit ia ka paraqitur raportin me rekomandime, andaj janë përmbushur kushtet për shqyrtim në parim të këtij projektligji.

Ftoj ministren e Tregtisë dhe Industrisë, zonjën Mimoza Kusari -Lila, që në emër të Qeverisë së Republikës së Kosovës, para deputetëve të Kuvendit, të prezantojë dhe ta arsyetojë Projektligjin.

MINISTRJA MIMOZA KUSARI- LILA: I nderuar kryesues,

Të nderuar deputetë,

Gjithnjë në funksion të përmbushjes së objektivave të Qeverisë së Republikës së Kosovës në ngritjen, zhvillimin dhe implementimin e infrastrukturës të cilësisë, me qëllim të furnizimit të rregullt të tregut me produkte cilësore, kontrollimin, mbikëqyrjen, rregullimin e tregut dhe mbrojtjen e konsumatorit, Ministria e Tregtisë dhe Industrisë, respektivisht Drejtoria e akreditimit, ka iniciuar ndryshimet dhe plotësimin e Ligjit 03-L-69 për akreditim, në mënyrë që të harmonizohet me Rregulloren 70065/2008, të Komisionit Evropian, e cila ka hyrë në fuqi me 1 janar të vitit 2010.

Drejtoria e Akreditimit, është i vetmi organ kombëtar i akreditimit i themeluar me ligj për të vlerësuar në përputhje me standardet ndërkombëtare, kompetencën teknike të organeve për vlerësim të konformitetit që kryen aktivitete të tilla si testim, kalibrim, certifikim dhe inspektim, qofshin në sektorët publik apo privat, të fushës vullnetare apo të detyrueshme.

Drejtoria e Akreditimit është anëtare në Korporatën Evropiane të Akreditimit, anëtare me të drejta të plota në Forumin ndërkombëtar të akreditimit dhe në Organizatën Ndërkombëtare të Akreditimit të laboratorëve. Me harmonizimin e Ligjit për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit, me Rregullore 70065/2008, Drejtorisë së Akreditimit i hapen rrugët për të nënshkruar marrëveshjen multilaterale me Agjencinë Evropiane të akreditimit dhe me këtë rast, certifikatat për vlerësim të konformitetit të lëshuar nga organet për vlerësim të konformitetit, do të njihen nga të gjitha shtetet e BE-së, të cilat janë nënshkruese të këtyre marrëveshjeve. Përpos kësaj, avancimi i infrastrukturës

ligjore në këtë fushë, ka ndikimin e vetë praktik në reduktimin e barrierave teknike, si në tregun e brendshëm ashtu edhe të jashtëm.

Përmes këtij projektligji, bëhet e mundur transfuzimi i rregulloreve dhe e direktivave evropiane të infrastrukturës së cilësisë si dhe të kapitullit të parë të asquis komunitare, lëvizja e lirë e mallrave, të cilat do të mundësojnë lëvizjen e lirë të mallrave pa pasur nevojë rritjes apo rikalibrimin në laborator të vendit ku hyjnë. Në këtë mënyrë, bazuar në parimin një produkt i testuar një herë, pranohet kudo, realizohet qëllimi për lëvizjen e lirë të produkteve me minimumin e kostove dhe të përpjekjeve.

I nderuar kryesues,

Të nderuar deputetë,

Me eliminimin e këtyre të metave, ligji në fjalë, i plotëson kërkon kërkesat në përputhje me Rregulloren e Komisionit Evropian përmes të cilës rregullohen kërkesat për organin akreditues si subjekt i vetëm shtetëror për vlerësimin e organeve për vlerësim të konformitetit në Republikën e Kosovës. Andaj, ju rekomandoj që këtë projektligj ta shqyrtoni dhe miratoni në këtë seancë parlamentare. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit!

Pas prezantimit, hap debatin për diskutim në parim. Sipas Rregullores, kryetari i Komisionit funksional për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri, deputeti Zenun Pajaziti e ka fjalën. Kam një vërejtje. I lus deputetët se konform Rregullores, secili prej jush e ka të drejtën që të diskutojë 10 minuta për ligjin. Paraqituni, askush nuk mund t'ua marr fjalën, jo pas kohës. Ju faleminderit!

ZENUN PAJAZITI: Ju faleminderit, zoti kryesues,

Kabinet qeveritar,

E nderuara ministre,

Të nderuar deputetë,

Komisioni funksional për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri, edhe këtë projektligj e ka trajtuar në mbledhjen e njëjtë më sa ju tregova më parë. Kemi marrë vendim që tri projektligjet nga kjo ministri të trajtohen në një paket dhe po ashtu ju informoj që nuk kemi arritur të bëjmë një rekomandim pozitiv, pra ka qenë një votim i balancuar në Komision. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit!

Sipas renditjes, në emër të Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike, prapë Zenun Pajaziti, e ka fjalën.

ZENUN PAJAZITI: Ju faleminderit, zoti kryesues!

Ne kemi në fuqi një ligj, nr. 03-L-069 për akreditim, mirëpo është vërejtur me kohë se gjatë raportimit të Drejtorisë së Akreditimit të Komisionit Evropian, në qershor të vitit 2010, është sugjeruar që Ligjin për akreditim ta harmonizojmë me Rregulloren 765/2008, e cila ka hyrë në fuqi më 1 janar të vitit 2010. Andaj, tani më kemi një situatë të re dhe kemi ardhur deri te nevoja e ndryshimit të këtij ligji. Po ashtu edhe Drejtoria e akreditimit, nuk e harmonizon Ligjin me këtë Rregullore, do të ketë, nëse nuk e

harmonizon, do të ketë vështirësi në plotësimin e kërkesave të Juropian corporation for akredition kështu që Ministria e Tregtisë, Industrisë, përmes hartimit të projektligjit në fjalë apo propozimeve për këto ndryshime, plotësime, do të bënte, do të arrinte deri te eliminimi i mangësive ekzistuese që e mbulojnë këtë fushë.

Meqenëse nga aspekti formal-juridik i Projektligjit sikur edhe te ai tjetri më parë, përmbahen ose plotësohen të gjitha kriteret. Po ashtu, nga ana e harmonizimit ligjor dhe standardizimit po ashtu dhe meqenëse, po ashtu ndryshimet bazohen kryesisht në kriteret ose sfidat e Raportit të progresit të BE-së dhe po ashtu, meqenëse ky është një prej projektligjeve që është në një paketë të projektligjeve të miratuara nga Qeveria, e që kanë për synim përmirësimin e mjedisit biznesor në Republikën e Kosovës, Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike të Kosovës e aprovon dhe kërkon po ashtu edhe nga grupet tjera parlamentare dhe deputetët ta aprovojnë këtë projektligj. Po ashtu inkurajon ministrin, Ministrinë përkatëse meqenëse është bartëse e këtyre projektligjeve të rëndësishme, në kuadër të këtij paketi të projektligjeve që synojnë përmirësimin e mjedisit biznesor, të punojnë më aktivisht në leximin e dytë dhe po ashtu të kontribuojnë edhe më tepër në fillimin e zbatimit të këtyre ndryshimeve. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit!

Në emër të Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike të Kosovës, deputeti Lutfi Zharku.

LUTFI ZHARKU: I nderuar kryeses,
Zëvendëskryeministra,
Të nderuar ministra,
Kolegë deputetë,

Projektligji i propozuar plotëson një zbrazësi juridike dhe praktike sa i përket autorizimit të trupave për vlerësim të konformitetit që nga ana e ministrive të ndryshme për fushat përgjegjësisë së tyre, e që është në përputhje me praktikatat e bashkësisë Evropiane. Megjithatë, projektligji i propozuar, përpos obligimit ligjor për vlerësimin e trupave të autorizuar nga ana e Drejtorisë së Akreditimit, nuk sqaron se cilat janë veprimet e ministrive relevante bazuar në këtë vlerësim, gjegjësisht vlerësimi i Drejtorisë së Akreditimit, çfarëdo qoftë, a ka karakter obligativ apo vetëm rekomandues. Cilado zgjidhje në praktikë, mund të ndeshet me situata të ndryshme si monopolizimit të dhënies së autorizimeve nga ana e Drejtorisë së akreditimit, kur vlerësimi është obligativ për Ministrinë relevante apo rasti tjetër i mospërfilljes së vlerësimit në rastet kur ai ka karakter vetëm rekomandues.

Projektligji duhet të lirohet nga disa dispozita të panevojshme sikurse neni 2 që përcakton obligimin e MTI-së për sigurimin e burimeve financiare dhe personelit për funksionimin e Drejtorisë së Akreditimit si dhe neni 5, që përshkruan nenet dhe numrin e Rregullores së Parlamentit dhe Këshillit Evropian, që duhet të zbatohet duke marrë parasysh se e njëjta mund të ndryshohet në çdo kohë nga ana e këtyre institucioneve. Po ashtu, dispozitat e këtij projektligji, duhet të harmonizojë me dispozitat e Ligjit për kërkesat teknike dhe vlerësimin e konformitetit të produkteve, i cili përcakton se

vendi ynë nuk ka obligim t'i njohë dokumentet e konformitetit, të lëshuara nga vendet tjera përderisa nuk kemi marrëveshje bilaterale për njohjen reciproke të tyre.

Duke i marrë parasysh këto vërejtje, si dhe bazuar në rekomandimin e Komisionit funksional, Grupi ynë parlamentar rekomandon që ky ligj të kthehet në ripunim. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit!

Në Emër të Grupit Parlamentar Vetëvendosje, nuk ka të paraqitur.

Në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, deputeti Ardian Gjini.

ARDIAN GJINI: Ju faleminderit, zoti kryesues!

Realisht është e njëjta procedurë. Në Komision nuk është votuar. Prapë në paraqitje 2 minutëshe për një ndryshim të ligjit, i cili thuhet se është tepër i rëndësishëm, mendoj se vetë serioziteti i cili sillet, përpos atyre që u thanë, por nuk sillet seriozitet në këtë mënyrë. Nuk po kam qysh mos ta them këtë, në formë evolutive dhe revolute, por nuk po sillet seriozitet në punë, dy minuta nuk mund të prezantohet ligji, që kështuashtu Komisioni ka rekomanduar mos ta votoj. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit!

Nga Grupi Parlamentar "Kosova e Re", Myzejene Selmani e ka fjalën.

MYZEJENE SELMANI: Ju faleminderit, zoti kryesues!

Ky projektligj vetëm pat kaluar në mandatin e kaluar, në vitin 209 dhe është plotësuar me ndryshimet, mirëpo duke marrë parasysh ndryshimin e Rregullores së Komisionit Evropian, atëherë është dashur së paku me një udhëzim administrativ të rregullohet ky projektligj, mirëpo të gjitha, prapëseprapë edhe një herë them të gjitha rekomandimet, të gjitha vërejtjet do të përfshihen në Komisionin Parlamentar. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit!

Grupi Parlamentar SLS, nuk është paraqitur askush, nuk e donë fjalën. Në emër të Grupit Parlamentar "6+", deputeti Enis Kervan.

ENIS KRVAN: Faleminderit, i nderuari kryesus!

Kanun taslağı, Avrupa'da akreditasyon hizmetinin sunulmasıyla ilgili hukuki çerçeveyi belirleyen düzenleme, akreditasyon talebinin ve ürünlerin pazarlanmasına yönelik yönetmenliklerin saptanmasına yönelik parlamento ve Avrupa Konseyi tarafından kabul edilen düzenlemeyi içermektedir. Bu düzenleme ayrıca, gönüllü olarak uyum perensibinin de değerlendirilmesine ve yasama tarafından talep edilen uyum değerlendirmesi ile ilgili faaliyeti de desteklemektedir. Aslında bu düzenleme akreditasyon organının bağımsız, tarafsız ve objektif yapılması gereken çalışmaları için yetenekli kadroya sahip olması, uyum değerlendirmesini yapan organlar tarafından hizmetlerin sunulmasına izin vermemesi ve diğer ulusal akreditasyon organları ile rekabete girmesini gerektirmektedir. Dolayısıyla bu tür önerilerimizi göz önünde

bulundurarak, var olan komisionlarda katkı sunacağımızı belirterek, birinci okunuşu 6+ Parlamenter Grubu olarak desteklediğimizi irade ederim.

Sağolun

KRYESUESI: Ju faleminderit!

Konstatoj që paraqitjet në emër të grupeve janë ezauruar. Deputetë të paraqitur nuk ka. Përfaqësuesi i Qeverisë, e dëshironi fjalën prapë apo jo? Në vazhdim, kërkohet deklarimi me votim për miratimin në parim të Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për akreditim.

Në sallë janë 89 deputetë.

Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim. Tani u bënë 94 deputetë. Votojmë, tani.

Konstatoj që “për” kanë votuar 50, 46 janë “kundër”, asnjë abstenim. Konstatoj që Kuvendi miratoi në parim Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për akreditim.

Kërkohet nga komisioni funksional dhe komisionet e përhershme, që në afatin e paraparë me Rregulloren e Kuvendit, ta shqyrtojnë projektligjin dhe Kuvendit t’i paraqesin raportet me rekomandime.

Vazhdojmë me pikën e tetë të rendit të ditës:

8. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për gjendjen civile

Në bazë të nenit 56 të Rregullores së Kuvendit, komisioni funksional ka shqyrtuar Projektligjin dhe Kuvendit ia ka paraqitur raportin me rekomandime, andaj janë përmbushur kushtet për shqyrtim në parim të këtij projektligji.

Ftoj ministrin e Punëve të brendshme, zoti Bajram Rexhepi, që në emër të Qeverisë së Republikës së Kosovës, para deputetëve të Kuvendit të prezantojë dhe ta arsyetojë projektligjin.

Zoti Rexhepi, e keni fjalën.

MINISTRI BAJRAM REXHEPI: I nderuar kryesues i Kuvendit,

Zëvendëskryeministra, ministra,

Të nderuar deputetë,

Më lejoni të prezantoj para jush Projektligjin për gjendjen civile. Fillimisht ju njoftoj se ky projektligj ka qenë në Kuvend, mirëpo me shpërndarjen e Kuvendit të Kosovës, i njëjti është kthyer edhe një herë për të siguruar miratimin e Qeverisë së re.

Nxjerrja e këtij projektligji, ka rëndësi të veçantë për faktin se adreson fusha thelbësore të regjistrimit të gjendjes civile sipas praktikave më të mira ndërkombëtare si dhe shfuqizon Ligjin për regjistrat e gjendjes civile, i cili nuk i përmbush në plotësi standardet e kërkuara lidhur me regjistrimin civil. Në përpilimin e këtij projektligji, kanë qenë të përfshirë edhe përfaqësuesit e misionëve ndërkombëtare në Kosovë, ku interesim të veçantë kanë shprehur përfaqësuesit e ICO-së, EULEX-it, i CITAP-it dhe

UNCHER-it, të cilët përmes përfaqësuesve të tyre, kanë dhënë rekomandimet të cilat edhe janë inkorporuar në projektligj.

Ky projektligj rregullon kuptimin dhe përbërësit e gjendjes të civile, të shtetasve të Kosovës, shtetasve të huaj dhe të personave të pa shtetësi, me banim të përkohshëm apo të përhershëm në Republikën e Kosovës, për caktimin e rregullave për krijimin, ruajtjen dhe ndryshimin e tyre, si dhe organizimin dhe funksionimin e Shërbimit të gjendjes civile në Republikën e Kosovës. Po ashtu projektligji siguron mbrojtjen e të drejtave dhe interesave të personave që u regjistrohen të dhënat, të drejtën për qasje në të dhëna si dhe mbledhjen dhe këmbimin e të dhënave, mbrojtjen e të drejtave të komuniteteve, po ashtu të drejtën e ankesës kundër vendimeve të organeve kompetente që kanë të bëjnë me gjendjen civile. Trajton në hollësi gjendjen e shtetasve të huaj dhe personave pa shtetësi, themelon një regjistër qendror të gjendjes civile, parasheh lëshimin e numrit personal me rastin regjistrimit të lindjes, parasheh regjistrimin e mëvonshëm dhe reregjistrimin.

Projektligji ka 11 kapituj me gjithsej 67 nene. Projektligji për gjendjen civile pritet të ketë implikime buxhetore, që vlerësohet të jenë të përballueshme për Ministrinë e Punëve të Brendshme. Vlerësohet se me buxhetin aktual që ka aprovuar për vitin 2010, por edhe buxhetin e vlerësuar për vitet 2011 deri 2013, sipas kornizës afatmesme të shpenzimeve, do të jetë në gjendje ta përballojë ndikimin buxhetor për zbatimin e këtij projektligji dhe pa pasur nevojë për mjete shtesë buxhetore.

Projektligji krijon stabilitet legjislativ, për fushëveprimtarinë të cilën e rregullon nga arsyet e parashtruara më lart, shihet qartë se bëhet fjalë për një projektligj me një prioritet të lartë, për faktin se është një ndër kriteret kryesore që kërkohet për të përmbushur progres në procesin e liberalizimit të vizave, andaj kërkoj që Kuvendi i Kosovës, ta miratojë në parim Projektligjin për gjendjen civile. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit!

Sipas radhës, kryetari i Komisionit funksional për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrje të Forcës të Sigurisë së Kosovës, deputeti Ahmet Isufi e ka fjalën.

AHMET ISUFI: Ju faleminderit, kryesues!

Komisioni për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrje të Forcës të Sigurisë të Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 19 prill 2011, ka shqyrtuar Projektligjin për gjendjen civile dhe rekomandon që projektligji të miratohet në parim.

Duke pasur parasysh rëndësinë e këtij ligji, ka nevojë të amendamentohet në procedurë të mëtejme të shqyrtimit, me vërejtjet dhe sugjerimet e deputetëve dhe me punën që do të bëhet në Komision, në mënyrë që të kemi një ligj të mirë dhe të implementueshëm në të ardhmen. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit!

Kryetarët ose përfaqësuesit e grupeve parlamentare. Në emër të Partisë Demokratike të Kosovës, fjalën e ka deputetja Ganimete Musliu.

GANIMETE MUSLIU: Ju faleminderit, zoti kryesues!

Të nderuar ministra,

Të nderuar kolegë dhe kolege deputetë,

Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike të Kosovës ka shqyrtuar me kujdes Projektligjin për gjendjen civile dhe gjatë shqyrtimit ka hasur në disa vërejtje ku kryesisht janë të natyrës teknike dhe drejtshkrimore, për çka i sugjerojmë Komisionit profesional që të bëjë ndërhyrje në këtë ose t'i përmirësojë këto gabime.

Parimisht, do të thotë, në anën substanciale ky ligj i plotëson të gjitha kushtet e parapara të nenit 54 të Rregullores së Kuvendit dhe si Grup Parlamentar i Partisë Demokratike të Kosovës e mbështesim në parim këtë projektligj dhe ftojme të gjithë deputetët e këtij Kuvendi që ta mbështesin. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit!

Nga Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike, Vjollca Krasniqi e ka fjalën.

VJOLLCA KRASNIQI: I nderuari kryesues,

Kolegë kuvendarë,

Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike të Kosovës, e ka shqyrtuar Projektligjin për gjendjen civile dhe natyrisht vlerëson se ky projektligj do të rregullojë edhe më tej jetën civile të shtetasve të Republikës së Kosovës, shtetasve të huaj, personave pa shtetësi, banorëve të përhershëm dhe të përkohshëm të Republikës së Kosovës.

Mendojmë se ky projektligj ka nevojë për shqyrtim dhe trajtim të mëtutjeshëm, sepse vlerëson se në shumicën e neneve, ka mangësi dhe të meta. Ky projektligj, fillimisht ka nevojë për një lekturë të mirëfilltë. Shumë shprehje të huaja janë të përkthyer në mënyrë jo të drejtë, gjë që në të shumtën e rasteve duket si dokument shumë gjuhësor, prandaj nuk ka korrekti gramatikore gjuhësore. Bazuar në materialin e ofruar edhe nga aspekti buxhetor, ky projektligj nuk do të mund të jetësohet në tërësi sepse thuhet që nuk do të ketë mjete shtesë buxhetore dhe vazhdimisht thuhet se ky projektligj do të jetësohet në bazë të mundësive buxhetore. Vërejtjet dhe sugjerimet tona do të jenë nen për nen, por kontributin tonë si anëtarë të Lidhjes Demokratike të Kosovës, do ta japim në komisionin përkatës, pra në Komisionin për Punë të Brendshme, Siguri dhe Forcë të Sigurisë, ku është miratuar parimisht. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit

Në emër të Grupit Parlamentar Vetëvendosje, Afrim Hoti.

AFRIM HOTI: Ju faleminderit, kryesues i Kuvendit!

Të nderuar deputetë,

Ligji në parim është mirë, përveç disa vërejtjeve në të cilat do të ndalem. Plotësimi i Projektligjit nr. 4-L-003 për gjendjen civile, sipas nenit 4, paragrafi 3, kryeshefi i Agjencisë së Regjistrimit Civil, autorizon dhënien e të dhënave të kërkuara prej institucioneve dhe organeve të ndryshme në përputhje me udhëzuesin e miratuar prej tij dhe këshillit të Agjencisë Shtetërore për mbrojtjen e të dhënave personale. Udhëzuesi

përcakton llojin dhe sasinë e informacionit që mund t'u jepet institucioneve dhe organeve, kërkuese duke pasur parasysh ligjet që rregullojnë organizimin dhe funksionimin e tyre si dhe legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale. Propozojmë që këtij neni t'i shtohet kryeshefi i Agjencisë së Regjistrimit Civil, autorizon dhënien e të dhënave të kërkuara prej institucioneve dhe organeve të ndryshme pa pëlqimin e personave të autorizuar dhe për interes të përgjithshëm shtetëror. Në përputhje me udhëzuesin e miratuar prej tij dhe Këshillit të Agjencisë Shtetërore për mbrojtjen e të dhënave personale, udhëzuesi përcakton llojin dhe sasinë e informacionit që mund t'u jepet institucioneve dhe organeve kërkuese, duke pasur parasysh ligjet që rregullojnë organizimin dhe funksionimin e tyre si dhe legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale.

Arsyetimi i dispozitës, konsiston në faktin se mbrojtjes së përgjithshme të dhënave personale dhe shfrytëzimin e tyre, në mënyrë racionale sipas standardeve ndërkombëtare me qëllim të ndalimit të keqpërdorimeve të mundshme që mund t'u jepen shërbimeve të huaja sekrete në kundërshtim me interesin e përgjithshëm shoqëror. Natyrisht këtu mungojnë informacione më të sakta kur thuhet: “standarde ndërkombëtare”, nuk tregohet se për cilat kritere dhe standarde është fjala. Arsyetimi sipas nenit 9, përbërësit e gjendjes civile janë: emri i personal; numri personal, datëlindja; vendlindja; gjinia, shtetësia; amësia; atësia; gjendja martesore, vdekja, vendbanimi dhe qëndrimi dhe faktet tjera të përcaktuara me këtë ligj. Neni 29, korrigjimi dhe plotësimi në regjistrin qendror të gjendjes civile nën një, ku në regjistrin qendror të gjendjes civile, vërehen gabime e materialeve që gjendet rubrikë që nuk pasqyron përbërësin përkatës, përgjegjësi i Zyrës që gjendjes civile, bënë korrigjimin ose plotësimin kur nën një, pika 1, përbërësi figuron në librat e akteve në regjistrat themeltar të mëparshëm të asaj zyre ose të vendit prej nga ka ardhur me ndryshim të vendbanimit për çdo shkak.

Pika 1.2, i interesuari paraqet dokumentin bazë nga burimi përgjegjës sipas Ligjit, pika 1.3, vërtetohet në të gjitha rastet e tjera me vendim gjyqate. Sipas nenit 40, pika 1, numri personal lëshohet me regjistrimin e lindjes, nën dy lëshimi i numrit personal për të gjithë personat që nuk janë të pajisur me këtë numër, deri në hyrje në fuqi të këtij ligji përfshirë edhe fëmijët nën moshën 16 vjeç, bëhet brenda një viti nga hyrja në fuqi i këtij ligj, nën tre,

Kriteret dhe procedurat rregullohen me akt nënligjor nga ministri.

Plotësimi i nenit 40, propozojmë që këtij neni t'i shtohet pika 3.

- Nën 1, numri personal lëshohet me regjistrin e lindjes,
- Nën 2, lëshimi i numrit personal për të gjithë personat që nuk janë pajisur me këtë numër deri në hyrje të fuqi të këtij Ligji, përfshirë edhe fëmijët nën moshën 16 vjeç, bëhet brenda një viti nga hyrja në fuqi e këtij Ligji,
- Nën 3, nuk lejohet ndryshimi i numrit personal përveç korrigjimeve teknike sipas nenit 29 të këtij Ligji,
- Nën 4, kriteret dhe procedurat rregullohen me akt nënligjor nga ministri.

Arsyetim:

Numri personal përbën kontrollin qendror digjital të përbërësve të gjendjes civile, mundësia e ndryshimit të këtij numri personal, përbënë keqpërdorim kur një person mund, që në të njëjtën kohë t'i ketë dy apo më shumë dokument. Identiteti që njëkohësisht praqet shmangien nga ligji dhe komprometim të organeve të drejtësisë dhe identifikimin e personit të caktuar i cili mund të kryejë një vepër të kundërligjshme. Analiza juridiko-politike e Projektligjit mbi gjendjen civile, termet themelor, gjendja civile nënkuptohen tërësinë e të dhënave personale të shtetasve të Kosovës, shtetasve të huaj si dhe personave të pa shtetësi që kanë vendbanimet e përhershme ose të përkohshme në Kosovë. Regjistrimi civil, nënkupton pajisjen e shtetasve të Kosovës me dokumente të udhëtimit, regjistrimi i popullsisë sipas nenit 2. Regjistrimi bëhet me qëllim të planifikimit dhe zbatimit të politikave të përgjithshme zhvillimore dhe për të dhënat statistikore. Projektligji për gjendjen civile, nr. 4 i L-003 i datës 6.4.2011, në nenin 2, paragrafi 1.4 dhe 1.5 thuhet se duhet të ruhet regjistri qendror i gjendjes civile në arkivin e Zyrës së gjendjes civile në komunë si dokument për pasqyrimin e përbërësve të gjendjes civile siç janë: lindja, vdekja; martesë, amësia, anëtarësia, e ku në rastin konkret regjistri origjinal, burimor qendror i gjendjes civile është uzurpuar nga shteti serb. Krejt kjo me qëllim që serbët që mund të manipulojnë duke regjistruar shtetas dhe duke shlyer shtetas të Kosovës në atë regjistër në mënyrë të falsifikuar me qëllim të ndikimit në votim, ku sipas nenit 5, paragrafi 1 të Ligjit për zgjedhjet e përgjithshme në Kosovë, thuhet se çdo qytetar i Kosovës ka të drejtë për të votuar nëse është i regjistruar në regjistrin qendror të gjendjes civile. Kjo përbën vetëm njërin anë të medaljes, ndërsa ana tjetër e manipulimit qendror në faktin se kontrollimi i këtyre regjistrave nga qeveria serbe, mundet në mënyrë falsifikuese të ndikojë dhe në numrin e shtetasve të Kosovës, duke i shtuar ata të Serbisë dhe duke i eliminuar shtetasit e Kosovës, për faktin se neni 28, paragrafi 1 të Ligjit mbi shtetësinë e Kosovës, citon se: çdo qytetar i cili është regjistruar si banor i përhershëm i Kosovës, konform Rregullores së UNMIK-ut 2000/13, në regjistrimin qendror civil, konsiderohet shtetas i Kosovës dhe regjistrohet si i tillë në regjistrin e shtetasve. Për shembull, një person banor i Kosovës, i regjistruar në atë libër, mund të hiqet arbitrarisht uzurpuesit e regjistrave civil, ndërsa mund të fusë një banor të Serbisë në atë regjistër, me qëllim që në mënyrë falsifikuese, të ndikojnë në numrin e shtetësisë ose banorëve që reflekton në numrin e votave gjatë zgjedhjeve të përgjithshme. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit!

Në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, deputja Donika Kadaj- Bujupi.

DONIKA KADAJ- BUJUPI: I nderuar kryesues,

Të nderuar kolegë deputetë,

Ministër, zëvendëskryeministra,

Edhe pse me vonesë i sjell në Kuvend, është i domosdoshëm Projektligji për gjendjen civile, për shumë arsye. Njëra ndër to është pastrimi i listave zgjedhore, do të jetë një bazë për pastrimin e listave zgjedhore dhe do të evitohet votimi i të vdekurve, siç ka ndodhur në të kaluarën, e sidomos herën e fundit, në këto zgjedhjet e fundit.

Pavarësisht kësaj, Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës ka disa dilema. Ministri e përmendi liberalizimin e vizave dhe ndërldihen me këtë ligj, prandaj unë do të pyes si

sponzorizues i ligjit, a do të zbatohet ky ligj edhe në pjesën veriore të Kosovës? Po e bëj këtë pyetje, sepse ligji paraprak i cili është lidhur me regjistrimin e popullsisë nuk është zbatuar në tërë territorin e Kosovës edhe pse është miratuar nga ky Kuvend dhe përkundër kësaj, qytetarët e veriut të vendit, qytetarët e Mitrovicës kanë mbetur jashtë regjistrimit.

Me veprimet si ky, Qeveria e Kosovës ka konfirmuar edhe një herë që nuk ka fuqi që të zbatojë ligjet në tërë territorin e Kosovës dhe dita -ditës kjo po i shkon në favor një skenari të keq, skenarit të ndarjes për vendin. Unë e di që pas këtij diskutimi do të pasojnë edhe reagime, sepse edhe në mandatin e kaluar shpesh deputetë të Aleancës janë quajtur që nuk e donë të mirën e vendit, sepse po e përmendin fjalën ndarje. Mirëpo, Qeveria Thaçi ka bërë veprime në favor të ndarjes dhe në drejtim të ndarjes. Prandaj, po dua ta di që ligji në fjalë a do të zbatohet në mbarë territorin e Kosovës?

Pika 1.1 e këtij ligji, thotë: “Përtëritja e regjistrave civil themeltar nënkupton krijimin e regjistrave të rinj, të zhdukur, asgjësuar apo dëmtuar. Prandaj unë pyes: A po bëhet ky ligj tani kur tema e regjistrave civil është në tavolinë të dialogut Kosovë-Serbi, e që në fakt kjo temë është dashur që të jetë kusht për t’u futur në dialog? A po bëhet tani që të legalizojmë heqjen dorë apo konsensusin që Qeveria Thaçi ka bërë në raport me regjistrat civil? Kemi nevojë të kemi një përgjigje.

Dhe krejt për fund, ministër edhe pse thatë që edhe të huajt kanë qenë pjesë e këtij projektligji, ndoshta e bëtë për t’u pajtuar me EULEX-in, nuk po di, por prapëseprapë ligji ka shumë të meta edhe është ligj jo i mirë, edhe deputetët e këtij Kuvendi duhet të punojnë shumë në amendamentimin e tij. Nëse zbatohet si i tillë, qytetarët e Kosovës do të kenë më shumë vështirësi se sa që në fakt do të rregullohet diçka dhe për t’ju bindur se kjo është ashtu, unë do të lexoj nenin 50, i cili thotë: “Leja e varrimit, varrimi mund të bëhet vetëm pas marrjes së lejes nga Zyra e gjendjes civile dhe nën 2, në rast kur nuk mund të veprohet sipas paragrafit 1” Tash si mund të thuhet në ligj nëse nuk zbatohet pika 1, vepro sipas pikës 2. A është zbatimi i ligjit i detyrueshëm, pjesërisht i detyrueshëm apo sipas nevojës, ashtu si i konvenon Qeverisë Thaçi dhe ashtu si vepron në shumë raste?

Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës, do ta miratojë në parim, mirëpo besoni që të gjithë se bashku si deputetë dhe sidomos komisionet përkatëse, do të kenë shumë punë për të bërë. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit!

Në emër të Grupit Parlamentar Koalicioni Kosova e Re, Ibrahim Makolli, me kartelën e Ukë Rugovës.

IBRAHIM MAKOLLI: Ju faleminderit, zoti nënkryetar i Kuvendit!

Projektligji në fjalë ose tashmë një përmirësim i ligjit që ka qenë në fuqi, natyrisht është i nevojshëm për vendin, me gjithë dobësitë që e përcjellin në pjesë të ndryshme këtë projektligj, koalicioni për Kosovë të Re e përkrah në parim dhe kontributin do ta japim në komisionet përkatëse kur do të trajtohet kjo çështje. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit!

Në emër të Grupit Parlamentar SLS, deputeti Goran Marinković.

GORAN MARINKOVIĆ: Hvala, gospodine predsjedavajući!

Nacrt zakona o civilnom statusu iako je dosta dobro urađen, ima i određene nedostatke. Te nedostatke će se u daljem radu, nadamo se, ispraviti. Samostalna Liberalna stranka u načelu podržava usvajanje ovog zakona. Hvala!

KRYESUESI: Ju faleminderit!

Në emër të Grupit Parlamentar “6+”, deputetja Duda Balje.

DUDA BALJE: Parlamentarna grupa “6+” vršila je razmatranje Nacrta zakona o civilnom statusu koji uređuje značajne sadržaje civilnog statusa građana Kosova, stranih državljana i lica bez državljanstva, sa privremenim i stalnim boravkom u Republici Kosovo i smatra da je služba civilnog statusa jedinstvena i njena evidencija od velikog značaja. Podržavamo Zakon u načelu.

KRYESUESI: Ju faleminderit!

Grupet parlamentare u deklaruan. Tani sipas radhës, deputetët. Është paraqitur deputeti Armend Zemaj.

ARMEND ZEMAJ: Ju faleminderit, kryesues!

Sa i përket këtij projektligji i cili është mjaft i rëndësishëm dhe me probleme nëpër të cilat ka kaluar, sidomos Kosova pas vitit 1999, me të vërtetë po të kalohet në këtë mënyrë pa i thënë disa vërejtje, sidomos që kanë të bëjnë me regjistrimi dhe reregjistrimin apo çregjistrimin e personave të vdekur, me të vërtetë jo vetëm që krijon konfuzitet, por në masë të madhe edhe lejon hapësirë për manipulime nga zyrtarët, të cilët janë kompetent apo që u jepen kompetenca sipas këtij ligji.

Unë po e potencoj përafërsisht te neni 50, por amendamenti 4 apo pika 4, leja për varrim nuk duhet të lëshohet pa vërtetim të mjekut që konfirmon vdekjen apo pa urdhër të gjykatës siç është përcaktuar në Ligjin për mjekësinë ligjore. Ndërsa në nenin 47, deklarimi i vdekjes është te pika 5, thotë: ” kur vdekja ndodhë ditëve të pushimit dhe nuk mund të sigurohet leja e varrimit, përgjegjësi i shërbimi të varrimit kërkon dokumentet që vërtetojnë vdekjen dhe me këto dokumente bënë deklarin e vdekjes në Zyrën e gjendjes civile në ditën e parë të punës”.

Faktikisht, ne e kuptojmë që shumica e ligjeve dhe përkthehen apo merren si mostër nga vendet e huaja por as në deklaratën shpjeguese, por as në atë terminologjike nuk shpjegohet kush është përgjegjësi i shërbimit të varrimit dhe e dyta, i jep mundësi manipulimit te neni 55 ku është te regjistrimi. Prandaj këto duhet shikohen me kujdes, sepse kjo mënyrë jo vetëm që nuk është mirë e rregulluar, por është aq shumë e çrregulluar sa krijon hapësirë për manipulime të mëdha ku kompetencë të shtuar i jepet në nenin 54 te regjistrimi i mëvonshëm, ku zyrtari i Zyrës të gjendjes civile domethënë e ka atë kompetencë të veten kur dhe si mund t’i regjistrojë personat e vdekur sipas

kërkesave. Ndërsa, sa i përket edhe në çështje të gjobave, të cilat nuk janë të konkretizuara dhe nuk ndërlidhen fare me dispozitat ndëshkuese të cilat duhet të jenë me njerëzit kompetent të cilët nuk i respektojnë këto amendamente.

Edhe një herë duhet të shikohet edhe gjendja e cila është, gjendja në Kosovë dhe situata apo sidomos në pjesët rurale, në të cilat nuk funksionon për shembull aty që është tentuar të futet ky është përgjegjëse për shërbim të varrimit. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit!

Deputeti Hydajet Hyseni me kartelën e Niazi Idrizit.

HYDAJET HYSENI: Ju faleminderit, zoti kryesues!

Ju përshëndes, zonja e zotërinj deputetë!

E përshëndes edhe Projektligjin e sjellë në Kuvend. Konsideroj një nevojë dhe mendoj se do miratuar si i tillë. Megjithatë, mund t'i bëhen vërejtje ligjit dhe unë do të parashtroj disa prej tyre, dhe po e nis me atë çështjen tonë të zakonshme, çështjen e mospërputhjes gjuhësore.

Në nenin 1 dhe me radhë pothuaj se në të gjitha nenet, në gjuhën shqipe është: “shtetas i Kosovës” gjithkund, por në gjuhën angleze është: “citizen of Kosovo”, që thotë “qytetarët e Kosovës”, kurse në gjuhën serbe është: “gradjani Kosova”. Do të dukej si pedanteri gjuhësore po të ishte vetëm kjo, po mos të prodhonte pastaj edhe një mori komplikimesh brenda në përmbajtje. Parandaj edhe e theksoj, sepse nuk është çështje e standardizimit gjuhësor. Unë madje përfitoj nga rasti që të kërkoj, besoj edhe pajtohemi, që standardizimi gjuhësor, do të thotë, harmonizimi gjuhësor të bëhet para se të vijë në Kuvend, ta bëjë edhe Qeveria dhe jo gjithmonë ne të përballemi me këtë problem.

Ka edhe vërejtje të tjera të tilla, por për të kursyer kohën, nuk po ndalem në to. Kjo që thashë, trajtimi në një gjuhë i shtetasve vetëm, kurse në gjuhët tjera edhe i qytetarëve, që është koncept më i gjerë, reflekton pasoja, sidomos kur trajtohet çështja e të zhvendosurve në Kosovë.

Në nenin 16, pika 2, për qytetarët, në ndonjë variant shtetasit e huaj që janë në Kosovë, kërkohet që të sjellin dokumente relevante shtetërore. Kolegu Idrizi sot e shtroi këtë problem, sidomos për të dëbuarit nga Presheva, Bujanovci e Medvegja, që janë një numër prej diku 12.000 vetash, të cilët çuditërisht trajtohen ndryshe nga të zhvendosurit prej Kosove jashtë saj. Trajtohet ndryshe jo vetëm Presheva, por trajtohen ndryshe edhe qytetarët e dëbuar preshevarë. Pse? Ligji nuk e rregullon këtë çështje, përkundrazi e legalizon edhe një herë anomalinë që u shkakton probleme të shumta qytetarëve të këtyre viseve të dëbuar me dhunë dhe që tani ndodhen në Kosovë.

Ligji e rregullon mirë çështjen e personave të gjetur si thuhet, është fjala për foshnjat kryesisht, por nuk merret fare me çështjen e të pagjeturve, është afër edhe “Dita e të pagjeturve” dhe kjo çështje do një vëmendje të shtuar. Unë jam i vetëdijshëm për ndërlikshmërinë e kësaj çështjeje. U tha edhe sot se për këtë çështje përgatitet edhe një

ligj. Shfrytëzoj vetëm rastin për të insistuar që ky ligj të përshpejtohet dhe të silltet më shpejtë, përndryshe edhe problemet civile të familjeve që kanë të pagjetur, vërtet janë të mëdha.

U theksua edhe këtu vërejtja lidhur me qytetarët e vdekur dhe regjistrimin e tyre. Është thënë aty diku që “shërbimet e gjendjes civile mund të bëjnë padi ndaj atyre që nuk i kanë regjistruar” por është aq e **vagët** si thuash sa nuk thotë gjë, kurse te dispozitat ndëshkimore është paraparë ndëshkimi me 20 euro për ata që nuk i regjistrojnë të vdekurit, e ju e dini që këtë pazarin tonë për vota, vota ka kushtuar pak më shumë se 20 euro. Për të mos folur pastaj për pensionet që në shumë raste i shfrytëzojnë edhe familje që kanë të vdekur, në emër të të vdekurve, ata që janë më afër të kësaj fushe, e dinë këtë mirë.

Në nenin 48 edhe kjo është vërejtja ime e fundit, shtetasi shpallet i vdekur në kushtet që e përcakton ligji, por referenca është te Ligji për procedurën kontestimore, kurse ne sot këtë ligj duke miratuar në parim Ligjin për noterinë e obligojnë Qeverinë që brenda një viti ta sjell në Kuvend këtë ligj. Mendoj kjo praktika për, që me një ligj të parashihet miratimi i një ligji tjetër është e kontestueshme dhe do të ishte mirë të evitohet. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit!

Nuk ka tjerë të paraqitur.

Sipas radhës, përfaqësuesi i Qeverisë, në qoftë se e donë fjalën, zoti Rexhepi

MINISTRI BAJRAM REXHEPI: Ju faleminderit, i nderuari kryesues!

Unë vetëm desha t’ju falënderoj, por meqenëse Donika i parashtrroi disa pyetje, do të provoj t’i përgjigjem.

Fillimisht ky ligj ka qenë, si thashë në fjalën hyrëse në ekspozë edhe më herët dhe për shkak të shpërbërjes së Parlamentit është kthyer edhe një herë nëpër Qeveri dhe ka ardhur, kështu që ka qenë në Parlament edhe para se të fillojnë bisedimet dhe nuk lidhet drejtpërdrejtë me çështje të bisedimeve. Ne i kryejmë punët tona, bisedimet i kanë punët e veta dhe tjetër kush i ka kompetencat për këtë. Sa i përket, u përmendën disa forma, çështja se nuk mund të bëhet varrimi pa e marrë lejen ose pa e lajmëruar të vdekurin, natyrisht që kjo lidhet edhe me pastërtinë e regjistrimit civil, por edhe listat e votuesve më vonë edhe është forma gati më e sigurt për t’i detyruar familjarët që t’i lajmërojnë ata që kanë vdekur dhe të pastrohet lista nga emrat e tyre, për arsye se unë edhe... kam qenë mjek, nuk ka funksionuar certifikata e mjekut, një pjesë e marrin një pjesë nuk i qojnë te mjeku fare, kështu që ajo nuk ka qenë formë efikase të pastrohet regjistri civil dhe do të jemi të detyruar. Natyrisht, këtu ka modalitete që bashkësitë fetare duhet ta luajnë rolin e vet që i kryejnë ato ceremoni ose të stimulohen dhe, në një mënyrë të pastrohet regjistri civil.

Sa i përket asaj se a të gjithë qytetarët e Kosovës, duke përfshirë edhe pjesën veriore se a do të regjistrohen? Sado që është modeste – simbolike, na e kemi Zyrën për regjistrimin civil në veri, mund të them se një pjesë e madhe e komunitetit serb janë të regjistruar,

regjistrohen për arsye se edhe e nxjerrin letërnjoftimin ose pasaportën, si obligim për përfitime nga Qeveria e Kosovës s e kanë të obliguar të pajisen me këto dokumente, prandaj një pjesë e madhe e tyre janë të regjistruar. Dhe, po ashtu mund të them se regjistri civil është në përfundim e sipër skanimi – digjitalizimi, por prapë është ë proces që vazhdon dhe ata të cilët eventualisht nuk janë regjistruar, gjithnjë kanë mundësi të regjistrohen dhe të korrigjohet ky.

Ndërsa, këtë nuk do ta kisha lidhur drejtpërdrejtë me regjistrimin e popullatës, janë dy procese që dallojnë shumë njëri me tjetrin dhe unë nuk e lidhi me atë se a është bërë regjistrimi i popullsisë në veri për arsye se ky është një proces krejt tjetër. Natyrisht, nuk ishte qëllimi këtu as të debatojmë, por pak a shumë provoj të jap disa sqarime për disa çështje që u ngritën. Edhe njëherë ju falënderoj për të gjitha sugjerimet dhe ne do të jemi të hapur që edhe në aspektin gjuhësor, teknikisht apo aty ku ka vërejtje që duhet të inkorporohen, ta bëjnë ligjin më funksional. Jemi të gatshëm të kontribuojmë edhe ne dhe ta bëjmë një ligj..

Ndërsa, sa i përket liberalizimit të vizave, është natyrisht njëri ndër dokumentet kryesore edhe për liberalizimin e vizave, por edhe në Raportin e progresit që kërkohet Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit, zoti ministër!

Tani ju njoftoj që në sallë janë 90 deputetë. Lus regjinë dhe deputetët le të përgatiten për votim. Votojmë, tani.

Konstatohet që me 81 vota “për”, 4 abstenime, 5 “kundër”, Kuvendi miratoi në parim Projektligjin për gjendjen civile.

Kërkohet nga komisioni funksional dhe komisionet e përhershme që në afatin e paraparë me Rregulloren e Kuvendit, ta shqyrtojnë Projektligjin dhe Kuvendit t’i paraqesin raportet me rekomandime.

Në qoftë se nuk jeni lodhur, i kemi edhe dy projektligje, t’i kishim miratuar edhe këto edhe e përfundojmë seancën. Atëherë, vazhdojmë me pikën e nëntë të rendit të ditës.

9. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për tregtinë e brendshme

Në bazë të nenit 56 të Rregullores së Kuvendit, Komisioni funksional ka shqyrtuar Projektligjin dhe Kuvendit ia kanë paraqitur raportin me rekomandime. Andaj, janë përmbushur kushtet për shqyrtim në parim të këtij Projektligji.

Ftoj ministren e Tregtisë dhe Industrisë, zonjën Mimoza Kusari Lila, që në emër të Qeverisë së Republikës së Kosovës, para deputetëve të Kuvendit, të prezantojë dhe arsyetoj Projektligjin. Regjia, fjalën ministres!

MINISTRJA MIMOZA KUSARI-LILA: Ju faleminderit, kryesues!

Të nderuar deputetë,

Para jush paraqes përmbajtjen e Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 2004/18 për tregtinë e brendshme.

Arsyeja për ndryshimin e Ligjit, është përmbushja e objektivave në lehtësimin e procedurave dhe fillimin, (më falni) dhe fillimin e punës së bizneseve si dhe krijimit të një mjedisi më të favorshëm afarist, në mënyrë që ligji të gjejë zbatim të plotë në praktikë. Po ashtu disa nene të Ligjit në fuqi, janë në kolizion me Ligjet tjera si në rastet e caktuara vështirësojnë zbatimin e tij dhe ligjeve. Si për shembull, Ligji për shoqëri tregtare dhe Ligji për Inspektionin e Tregut. Ky projektligj do të rregulloj nxitjen dhe pjesëmarrjen e konkurrencës së lirë dhe të drejtë në tregun e Kosovës, eliminon sjelljet e paligjshme dhe praktikën e pandershme tregtare si dhe rregullon një treg të qëndrueshëm i cili do të ndikojë në lëvizjen e lirë të mallrave, shërbimeve, njerëzve dhe kapitalit.

Ndryshimet themelore të cilat janë propozuar për ndryshim në Ligjin aktual janë: leja e punës është hequr pasi konsiderohet si pengesë për përmirësimin e mjedisit afarist në Republikën e Kosovës dhe ndikon në ngritjen e pozitës së Kosovës në nivelin ndërkombëtar dhe bërjen biznes.

Janë harmonizuar afatet kohore procedurale që konsiderohen si lehtësime për investitorë nga jashtë në harmoni me Ligjin për inspektoratin dhe janë përcaktuar afate shumë më të shkurta dhe optimale me qëllim të efikasitetit në punë ndaj palëve. Janë fshirë disa nene. Neni 39 i cili flet për kushtet minimale profesionale dhe është bërë ndryshimi në nenin 61.3, i cili nen përcakton gjobën dhe nenet të ndërlidhura.

Ndryshimet dhe plotësimet në Projektligjin për ndryshim dhe plotësim, e Ligjit nr. 2004/18 për tregtinë e brendshme, janë harmonizuar me direktivat dhe legjislacionin e Bashkimit Evropian dhe me ligjet e tjera në fuqi dhe është në përputhje të plotë me praktikën e hartimit të legjislacionit sa i përket harmonizimit dhe standardizimit.

Gjithashtu, ky ndryshim ndikon në rritjen e besueshmërisë së qytetarëve, mbështetjen e fuqishme të biznesit kosovar si dhe lehtësinë për investitorë nga brenda dhe jashtë për të ushtuar aktivitetin në Republikën e Kosovës. Edhe një herë duke qenë të vetëdijshëm për rëndësinë e këtij projektligji dhe duke pasur parasysh nevojën e krijimit të një mjedisi më të favorshëm në Republikën e Kosovës, si dhe ngritjen e pozitës së Kosovës në nivel më të lartë ndërkombëtar, në rejtingun e Bankës Botërore për të bërë biznes, ju ftoj që ta votoni amendamentimin e këtij projektligji. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit, zonja ministresh!

Pas prezantimit të projektligjit, hapi debatin për diskutim në parim. Kryetari i Komisionit funksional, Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri, deputeti Zenun Pajaziti, e ka fjalën.

ZENUN PAJAZITI: Ju faleminderit, zoti kryesues!

Kabinet qeveritar,
Të nderuar deputetë,

Po ashtu edhe ky projektligj është trajtuar në mbledhjen e fundit të datës 26.4. 2011 nga Komisioni FunkSIONAL Zhvillim, Ekonomi, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri, ka trajtuar, ka shqyrtuar të gjitha edhe është debatuar për të gjitha ndryshimet. Kemi pasur po ashtu edhe ministren prezent dhe po ashtu dëshiroj që t'ju them që në paket edhe ky projektligj nuk ka arritur që të kalojë ose të kemi, nuk kemi arritur si Komision të kemi rekomandim pozitiv. Pra ka qenë votim i barabartë i balancuar. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit! N

Tani, kryetarët ose përfaqësuesit e grupeve parlamentare. Në emër të PDK-së, Zenun Pajaziti

ZENUN PAJAZITI: Ju faleminderit, zoti kryesues!

Edhe ky projektligj është në pakon e projektligjeve të cilat Qeveria i ka evidencuar dhe i ka propozuar Parlamentit si grup ligjesh të cilat konsiderohet se përmirësojnë ndjeshëm mjedisin biznesor në Kosovë. Ministria e Tregtisë dhe Industrisë e ka sqaruar arsyeshmërinë, po ashtu e dëgjuam edhe ministrin, për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit numër 2004/18 për tregtinë e brendshme. Është një ligj i cili krijon kushte dhe duhet të gjejë zbatueshmëri të plotë në krijimin e kushteve më të favorshme për tregun e brendshëm në vend.

Për shkak të disa neneve të këtij ligji që janë në kolizion me ligjet tjera dhe në raste të caktuara vështirësojnë zbatimin e tij dhe ligjeve tjera, si Ligji për shoqëritë tregtare dhe Ligji për inspeksionin e tregut, ky projektligj është harmonizuar edhe me ligjet tjera në fuqi, andaj edhe ndryshimet në këtë ligj i janë përshtatur rrethanave në Kosovë.

Ndryshimet dhe plotësimet e këtij ligji nuk kanë implikime buxhetore dhe po ashtu në aspektin formalo-juridik Projektligji është harmonizuar me Rregulloren e BE-së. Të gjitha kushtet tjera janë të plotësuara që ky projektligj të kalojë dhe të shkojë në leximin e dytë. Unë i siguroj anëtarët e komisionit dhe të gjithë deputetët dhe po ashtu edhe me bashkëpunimin e Ministrisë përkatëse do të punojmë në ndryshimin e nevojshme në nene të caktuara, të cilat edhe i kemi debatuar në komision, në mënyrë që ky projektligj të realizohet sa më shpejt në afatin e paraparë dhe në mënyrë që të jetë në kuadrin e këtyre ligjeve tjera që duhet dhe janë esenciale për të krijuar një mjedis biznesor sa më të përshtatshëm në Republikën e Kosovës.

Në emër të Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike të Kosovës deklaroj se jemi në mbështetje të këtij projektligji dhe po ashtu i ftoj edhe grupet tjera dhe deputetët që të mbështesin Projektligjin dhe të japim shansin në leximin e dytë të bëjmë ndryshimet e nevojshme. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Në emër të Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike të Kosovës, deputeti Lutfi Zharku e ka fjalën!

LUTFI ZHARKU: I nderuar kryesues,
Zëvendëskryeministra, ministër,

Duke pasur parasysh rëndësinë e këtij ligji për ekonomi në përgjithësi, e posaçërisht për përmirësimin e ambientit për biznes, ne mendojmë se Projektligji i propozuar nuk përmbush nevojat e domosdoshme për ndryshime serioze në fushën e fillimit të biznesit. Për më tepër, Projektligji i propozuar edhe më tutje nuk përmirëson konfliktet e ligjit në fuqi me ligjet tjera, kurse në disa dispozita ende lejon konfuzitet. Projektligji nuk përfshin një rirregullim rrënjësor të tregtisë së brendshme, por në mënyrë sipërfaqësore ndryshon disa dispozita, efekti i të cilave në praktikë do të jetë i kufizuar.

Nëse abstrahojmë nenet që kanë të bëjnë me disa përkufizime dhe rregullime gjuhësore, esenca e ndryshimit dhe plotësimit të këtij projektligji qëndron në përpjekjet për anulimin e lejeve të punës për ushtrimin e veprimtarisë tregtare që i lëshojnë kuvendet komunale përmes fshirjes së disa paragrafëve të nenit 38 dhe taksës që paguhet për të, si dhe ndryshimin e lartësisë së gjobave përmes riformulimit të neneve 60 dhe 61.

Megjithatë, heqja e lejeve të punës nuk është sqaruar në tërësi, duke marrë parasysh se nuk janë ndryshuar të gjitha dispozitat që i referohen kësaj çështjeje. Për shembull, neni 53.1 i Ligjit në fuqi ende përcakton se inspektori mund të ndalojë përkohësisht ushtrimin e veprimtarisë tregtare nëse aktiviteti tregtar nuk ka leje pune.

Për më tepër, edhe Projektligji për ndryshimet dhe plotësimet e Ligjit për tregtinë e brendshme që po e shqyrtojmë sot, në nenin 13, me të cilin riformulohen gjobat, përcakton ndëshkimet për mosposedim të lejes për ushtrimin e veprimtarisë tregtare. E gjithë kjo vërteton mosekzistimin e konceptit mbi mënyrën e rregullimit të kësaj fushe. Përveç kësaj, këto dispozita nuk janë në harmoni me dispozitat e nenit 17, paragrafi N të Ligjit për vetëqeverisje lokale, i cili përcakton licencimin e objekteve, përfshirë ato tregtare, si kompetencë vetanake komunale.

Ne mendojmë se kjo çështje duhet të rregullohet në atë mënyrë që lejon bizneset për zhvillimin e aktivitetit tregtar menjëherë pas regjistrimit të biznesit, por pa e eliminuar obligimin për pajisje me leje pune nga ana e pushtetit komunal, e cila në çdo kohë do të kishte të drejtën e verifikimit të plotësimit të kushteve për zhvillimin e veprimtarisë tregtare dhe lëshimin e lejes së punë, apo si zgjidhje alternative do të ishte lëshimi i lejes së punës nga ana e organeve komunale në një afat prej maksimum 8 ditësh kalendarike nga dita e aplikimit.

Në anën tjetër, taksa për lejen për ushtrimin e veprimtarisë afariste është e rregulluar me Ligjin për financat e pushtetit lokal dhe është kategori e të hyrave komunale.

Përndryshe, Projektligji për ndryshimet dhe plotësimet e Ligjit për tregtinë e brendshme duhet të riformulojë dhe ripërkufizojë dispozitat që kanë të bëjnë me ndalimin e çfarëdo aktiviteti tregtar pasi të regjistrohet biznesi, shitësit me shumicë dhe objektet e ushtrimit të tregtisë me shumicë, ndërmjetësit e vetë punësuar të cilët mund të ushtrojnë veprimtari tregtare, por ligji në fuqi nuk i obligon të regjistrojnë biznesin e tyre, çka nënkuptohet me konsumatorë mesatarë, të rishqyrtojë dispozitat që kanë të bëjnë me veprimtarinë e agjentëve tregtarë, pasi që kjo rregullohet me kontratë në mes palëve, të rishqyrtojë çështjen e evidencës së librave të kontabilitetit, pasi që kjo çështje është kompetencë e

Ministrisë së Financave, gjegjësisht Administratës Tatimore, çështjen e mbikëqyrjes në implementimin e këtij ligji, pasi Ligji në fuqi lejon përzierje të kompetencave në mes inspektoratit të tregtisë, inspektorateve tjera dhe doganës, si dhe rregullimin e disa gabimeve teknike të dispozitave të Ligjit në fuqi që mund të shkaktojnë konfuzion në interpretimin e tyre.

Duke i marrë parasysh të gjitha këto vërejte si dhe bazuar në rekomandimin e komisionit funksional, ne propozojmë që ky ligj të kthehet në ripunim. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Në emër të Grupit Parlamentar “Vetëvendosje”, deputeti Visar Ymeri e ka fjalën!

VISAR YMERI: Faleminderit!

Në përgjithësi, ndryshimet që janë bërë në këtë ligj, pra për tregtinë e brendshme, janë pak ndryshime dhe nuk mund të thuhet që ka ndryshime kushedi sa substanciale, siç po pretendohet të thuhet këtu dhe janë hequr disa paragrafë aty, të cilët edhe në ligjin origjinal pra kanë qenë absurd i llojit të vet, siç është për shembull paragrafi që thotë që konsumatori s’mund të heq dorë nga të drejtat që i takojnë. Ky është hequr dhe është përmirësuar.

Konsiderojmë që Ligji ose propozimi për ndryshimet e ligjit, i cili po ashtu në paket nuk ka kaluar në Komisionin për Zhvillim Ekonomik, Tregti dhe Industri. Në parim, nuk ka asgjë të keqe dhe ne si Lëvizje “Vetëvendosje” do ta mbështesim këtë lexim të parë të këtij ligji, por natyrisht do të jemi po ashtu edhe të angazhuar që ato ndryshime rrënjësore që i nevojiten këtij ligji, jo vetëm ato të propozuara, por edhe ato të tjerat, t’i paraqesim përmes komisionit dhe pastaj po ashtu t’i diskutojmë në seancën tjetër. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, deputeti Ardian Gjini e ka fjalën!

ARDIAN GJINI: Faleminderit, zoti nënkryetar!

Mendoj se për shkak të mos studimit, qoftë të situatës, qoftë të asaj që ka qenë ekzistuese si provizion ligjor ose provizionet ekzistuese ligjore dhe për shkak se dikujt i ka rënë në mend ta ndryshojë ligjin për diçka tjetër dhe gjatë punës i kanë dalë edhe disa nene të cilat dikush ka menduar se duhet të ndryshohen, kemi ardhur në situatë në të cilën Kuvendi i Kosovës e ka parë disa herë, e ajo është se edhe nëse ky ligj miratohet sot, edhe nëse ky ligj i kalon komisionet dhe votohet edhe në lexim të dytë, brenda 3 ose 4 muajsh dikujt prapë ka për t’i rënë në mend ta ndryshojë dhe kemi për të pasur kërkesë për amendim të Ligjit dhe për ndryshim të Ligjit diku brenda 6 muajve deri në 1 vit, maksimum. Kjo është arsyeja pse prapë po themi se nuk duhet të votohet, duhet të kthehet në rishikim, duhet të punohet pak më tepër në ligj dhe të vjen këtu, në mënyrë që të mos kemi ndryshime të ligjeve për çdo ditë. Domethënë, nëse dikush e merr dhe e sheh vetëm agjendën legjislativë që e kemi para vetes, keni për të parë që nuk ka asnjë ligj i cili është miratuar prej vitit 2007 e deri sot, ose mos të them asnjë, shumica e ligjeve që janë miratuar prej vitit 2007 deri sot duhet të amendohen dhe duhet të ndryshohen prapë.

Mendoj se mënyra e punës kështoj çfarë e pamë sot, pa hyrë në detaje prapë, është e njëjtë sikur të kalohet nëpër materie shpejt e shpejt pa e studiuar, të rregullohet një element i vogël dhe të prishen pesë ose gjashtë elemente tjera dhe, fundi i fundit, kjo është ngarkesë edhe për administratën, edhe për Kuvendin është humbje e kohës, mirëpo mbi të gjitha nuk po i ndihmon zhvillimit të Kosovës, as biznesit, as cilitdo aspekt tjetër zhvillimor rreth të cilëve edhe mund të thuhet se ligji do të ketë ndikim të drejtpërdrejtë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Në emër të Grupit Parlamentar Koalicioni Kosova e Re, deputetja Muzejene Selmani e ka fjalën.

MUZEJENE SELMANI: Faleminderit, zoti kryesues!

Duke marrë parasysh çështjen e prezantimit të Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit 2004/18 për tregti të brendshme, mund të thuhet se gjatë draftimit apo projektimit të këtij ligji ka lëshime dhe ka mos harmonizime me ligjet e ministrive tjera, mirëpo duke pasur parasysh se këtu u dhanë vërejtjet edhe nga grupet parlamentare të cilat janë në seancë plenare, sugjeroj që të gjitha vërejtjet të merren parasysh dhe t'i dedikohen komisionit parlamentar për arsye që ky ligj në përfundim të leximit të dytë të dalë një ligj i cili shkon në favor të ekonomisë dhe të bizneseve në Kosovë. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Në emër të Grupit Parlamentar SLS, deputeti Sasha Rashiq!

SAŠA RAŠIĆ: Hvala, poštovani predsjedavajući!

Parlamentarna grupa Samostalne liberalne stranke razmotrila je dakle Nacrt zakona o izmeni i dopuni Zakona o unutrašnjoj trgovini. Razmotrili smo i preporuke koje smo dobili od funkcionalne komisije. Svakako da i ovaj zakon sadrži određene nedostatke i propuste, ali verujući da ćemo te nedostatke otkloniti, da će se ti nedostaci otkloniti u drugom razmatranju ovog zakona na funkcionalnoj komisiji, mi ćemo u načelu zakon podržati, opet sugerisajući da se nedostaci otklone. Hvala!

KRYESUESI: Faleminderit! “6+” nuk është paraqitur. Po, shtype vëlla, se na tash... Shtype e ta dimë që doni të flisni. Deputeti Albert Kinolli, në emër të Grupit Parlamentar “6+”.

ALBERT KINOLLI: Faleminderit!

I nderuar kryesues,

I nderuar Kabinet qeveritar,

Të nderuar kolegë deputetë,

Grupi Parlamentar “6+”, pas shqyrtimit të këtij projektligji për tregti të brendshme ka parasysh mangësitë e tij, por do ta mbështes në parim dhe do ta votojë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Për fjalë është paraqitur, do të thotë radha është e deputetëve tani, për fjalë është paraqitur deputetja Sala Berisha-Shala.

SALA BERISHA-SHALA: Faleminderit, kryesues!

Përshëndetje Kabinet qeveritar,
Përshëndetje të veçantë ministres së Tregtisë dhe Industrisë,
Të nderuar kolegë deputetë,
Përshëndetje për të gjithë të pranishmit këtu!

Kjo është një pako e projektligjeve që e ka sjellë Ministria e Tregtisë dhe Industrisë në Kuvend dhe ne në komision e kemi pasur në rend dite dy herë. Dhe është shumë e çuditshme se komisioni dy herët e ka refuzuar, domethënë është votuar kundër këtyre projektligjeve dhe deputetët e opozitës nuk kanë sjellë asnjë argument pse duhet të kthehen këto projektligje, por unë sot e mora fjalën për ta cekur më tepër një fenomen të kësaj çështjes refuzuese opozitare të projektligjeve dhe të strategjive që po e përcjellin komisionin parlamentar, por edhe Kuvendin në përgjithësi.

Unë kam menduar dhe kam shpresuar se do të ndikojë pozitivisht me përvojën e sjellë si ish ministër i Tregtisë dhe Industrisë zoti Zharku, por po ndodh e kundërta. Ky është një fenomen që e ka përcjellë komisionin edhe në mandatin e kaluar dhe do ta sjellë një përvojë tjetër të mandatit të kaluar se ka qenë i përbërë prej më shumë ish ministrave komisioni dhe kanë qenë më tepër frenues dhe pengues të draft ligjeve dhe strategjive se sa iniciues dhe shtytës të tyre. Dhe ky fenomen është një tregues negativ i kësaj mendësie, në vend që të jetë e kundërta dhe nuk di se si të kualifikohet, të merret se, sipas logjikës, aty ku s'jam unë, nuk punohet mirë, apo për inati, nuk e di çfarë – personale, po uroj që të ndryshohet diçka në këtë legjislaturë dhe zoti Zharku dhe të gjithë ata që e kanë përvojën nga Qeveria të kontribuojnë pozitivisht me përvojën e tyre në komision.

Në komision është interesant se votimi ka qenë me një inercion opozitar, gjithçka refuzues, dhe refuzimi i projektligjeve nuk e di se si të merret, të merret si ikje nga detyra kryesore e deputetëve që e kanë për obligim të bëjnë ligje, obligimi primar dhe obligimi i dytë menjëherë pas kësaj është që të bëhet monitorimi i këtyre ligjeve dhe kjo të çon në logjikën se, do të thotë, i ikin punës së vet për të cilën janë votuar apo një mendësie krejt tjetër.

U përmend këtu nga disa deputetë, e përcolla me vëmendje diskutimin e këtyre projektligjeve që i sjell Ministria e Tregtisë dhe Industrisë dhe pat një qasje nga deputetët e opozitës që janë për herë të parë në Kuvend se iu mungon mekanizmi potencial mbikëqyrës këtyre ligjeve. Duhet ta dinë se mekanizëm potencial mbikëqyrës i ligjeve është Kuvendi, që e ka menjëherë detyrën e dytë pas bërjes së ligjeve. Dhe këto projektligje, po e përsëris, nuk është e tepërt, nuk po vijnë në Kuvend dhe nuk janë kthyer për shkak të mangësive të tyre, por në Kuvend janë kthyer për plotësim dhe ndryshim për shkak të ndërprerjes së mandatit të legjislaturës së kaluar. Po, e mira e së mirës është që këto ligje prapë po votohen me shumicën e votave dhe ju ftoj, deputetë, ta miratoni edhe këtë ligj dhe i ftoj anëtarët e komisionit – kolegë në Komisionin parlamentar, që në komision t'i shprehin të gjitha energjitë dhe përvojat pozitive, në mënyrë që t'i kryejmë obligimet tona si deputetë, sepse këtu e kemi edhe një listë të ligjeve që e ka sjellë Qeveria, që i ndihmon frymës së biznesit të mirë në Kosovë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka deputeti Arben Gashi!

ARBEN GASHI: Faleminderit, i nderuar kryesues!

Të nderuar kolegë deputetë,

Unë kuptoj dëshirën e Qeverisë dhe të përfaqësuesve të pushtetit që me çdo kusht ta kalojnë atë çka ata mendojnë se është e mirë për ta, po jo që ata nuk e mendojnë diçka çka është e mirë për Kosovën. Jam i bindur në këtë pikë dhe në qoftë se interesi i deputetëve të pushtetit dhe i pushtetarëve të Kosovës është që të kalojnë nëpër seanca ligje dhe projektligje me dallim dy-tre vota, është diçka që është e papranueshme në konceptin e qëndrueshmërisë ligjore dhe në konceptin e qëndrueshmërisë institucionale.

Ky defekt që po ndodh me sistemin, duke kaluar në seancë plenare ligje të cilat nuk kanë mund të kalojnë...

KRYESUESI: Të lutem, përmbaju rendit të ditës, për ligjin po flasim! Nuk kemi hap debat për Qeverinë!

ARBEN GASHI: ...nuk kanë mund të kalojnë në komisionin përkatës, qysh nuk ka kaluar as ky projektligj, që po flasim, se nuk ka kaluar në komisionin përkatës dhe bëhet presion që me çdo kusht të kalojë në seancë plenare. Andaj, mendoj se ky ligj dhe ligjet tjera që kanë kaluar këtu, siç është edhe ligji - pjesa e ligjit ku përfshihet edhe për inspektoratin dhe pastaj shkaktohet aq konflikt dhe aq tollovi në sistemin, edhe në sistemin juridik po edhe në sistemin praktik dhe administrativ në Kosovë, kemi problematika të tilla ku u përmend edhe nga ministrja, që tha Ligji për inspektoratin na lejon që të marrim kompetenca dhe të krijojmë një situatë ku kontrollohet edhe tregtia e brendshme dhe ku të kemi një realitet më të mirë në bamjen e tregtisë, ky ligj pikërisht edhe ligjet tjera që lidhen me këtë ligj po shkaktojnë një destabilitet edhe në aspektin e tregtisë së brendshme, sepse po krijohet një sistem i tillë ku po centralizohen përgjegjësitë dhe autoritetet po merren nga niveli komunal dhe po çohen në nivel qendror.

Ju duhet të jeni të vetëdijshëm për këtë çka po bëhet dhe mund të shihni me kompetencat për Inspektoratin e Tregut se çfarë tollovish po shkaktohen, ku po centralizohen kompetencat nga niveli qendror në nivel lokal dhe pastaj ku shihet që s'mund t'i kryejnë këto kompetenca, thërrasin komunat dhe u thonë kryetarëve të komunave - hajde tash të nënshkruajmë ne memorandum mirëkuptimi që t'ua kthejmë kompetencat juve.

Ky është një mentalitet i cili nuk do të japë rezultat dhe një mentalitet qeverisës dështues. Prandaj, unë ju kisha lutur shumë që këto ligje në komisione t'i trajtojnë më me kujdes dhe të marrin të paktën përkrahje në komision dhe pastaj kur të vijnë në seancë, të kemi ligje më kualitative dhe jo ligje të cilat plotësojnë tekat dhe dëshirat e përfaqësuesve të Qeverisë dhe të përkrahësve të tyre në Parlament. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Ismet Beqiri e ka fjalën!

ISMET BEQIRI: Zoti kryesues,

Pikërisht për atë që i thatë zotit Gashi, e mora fjalën për t'u lutur dhe kërkuar në emër të Grupit Parlamentar që të jesh njësoj ndaj të gjithëve. Edhe parafolësja lidhje s'pati me

rend të ditës dhe nuk është ajo për të cilën do të duhej moralizuar dhe të na tregosh ne opozitës çka duhet bërë.

Unë po kërkoj në emër të Grupit Parlamentar, sepse sot gjatë gjithë seancës nuk keni qenë korrekt, duke filluar nga kryetari, e keni vazhduar ju, në trajtimin e deputetëve njësoj si të pozitës, si të opozitës. Nëse vërtet i keni marrë detyrat kësisoj, atëherë vazhdoni, mirëpo nuk është korrekte - për dikë, siç thuhet në popull, nënë, për dikë njerke dhe ju e patë, ia tërhoqët vërejtjen zotit Gashi, a nuk ia tërhoqët deputetes paraprake që s'kishte lidhje me rendin e ditës.

KRYESUESI: Po ta tërheq edhe ty!

ISMET BEQIRI: Jo, unë e kreva! Unë, e kreva!

KRYESUESI: Është paraqitur, por nuk e di për çka. A e ke kryer fjalën? Po, është dashur të paraqitesh me kohë, jo pas tre diskutuesve tash. Nuk ke të drejtë kështu. Vazhdo, merre fjalën për replikë, por paraqitu menjëherë. Unë bash e këqyra a po paraqitesh, s'u paraqite, ke harruar. Lutfi Zharku e ka fjalën!

LUTFI ZHARKU: Faleminderit, kryesues!

Nuk po e komentoj Rregulloren, natyrisht ju e keni autoritetin për ta interpretuar Rregulloren. Megjithatë, desha, për zonjën Berisha, po më duket se absolutisht s'ka dëgjuar çka kam folur unë në tri prezantimet e mia apo e kam bindjen tjetër se ndoshta përkatësia partiake ia ka mbyllur sytë edhe veshët. Faleminderit!

KRYESUESI: Kundër replikë, Berisha! Sala Berisha-Shala, kundër replikë, për një minutë!

SALA BERISHA-SHALA: Faleminderit, kryesues!

Edhe unë e kam një pyetje shumë të thjeshtë për zotin Zharku. Këto projektligje as me pikë e as me presë, sidomos dy të parat s'kanë ndryshuar prej kohës kur ju keni qenë ministër dhe i keni sjellë në Kuvend. Pse atëherë keni thënë se janë të mira duhet të votohen, e tash po thoni - nuk janë të mira, duhet të kthehen. Ko të çon në atë çka thashë më herët, se këtu është fjala – kur s'jam unë aty, nuk është mirë.

KRYESUESI: Përfaqësuesi i Qeverisë, sipas rregullit!

MINISTRJA MIMOZA KUSARI - LILA: Ju faleminderit, deputetë të nderuar, për komentet!

Gjithashtu, siç e dimë të gjithë, është leximi i parë, prandaj një numër i rekomandimeve të prezantuara këtu do të reflektojnë në leximin e dytë të këtij projektligji. Një sqarim lidhur me aspektin përmbajtjesor të zbatimit të ligjit, i cili iu ngrit këtu në disa pika. Ka të bëjë me përzierjen e kompetencave, gjegjësisht me heqjen e lejes së punës në nivelin komunal dhe me përzierjen e kompetencave të Inspektoratit Komunal dhe të atij Qendror.

Leja e punës në nivelin komunal ka qenë si një dokument shtesë ose një procedurë shtesë për komunitetin e biznesit pas regjistrimit të biznesit në Ministri për Tregti, Tregti e Industri, marrjes së numrit fiskal, marrjes së certifikatës së TVSH-së dhe marrjes së numrit në dogana. Domethënë, kemi të bëjmë me një numër të madh të dokumenteve të cilat biznesi duhet t'i sigurojë para se të fillojë punën. Prandaj, është vlerësuar që, duke filluar prej heqjes së lejes së punës në nivelin komunal, do të hiqet një kosto dhe një kohë shtesë e vënë për biznesin.

Ndërsa, sa i përket të hyrave dhe korrespondimit të këtij ligji me Ligjin mbi financat komunale, gjithsesi se kjo do të reflektojë drejtpërdrejt në këtë ligj, por edhe do të ndikojë në ngritjen e të hyrave në kuptimin e përmirësimit të biznesit dhe të ambientit të biznesit. Por, të njëjtat komente, edhe me raportimet financiare do të vlejné edhe për këtë ligj, sikurse edhe për Ligjin për shoqëritë tregtare.

Ndërsa, nuk kam nevojë t'ju rikujtoj se Ligji mbi inspektoratin ka kaluar në legjislaturën e kaluar, ndërsa ne tani po i bartim pasojat, por gjithsesi besoj se me një vullnet të mirë edhe të kuvendeve komunale, por edhe të Ministrisë së Tregtisë dhe të Industrisë që komunat ta kenë kompetencën mbi rregullimin e tregut, do ta tejkalojmë këtë vështirësi, ndërsa komentet tuaja janë të mirëseardhura. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Të nderuar deputetë, në vazhdim kërkojmë deklarin me votim për miratim, në parim, të Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për tregtinë e brendshme.

Në mbledhje janë prezentë 89 deputetë. Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim dhe votojmë tash:

Konstatoj që me 51 vota “për”, 33 vota “kundër”, 3 “abstenime”, Kuvendi miratoi, në parim, Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për tregtinë e brendshme.

Kërkohet nga komisioni funksional dhe komisionet e përhershme që në afatin e paraparë me Rregulloren e Kuvendit ta shqyrtojnë Projektligjin dhe Kuvendit t'i paraqesin raportet me rekomandime.

Pika e dhjetë e rendit të ditës, është:

10. Plani i veprimit i Kuvendit për integrimet evropiane, për vitin 2011

Komisioni për Integritime Evropiane, në bazë të Raportit të progresit të Komisionit Evropian për Republikën e Kosovës, për vitin 2010, ka përgatitur Planin e veprimit të Kuvendit për integritime evropiane, për vitin 2011, dhe Kuvendit i ka rekomanduar për miratim.

Sipas radhës, ia japim fjalën kryetarit të Komisionit për Integritime Evropiane, deputetit Lutfi Haziri, për arsyetimin e Planit të veprimit.

LUTFI HAZIRI: Faleminderit, zoti kryesues!

Ministra,

Të nderuar deputetë,

Komisioni për Integritet Evropian, në pajtim me detyrën kushtetuese, neni 65, dhe Rregulloren e Punës së Kuvendit të Republikës së Kosovës e ka shqyrtuar Raportin e progresit të Komisionit Evropian për Republikën e Kosovës në periudhën kohore të vitit 2010, për shkak se është legjislatura e katërt, dhe ne kemi arritur që gjatë shqyrtimit të Raportit të progresit t'i evidentojmë të arriturat dhe sfidat për Kuvendin dhe institucionet në varësi të Kuvendit.

Për t'i adresuar sfidat e identifikuar në Raport, Komisioni për Integritet ka hartuar Planin e veprimit të Kuvendit, të cilin po e paraqesim para jush dhe natyrisht në pikën tjetër edhe Rezolutën dhe prioritetet që përfshijnë Strategjinë e Kosovës për integritet në Bashkimin Evropian për të shprehur përkushtimin e Kuvendit të Republikës dhe promovimin e agjendës për integritet evropian nga institucionet e Kosovës.

Për dallim nga vitet e kaluara, Plani i veprimit është përqendruar në prioritetet, si në përmbushjen e kriterëve politike që mundësojnë funksionimin e institucioneve që garantojnë demokracinë, sundimin e ligjit, respektimin dhe mbrojtjen e të drejtave të njeriut. Po ashtu, ky komision ka marrë parasysh vërejtjet e ngritura në mandatin e kaluar, respektivisht thjeshtëzimin e planit. Komisioni është ndihmuar në përgatitjen e Planit të veprimit nga ana e Zyrës Ndërlidhëse të Komisionit Evropian, Misionit të OSBE-së në Kosovë dhe shoqërisë civile të përfaqësuar nga KCSF-ja.

Prioritetet shtesë të Planit të veprimit janë marrja e masave për përmirësimin e gjendjes në fushën e liberalizimit të vizave, mirëqenia e qytetarëve, drejtësia dhe mekanizmi i sigurisë.

Natyrisht, ne paraqesim para jush shqyrtimin dhe miratimin e këtij plani, si dhe përmbushjen e aktiviteteve të parapara me plan dhe kërkohet nga të gjitha komisionet parlamentare që të përfshijnë në agjendën e takimeve të tyre të rregullta pika të veçanta të rendit të ditës që lidhen me agjendën evropiane, ku do të shqyrtojnë sfidat e identifikuar në Raportin e progresit për vitin 2010, dhe veprimet në planin tonë të përbashkët.

Informacionet e mbledhura nga Komisioni parlamentar t'i dërgohen Kryesisë së Kuvendit, kryetarit dhe Komisionit për Integritet.

Nën dy, Komisioni për Integritet do të ngarkohet për përgatitjen e raporteve të rregullta me rekomandime mbi zbatimin e Planit të veprimit, të cilat ia dorëzon për shqyrtim seancave plenare për çdo tre muaj. Dhe këtu do ta bëj një përmirësim, se ju e keni pa në plan, në tetë raste përmendet – raportime në seancë nga ana e ministrive, duhet të përmirësohet, është lëshim teknik, ne e kemi diskutuar. Ministrinë relevante raportojnë në komisione dhe komisioni çdo tre muaj i përgatit raport seancës plenare, respektivisht Kuvendit përmes Kryesisë së tij. Dhe gjatë shqyrtimit dhe miratimit të agjendës

legjislative për vitin 2011, Kuvendi do të marrë parasysh të gjeturat rreth mungesës së kuadrit ligjor në Raportin e progresit për vitin 2010.

Atëherë, më lejoni të mos arsyetoj më shumë, sepse e keni të paraqitur me shkrim raportin dhe arsyetimin, pos të shtoj edhe një herë dhe të falënderoj në radhë të parë deputetët nga të gjitha grupet politike që janë të përfaqësuar, qofshin të opozitës, qofshin të pozitës, kanë punuar me përkushtim dhe kanë eliminuar dallimet eventuale në metodën e punës për të përafruar që në këtë agjendë kemi konsensus dhe angazhim të përbashkët dhe në veçanti roli i tyre, raporti i tyre ka qenë jashtëzakonisht pozitiv. Falënderoj shoqërinë civile, e cila është involvuar dhe e cila do ta ketë rolin e vet, në veçanti Kryesinë e Kuvendit, e cila ka proceduar në afat shumë të shkurtër, në mënyrë që raporti i parë që është paraqitur sot këtu, të shqyrtohet nga ju, të miratohet dhe më tutje bashkërisht gjatë këtij viti t'i përcjellim të gjitha sfidat që i kemi përpara nesh.

Dhe, në fund, po ashtu, komisioni e ka dëgjuar raportimin dhe dëgjimin e parë nga ana e ministrisë respektivisht ministres Vlora Çitaku e cila e ka paraqitur Planin e punës së Qeverisë dhe problemet me të cilat ballafaqohet, por ne do ta ushtrojmë vetëm detyrën tonë, si organ më i lartë kushtetues, i cili ka detyrat kryesore sa i përket koordinimit të aktivitetit për Kuvendin, për institucionet në varësi të Kuvendit, e në veçanti do të rritet raporti i monitorimit të ekzekutivit në kuadër të këtyre angazhimeve që përmbledhin agjendën evropiane për Kosovën. Faleminderit, shumë!

KRYESUESI: Faleminderit, zoti Haziri! Tani, sipas radhës, kryetarët ose përfaqësuesit e grupeve parlamentare. Fjalën e ka në emër të PDK-së, Blerta Deliu.

BLERTA DELIU: Faleminderit, kryesues!

Në emër të Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike të Kosovës e përkrahim Planin e veprimit të Kuvendit për integritet evropian, për vitin 2011.

KRYESUESI: Faleminderit! Në emër të Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike, deputeti Sabri Hamiti!

SABRI HAMITI: Zoti kryesues, të përshëndes!

Ne sot po diskutojmë një raport, i cili na kthen me fytyrë kah vetvetja, Kuvendin kah e vërteta. Dhe, nëse harrojmë atë që është proforma çka shkruhet në letër dhe kalojmë në esencë, atëherë performanca e Kuvendit të Republikës së Kosovës, në një përgjasim me kuvendet e vendeve të Bashkimit Evropian, ku duam të shkojmë, mund të krahasohet duke analizuar vetëm këtë çka ka ndodhur sot në Kuvendin tonë, prej se është hapur, deri tash.

Në kapitullin - Demokracia dhe sundimi i ligjit, Kuvendi në dokumentin që na propozon Kuvendi ynë për muajt në vijim, janë disa pika.

E para, thotë: Duhet të përmirësohet procesi i mbikëqyrjes së ekzekutivit.

E dyta, thotë: Duhet të forcohet roli i Kuvendit në shqyrtimin e legjislativit për të siguruar cilësi.

E treta, thotë: Komisioni për Integritet Evropian ende ka nevojë të zhvillojë kapacitetin financiar e administrativ.

Tutje, i katërti, thotë: Ende mbesin shqetësime në fushën e menaxhimit të burimeve njerëzore. Nga sekretari i Kuvendit duhet të bëhet një proces transparent dhe meritore i rekrutimit.

E pesta, Duhet të përmirësohet kapaciteti i Kuvendit për shqyrtim efektiv të legjislacionit në bazë të normave të BE-së.

Të gjitha janë formulime përgjithësuese, po të gjitha duhet të marrin një pamje konkrete pikërisht në Kuvendin e Republikës së Kosovës, këtu ku jemi ne sot, si hera tjera.

Pra, a është ky Kuvend vet, i cili merr përgjegjësi edhe të kontrollojë institucionet që i zgjedh, mbi të gjitha Qeverinë, a është demokratik, a është Kuvend i përgjegjshëm, a është substancial në trajtimin e detyrimeve që i ka?

Edhe njëherë po them, mund të provohet nga një mbledhje, një prerje e një mbledhjeje të zakonshme që kishim ne sot.

Nën një, respektimi i Rregullores, qoftë e mirë, qoftë e keqe që ekziston në fuqi.

Ne sot kishim dy shkelje flagrante të kësaj Rregulloreje. Një, lejohet diskutimi në pikën e rendit të ditës, ku nuk ka diskutime. Nën dy, prova që të merret në kontroll, domethënë në zbatimin e ligjeve, Qeveria prodhon një përgjigje përjashtuese, që merr konotacion ideologjik.

Tutje, problemi i asaj që këtu quhet replikë, e drejta e marrjes ose mos marrjes së fjalës, është një interpretim që u bë shumë i gabueshëm i Rregullores sepse, në rast se një fjalim i kujt do qoftë, qoftë ai deputet, qoftë ministër, që këtu nuk është deputet, edhe me ligj më te ne, i drejtohet kolektivisht një grupi parlamentar ose krejt opozitës, qysh ka ndodhur nja pesëmbëdhjetë herë i regjistrua deri tash, atëherë e drejta e replikës është domosdo. Nuk ka nevojë 45 a 50 deputetëve të opozitës t'ua përmend emrat nëse në mënyrë kolektive me fjalim ideologjik, a, i markon. Këtë merreni, analizojeni te shtëpia Rregulloren, fjala nuk mund të ndalohej. Aq më tepër, kur një ministër që paraqet ligj, bën cilësim ideologjik dhe nuk lejohet që anëtar i Parlamentit t'ia jap përgjigjen profesionale.

Shkojmë tutje. Kuvendi në hartimin e ligjeve. Çfarë pamë ne sot? Ne pamë një absurd që ka ndodhur sot me tri ligjet që po i quajnë ligje të biznesit, ku komisioni shumëpartiak, parlamentar – komisioni funksional, tri herët thotë: i rekomandojmë, me letër... me letër, zotëri! I rekomandojmë Kuvendit që të mos e miratojë ligjin!

Shkojmë në pikën tjetër. Absurdi është tash që kryetari i komisionit, një njeri që unë e respektoj, si individ, por ne po flasim për parime, pas dy sekondave i njëjti kryetar i Grupit që lajmëron në emër të komisionit që ligjet nuk i rekomandohen komisionit, thotë: jo i rekomandohet në emër të partisë time. Duhet të bëhet bile pak më me stil, të bëhen këto punë. Ta thotë një njeri tjetër, sepse problemi është i besueshmërisë. Një njeri që ndahet në dysh për dy sekonda, është problem.

Unë jam moti në këtë Kuvend, unë e di çka është vota politike. Në këtë rast, nuk kanë qenë këto vota politike. Në këtë rast duhet të jenë vota që shkojnë kah profesionaliteti dhe përgjegjësia, se ligjet janë të tilla.

Tutje, kemi problemin e ligjeve që lidhen me legjislativin dhe me ekzekutivin. Unë nuk pash në këtë propozim dy vërejtje fundamentale, në dy raport-progreset e fundit për 2009 dhe 2010, që kërkohen dy ligje të hartohen se mungojnë patjetër. Njëri quhet Ligji për Prishtinën dhe tjetri Ligji për Qeverinë.

Ky është një lëshim shumë i madh edhe për produktin që po e jap. Për Prishtinën, sepse kemi kryeqytetin që e ka 1/4 e banorëve të Kosovës, ku vijnë të gjithë, realizojnë...

(Ndërhyrje)

...thuhet, i shohim shifrat. Po, si do që të jetë, 1/4 lëviz brenda ditës në Prishtinë dhe tash nuk e kemi ligjin. Ky është kërkuar që dy herë në raporte të progresit. Tutje, domethënë nuk kemi mundësi që Prishtinën ligjërisht ta bëjmë kryeqytet, edhe në kuptimin e funksionimit, edhe në kuptimin e financimit.

Ligji për Qeverinë. Pse? Për shkak se duke mos pasur një ligj për Qeverinë, ne në kërkim të përpjesëtimeve të asaj që quhet koalicion qeveritar, që është e drejta e tyre, qofshin këta të mëdhenj, të vegjël apo super të vegjël – ambiciet për pushtet, makutia është bërë e madhe. Dhe, ju do të shihni që Kosova i ka 19 ministri, po pa ligj mund t'i bëjë 25. Sepse, Qeveria thotë, shikoni, ne na duhet përpjesëtimi. E harrojnë që përpjesëtimi është si 3 me 1, si përpjesëtim, si 30 me 10, po nuk është si të paguhen 3 ministra, si 30. Domethënë, ligji është domosdo dhe rekomandim.

Unë mendoj që të dyja këto duhet të hyjnë në projektin legjislativ, zoti Lutfi, që je kryetar i Komisionit. Merri në evidencë, se janë detyrime.

Kështu që, unë për tash, se e kemi edhe një pikë tjetër, nëse koha më kalon, unë do ta vazhdoj në pikën tjetër të rendit të ditës, duke zbatuar Rregulloren totalisht, do të flas kur të vjen puna e asaj rezolute, por po them edhe një herë dhe po nënvizoj: Që nuk është mirë, për shkak të atyre që quhen votime politike, të shkojmë deri te një de-profesionalizim total dhe de-etiketizim të deputetëve, zoti na ruajt, për shkak se nuk është mirë, se bëhemi të pabesueshëm.

Unë nuk dua të përmend emra, por pikërisht për këto ligje unë kam pasur biseda vullnetare me deputetë që kanë kërcyer përpjetë – kanë thënë: gjë s'vlejnë dhe sot i kanë mbrojtur. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zoti Hamiti! Fjalën e ka, në emër të Grupit Parlamentar Vetëvendosje, deputeti Glauk Konjufca!

GLAUK KONJUFCA: Kryesues dhe deputetë të Kuvendit të Republikës së Kosovës,

Plani i veprimit të Kuvendit të Kosovës për integritet evropian, për vitin 2011, më së shumti tregon për dështimet e mëdha të Qeverisë së Kosovës në plotësimin e atyre kritereve që janë të domosdoshme për integritetin e Kosovës në Bashkimin Evropian. Në këtë dokument 65 faqesh listohen 116 kritika serioze të adresuara kryesisht ndaj Qeverisë së Kosovës nga Komisioni Evropian në Raportin e progresit në vitin 2010.

Po ashtu, paralelisht me këto kritika janë dhënë edhe 197 veprime konkrete për institucionet e Kosovës që duhet të bëhen gjatë vitit 2011, duke përfshirë këtu edhe Kuvendin e Republikës së Kosovës, gjegjësisht komisionet parlamentare që merren me fushat përkatëse.

Kryeministri Thaçi, i cili integritetin evropian i ka bërë retorikë tashmë, duhet ta lexojë me vëmendje këtë dokument, i cili në pikën 23 lidhur me pasurimin e politikanëve të Kosovës thotë kështu, po e citoj raportin: “Informatat në dispozicion kanë shfaqur mospërpjethje ndërmjet të hyrave dhe pronave të zyrtarëve të lartë politikë në Kosovë”. Kjo dëshmon...

KRYESUESI: Glauk, më fal! Në qoftë se ju dëshironi ta bëjmë një seancë të veçantë për Raportin e progresit, e bëjmë. Ne kemi për të miratuar një dokument, i cili ...

GLAUK KONJUFCA: Jo, kjo thuhet në dokument! Thuhet në dokument, në raport kështu thuhet dhe unë po e citoj Raportin, jo të progresit, ky është dokument!

KRYESUESI: Mirë, mirë!

GLAUK KONJUFCA: Informatat në dispozicion kanë shfaqur mospërpjethje ndërmjet të hyrave dhe pronave të zyrtarëve të lartë në Kosovë. Kjo dëshmon praninë në shkallë të gjerë të korrupsionit në nivele të larta në Kosovë. Ky fakt nuk është përcjellë me debat publik ose me hetime nga organet përkatëse, që tregon mungesën e vullnetit politik për ta luftuar korrupsionin. Pra, kështu mendojnë institucionet relevante evropiane për qeveritarët tanë. E, siç dihet, pasuria e politikanëve tanë veç sa është rritur.

Kur kritikohen për këto gjëra, qeveritarët e mbrojnë vetveten automatikisht me arsyetimin e tyre të mirënjohur tashmë: drejtshënia drejtshënisë. Mirëpo, Raporti në pikën e tij 15, 16 dhe 17, pra ky që na është dorëzuar si material, thotë se – drejtshënia në Kosovë është e anshme, e ndikuar politikisht, se aty ka emërime politike, me raste të shpeshta të korrupsionit, nepotizëm, funksionim të dobët dhe efikasitet të ulët. Kjo tregon se njerëzit

e pajisur me pushtet absolut që e keqpërdorin parane publike, pa dhënë llogari, e kanë uzurpuar drejtësinë dhe e kanë bllokuar çfarëdo mundësie që demokracia në Kosovë të funksionojë. Kurse ata deputetë që në Kuvendin e Kosovës janë të shumtë e të cilët kanë ardhur në Kuvend vetëm e vetëm për t'ia përkëdhelur pushtetin Hashim Thaçit, është mirë ta lexojnë pikën e parë të këtij raporti që na është dorëzuar, i cili thotë se Kuvendi i Kosovës nuk po e kontrollon bash mirë punën e Qeverisë së Kosovës. E shtrohet pyetja: si mund ta kontrollojë mirë ekzekutivin, kur këtu në Kuvend të Kosovës ka deputetë të cilët janë më qeveri se vetë Qeveria e Republikës së Kosovës.

Raporti më tutje thotë se mungon parimi i ndarjes së pushteteve, nuk ka llogaridhënie, drejtësia kontrollohet nga politika dhe ngulfatet, ka korrupsion, kontrabandë, diskriminim, klientilizëm e çka jo tjetër.

Këto 116 kërkesa që janë listuar këtu, duhet të rregullohen, pa dyshim, nga ana e shtetit të Kosovës, jo thjeshtë sa për hir të integritetit evropian, por për shkak të konsolidimit të shtetësisë dhe demokracisë në Kosovë, në mënyrë që ne të gjendemi me të vërtetë në rrugën drejt integritetit evropian.

Kjo Qeveri deri tash i ka pasur më shumë se tri vite që të plotësojë standarde por kritikën e Komisionit Evropian për çdo vit përmbi 90% kanë qenë po ato të njëjtat. Kjo tregon se sa ka punuar Qeveria e Kosovës në këtë drejtim. Dhe, meqë janë të njëjtit njerëz, unë nuk kam kurrfarë shprese se do të punojnë në të ardhmen, prandaj mund të thuhet me siguri se kritikën, po ashtu, të vitit 2011 do të jenë përafërsisht ato që kanë qenë gjithmonë: njerëz mbi ligjin, kontrollim i medias publike, mostransparencë, korrupsion e kështu me radhë.

Me pushtetin aktual, i cili sundon në Kosovë, po aplikohen disa praktika politike dhe institucionale të cilat nuk kanë vend në Bashkimin Evropian dhe gjithmonë janë kritikuar edhe prej vetë Bashkimit Evropian. Përderisa mos ta ndërrojmë këtë pushtet politik, Kosova do të vazhdojë të jetë në fundin e proceseve të integritetit evropian, prapa të gjitha shteteve tjera të rajonit. Kurse integriteti evropian nuk do të jenë asgjë më shumë se sa retorikë qeveritare. Dhe, në anën tjetër, BE do të na shohë vetëm si një shtet të jashtëzakonshëm – sui generis, siç thonë, me pushtetarë përmbi ligjin, të cilëve ua dërgon një mision të ligjit e të rendit që i bastisë për çdo javë ministrinë tona apo vilat e shtrenjta të zyrtarëve qeveritarë. Kështu nuk mund të integrohemi në Bashkimin Evropian.

Kurse, sa i përket Komisionit që e ka përgatitur këtë dokument, sidomos të faqes së parë, ku arsyetohet pse është përgatitur ky dokument, edhe një kritikë në fund të vërejtjes duhet t'i adresohet këtij komisioni, gjegjësisht udhëheqësit të saj, zotit Haziri, i cili në renditjen e prioritetëve për qytetarët e Kosovës tha: liberalizimi i vizave, i pari, mirëqenia e qytetarëve, drejtësia dhe mekanizmat e sigurisë. Kisha për të thënë që renditja, sa i përket nevojave të qytetarëve të Kosovës është tjetër. Liberalizimi i vizave vjen pas mirëqenies, pas drejtësisë dhe pas sigurisë. Sepse, qytetarët e Kosovës, po e lëshojnë Kosovën dhe po ikin prej Kosovës pikërisht pse po mungojnë këto tria: mirëqenia, drejtësia dhe siguria për ta, e për këtë po u duhet liberalizimi i vizave. Faleminderit, shumë!

KRYESUESI: Faleminderit! Në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, a është paraqitur kush? Blerim Shala!

BLERIM SHALA: Faleminderit!

I nderuari kryesues,

Kabinet i Qeverisë,

Të nderuar deputetë,

Plani i veprimit i Kuvendit të Kosovës për integritet evropian, për vitin 2011, për të cilin po flasim sot, do të aprovohet në fund të prillit me një vonesë të madhe, e cila i ka justifikimet e njohura për të gjithë ne. Këto justifikime ridëshmojnë mungesën e një strategjie politike të autoriteteve institucionale të vendit. Mungesa e kësaj strategjie ka bërë që politika kosovare të karakterizohet me improvizime të të gjitha llojeve, me këmbëngulje të përmbushjes së interesave afatshkurtër partiak dhe individual, me dëme që i janë shkaktuar politikës kosovare në përgjithësi dhe vetë shtetit të Kosovës.

Plani i veprimit i Kuvendit të Kosovës për integritet evropian për këtë vit, ashtu siç ka mund edhe të pritët, ndërtohet në radhë të parë mbi sprovat dhe objektivat që kanë dalë nga Raporti i progresit për Kosovën i Komisionit Evropian për vitin 2010. Ky plan është një reflektim i saktë dhe i drejtë i detyrave që i kemi si Kuvend i Kosovës.

Si do qoftë, edhe një lexim i shpejtë i të gjitha masave dhe veprimeve që ne duhet t'i ndërmarrim tash e tutje si Kuvend i Kosovës, na tregon se çfarë pune më na pret dhe sa jemi prapa në sendërtimin e këtyre obligimeve, ashtu që të kemi një përmirësim thelbësor të pozicionit të Kosovës në Raportin e progresit të vitit 2011.

Objektivisht, si Kuvend, ne do të mund të zëmë hapin e duhur vetëm në vitin 2012, pasi që të jemi njoftuar me gjetjet e radhës të Komisionit Evropian.

Duhet shtuar këtu se si deputetë na pret një punë e jashtëzakonshme në respektim të këtij plani të veprimit edhe në ndryshimin rrënjësor të raportit tonë ndaj ekzekutivit, i cili ka qenë burim i shqetësimit të madh të Komisionit Evropian.

Subordinimi i Kuvendit a Qeverisë, që ka qenë tipari kryesor i marrëdhënieve Kuvend – Qeveri gjatë mandati të kaluar, duhet të marrë fund në të gjitha aspektet. Fuqizimi i rolit të Kuvendit i kontribuon shëndetit politik dhe forcimit të demokracisë në Kosovë.

Së fundit, duhet përmendur se Kosova po kalon nëpër një periudhë ... të ndërlikuar kur flitet për raportet e Prishtinës dhe Brukselit dhe kur është zbehur ajo porosia e njohur politike që vendi i Kosovës është në Evropë apo që Kosova ka perspektivë evropiane.

Si rrallëherë më parë, në politikën kosovare dhe tek opinioni kosovar duhet të shfaqim një agjendë të qartë të Kosovës për hyrje në Bashkimin Evropian, e cila po ashtu do të tregojë edhe interesin e BE-së që Kosova të jetë pjesë përbërëse e Bashkimit Evropian. Ky është interes i dyanshëm. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Në emër të Grupit Parlamentar Koalicioni Kosova e Re, deputeti Amir Ahmeti!

AMIR AHMETI: Faleminderit!

I nderuari kryesues,

Kabinet qeveritar,

Të nderuar deputetë,

Qytetarë të Kosovës,

Në emër të Grupit Parlamentar Koalicioni për Kosovë të Re e përshëndesim angazhimin e Republikës së Kosovës drejt integritimit evropian. E përkrahim këtë plan të punës për t'u integruar sa më shpejt në Bashkimin Evropian, por sot do të paraqesim disa sugjerime tona që nga komisionet përkatëse të merren parasysh dhe të përmirësohen.

Nën një, për të qenë plani i veprimit sa më i kompletuar në akordancë me respektimin e të drejtave të njeriut, sipas të drejtës ndërkombëtare, në faqen 15 dhe 16, p/28 dhe p/29 ku flitet për të drejtat e njeriut sipas të drejtës ndërkombëtare, kemi rekomandimet që dalin nga organet ndërkombëtare për të drejtat e njeriut dhe pika 4. Përgatitjet e rekomandimeve për miratim nga ana e seancës plenare për çështjet që kanë të bëjnë me të drejtat e njeriut në nivelin lokal dhe atë qendror.

Këtu ju përkujtoj se është një udhëzim administrativ i Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë 2010/6, ku një pikë e këtij udhëzimi administrativ shkel të drejtat elementare të njeriut, të drejtën individuale dhe atë fetare.

Në një bisedë të shkurtër me ministrin e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë ka premtuar bashkëpunim dhe shpresojmë se shumë shpejt do të eliminohet edhe kjo shkelje e të drejtave të njeriut.

Nën dy, tek të drejtat civile dhe praktike, faqe 21, 22 p/38 të Raportit të progresit, thuhet: duhet të miratohet korniza ligjore që mundëson lirinë dhe aktivitetet fetare. Komunitetet fetare janë ende të regjistruara si OJQ.

Sa për njohuri, mendoj se edhe Raporti i progresit është në lajthitje, sepse bashkësitë fetare në Kosovë, të paktën ato tradicionale, nuk janë të regjistruara fare as si OJQ. Pra, nuk kanë kurrfarë statusi dhe konsideroj se komisionet përkatëse, si Komisioni për të Drejtat e Njeriut dhe Komisioni për Integrim Evropian duhet të bashkërendojnë takimet me bashkësitë fetare, si Bashkësinë Islame të Kosovës, si Ipeshkvinë e Kosovës, për t'u njoftuar me veprimtarinë e këtyre bashkësive fetare dhe sipas Planit të punës të Kuvendit të Kosovës në vjeshtë, kur kemi të diskutojmë për Projektligjin për liritë fetare në Kosovë, t'i kemi të gatshme të gjitha këto përgatitje.

Dhe, nën tre, tek të drejtat ekonomike dhe sociale, faqe 23, 24 p/43, shkruan kështu: Kërkohet vetëdija për çështjet e lezbikeve, homoseksualëve, biseksualëve dhe tranzitorëve, që mbetet e ulët dhe kërkohet nga Ministria e Punëve të Mirëqenies Sociale për këto kategori.

Ne konsiderojmë se Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale ka mjaft punë në Kosovë, kur e dimë se Kosova ka 40% të popullsisë në varfëri të skajshme, është e nevojshme hapja e vendeve të reja të punës dhe mirëqenies së qytetarëve të Kosovës dhe nuk ka nevojë që të angazhohet për akomodimin e homoseksualëve.

Ju përkujtoj se këtu me veti kam edhe legjislacionin evropian në formë tabelare për mbrojtjen e homoseksualëve, lesbikeve dhe Kosova është në mesin e shteteve që ka bërë progres, si quhet këtu, në këto pika, madje ua ka kaluar të gjitha vendeve të rajonit, madje edhe shteteve evropiane, si Italisë, Polonisë, Greqisë, Bullgarisë e Sllovakisë. Madje, Polonia dhe Greqia kanë ligje diskriminuese sipas këtij legjislacioni, për homoseksualë, ndërsa Komisioni Evropian bën presion përmbi Kosovën për këto çështje, ndërkohë që ne kemi punë shumë më të rëndësishme për të bërë.

Si konservatorë që jemi, duke u bazuar edhe nga partitë popullore konservatore evropiane rreth kësaj çështjeje, ne konsiderojmë se Kosova do të jetë pjesë e Bashkimit Evropian me traditën dhe kulturën tonë, e cila traditë dhe kulturë do të begatojë multikulturalizmin evropian dhe konsideroj se komisionet përkatëse t'i japin jo Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale detyrë, por Ministrisë së Shëndetësisë për të ndërtuar mekanizma për të shëruar këto vese të shëmtuara që janë në kundërshtim me etikën e familjes kosovare dhe me traditën tonë dhe kulturën tonë. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Në emër të Grupit Parlamentar SLS, Sasha Milosavljeviq e ka fjalën.

SAŠA MILOSAVLJEVIĆ: Hvala, gospodine predjedavajući!
Parlamentarna grupa SLS je razmotrila Plan delovanja Skupštine za evropske integracije za 2011. i nemamo nikakvih primedbi i glasaćemo za ovaj plan.

KRYESUESI: Faleminderit! Në emër të Grupit Parlamentar “6+”, a është paraqitur kush? Allbert Kinolli!

ALLBERT KINOLLI: Faleminderit, i nderuari zoti kryesues!
Të nderuar ministra,
Të nderuar kolegë deputetë,
Grupi Parlamentar “6+” e ka shqyrtuar me kujdes këtë plan të veprimit për integritet evropian dhe si të tillë e mbështet, në parim, dhe duke pasur parasysh rëndësinë e tij, do ta votojë atë dhe njëherësh kontributin e saj do ta japë në Komisionin për Integritet Evropian. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Deputeti Zenun Pajaziti e ka fjalën!

ZENUN PAJAZITI: Faleminderit, zoti kryesues!
Edhe pse unë pata rastin të bëj një replikë, po e shfrytëzoj rastin e fjalës time të flas për pikën e rendit të ditës dhe pastaj mund edhe të bëj një përgjigje.

E para, mendoj që edhe pse pak vonë, ky dokument, të cilin ne duhet ta konsiderojmë si udhërrëfyes, edhe pse vonë, është i domosdoshëm dhe është i nevojshëm. Jo vetëm Kuvendi, por edhe institucionit tjera kanë prioritet së paku edhe nga qëndrimet politike dhe subjektet politike që agjendën evropiane ta kenë në plan të parë në punën e tyre, aq më tepër në kohën kur ne si Kosovë po pretendojmë që të arrijmë sa më lartë në këtë proces të integrimi evropiane dhe të arrijmë që sa më shpejt jo vetëm t'i realizojmë ato detyrime që i kemi në kuadër të rrugës tonë për në BE, por edhe të arrijmë që të rangohemi sa më shpejt në shtetet që duhet të aderojnë atje.

Kuvendi i Kosovës ka një varg detyrash të cilat, ne, për më tepër i kemi kuptuar edhe më herët, nuk është hera e parë, në mënyrë të rregullt Kuvendi i Kosovës aprovon dokumente dhe udhërrëfyes që tregojnë, synojnë të kenë në plan të parë agjendën evropiane dhe një nga detyrat kryesore është që dokumentet që vijnë ose projektligjet që vijnë, të trajtohen me prioritet.

Ne posa kishim sot disa projektligje të cilat janë konsideruar edhe nga Raporti i fundit i progresit që duhet të kenë ndryshime dhe kemi pretenduar t'i trajtojmë në kuadër të kësaj agjende dhe kemi pasur këtu edhe deputetë edhe grupe parlamentare që kanë kundërshtuar, edhe pse këto kanë qenë të kërkuara nga BE ose nga Komisioni Evropian ose nga Raporti i progresit të BE-së.

U përmendën këtu edhe projektligjet të cilat nuk kanë shkuar në Komisionin për Zhvillim. Dëshiroj t'i jap sqarime, edhe pse këto dolën nga një fjalim i cili nuk kishte të bëjë aspak me agjendën, po më shumë ishte fjalim ideologjik. Dëshiroj t'i jap përgjigjen që edhe në kuadër të kësaj të sqarohem se unë në të njëjtën kohë kam qenë shumë korrekt me anëtarët e Komisionit. Në Komision kam kërkuar me ngulm që të aprovohen për shkak se janë në kuadër të agjendës evropiane, pikësëpari duke theksuar nen për nen të gjitha ato që janë kërkesë nga Raporti i progresit dhe duke qenë korrekt, po ashtu, me Grupin Parlamentar të Partisë Demokratike kam kërkuar që pavarësisht nga votimi i barabartë të aprovohen, kam kërkuar të njëjtën gjë edhe nga kryetari i Kuvendit, për çka i falënderoj sepse e kanë përshpejtuar ose janë në përputhje të plotë me agjendën evropiane dhe nuk kemi shkaktuar edhe një vonesë tjetër.

Pra, në këtë plan, mendoj se të gjithë deputetët dhe grupet parlamentare të mos kenë qëndrime të dyfishta, në njërën anë, kur flitet për integrimet evropiane të thonë se jemi për këtë agjendë dhe, në anën tjetër, kur janë për angazhime të veçanta, për çështje të veçanta, siç janë edhe aprovimi i projektligjeve, të kenë qëndrime të ndryshme.

Mendoj që pikërisht këtu qëndron ai principi ose ana primore e qëndrimit të çdo deputeti dhe grupi parlamentar.

Ju falënderoj dhe shpresoj se me vendimet që i kemi marrë sot për tri projektligje, të cilat nuk kanë gjetur aprovimin e nevojshëm në komision, por si Parlament kemi arritur të jemi mirë në agjendë dhe unë shpresoj se që në leximin e dytë po ashtu do t'i kontribuojmë agjendës së integrimi evropiane. Faleminderit, shumë!

KRYESUESI: Faleminderit! I kam dy replika të paraqitura. Kush ke ai fjalimi ideologjik, më mirë përmendni emrat, se tash duhet sipas interpretimit që u bë më herët, duhet të gjithë ata që s'pajtohen sipas interpretimeve që u bënë më herët, duhet të diskutojnë. Për replikë është paraqitur zoti Hamiti!

SABRI HAMITI: Faleminderit, zoti Haliti, nënkryetar i Kuvendit të Kosovës!

Unë atë çfarë e thashë, e thashë dhe ju thashë, kur të marr kohë, mund ta zhvilloj me orë.

Unë veç desha t'ju tërheq vërejtjen që e thyet edhe një herë Rregulloren, sepse replika paraqitet menjëherë. Zotëria priti të flasin edhe disa ndërmjet dhe u paraqit, është e drejta e tij, ia dhatë fjalën.

Ndërsa, pak përpara, pak përpara...

KRYESUESI: Kohën e diskutimit e ka shfrytëzuar ai. Nuk e ka shfrytëzuar kohën e replikës.

SABRI HAMITI: Po, s'ka lidhje!

KRYESUESI: Jo, ka lidhje!

SABRI HAMITI: E dyta, e dyta, meqë kolegun e ri, që thashë edhe një herë, e kam një, nëse lejohet të thuhet, një simpati njerëzore për të, në këtë rast nuk do të thotë që Bashkimi Evropian lyp agjendë të filan ligjeve, që ti të marrësh në hunë e buzë e të bësh ligje të këqija. Kjo, pikërisht është antievropiane. Kjo është sikur të thuash: ata thonë, duhet fluturuar, ti avion s'ke dhe i hip lojës dhe bien në rovinë.

Domethënë, esenca është standardi. Shkuarja në Evropë është standard. Nuk është problem i deklarimit, po është standard, arrijte, vlerë. Kaq, faleminderit!

KRYESUESI: Ardian, a deshe replikë ti? Ardian Gjini, replikë!

ARDIAN GJINI: Faleminderit, zoti nënkryetar!

Realisht, esencën e asaj që desha ta them, e tha profesori Hamiti. Nëse na kërkohet një ligj, nuk do të thotë që duhet të bëjmë dhe të kalojmë ligj të keq për shkak se e bëjmë një të keqe edhe më të madhe dhe kjo mënyrë e prezantimit të asaj që ndodhë këtu, kush është kundër e kush është për, duke e kamufluar esencën e asaj për çka po flasim, nuk ka emër tjetër përpos demagogji. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Replikë ka Arben Gashi!

ARBEN GASHI: Faleminderit!

Të nderuar kolegë deputetë,

Unë mendoj që replika është më shumë parimore dhe konceptuale, në këtë rast. Në qoftë se ne flasim për integritet evropian dhe para dhjetë minutash ne kaluam një ligj i cili bie

në kundërshtim drejtpërdrejt me kartën evropiane dhe qeverisjes lokale, duke centralizuar autoritete dhe përgjegjësi që i takojnë nivelit lokal, kjo është një absurd që po zhvillojmë ne këtu dhe nuk mund të flasim për integritet evropian në këtë kuptim.

Në qoftë se ne diskriminojmë zona të caktuara, si në këtë rast qytetin e Prishtinës, që është kryeqyteti i Republikës së Kosovës dhe me Kushtetutën e Republikës së Kosovës, në nenin 12 thuhet që kryeqyteti i Republikës së Kosovës duhet të qeveriset me ligj të veçantë, se shkohet në kuptimin e Kartës evropiane për vetëqeverisjen lokale, ku parimi kryesor aty është parimi i subsidiaritetit, prurja e vendimmarrjes sa më afër qytetarit, në këtë rast ne po centralizojmë prapë autoritete dhe përgjegjësi. Ky është një absurd që po zhvillohet në këtë Parlament. Ky Parlament ka humbur logjikën dhe arsyen si rezultat i dirigjimit që vjen nga kjo qeveri e pa përgjegjshme.

Andaj, ju lutem shumë, kolegë deputetë, keni parasysh, se kur merren vendime dhe votohet, duhet të kemi parasysh se interesi i parë në këtë rast duhet të jetë interesi i qytetarëve të Kosovës, qeverisja demokratike dhe krijimi i kapaciteteve për qëndrueshmërinë institucionale dhe vetëqeverisëse.

Dhe, në këtë rast, duke folur fjalë të mëdha për integritet evropian, ku nuk kemi asnjë marrëdhënie kontraktuale me asnjë institucion evropian, po biem në një situatë shumë konfliktuale dhe po biem në një realitet ku kjo Qeveri po i imponohet këtij Parlamenti dhe ky Parlament po merr vendime të gabuara, duke centralizuar shërbimin inspeksionit dhe duke centralizuar regjistrimin e bizneseve dhe lejen e punës dhe duke hequr burimet e financimit që kanë komunat individualisht, duke ia hequr dhe duke centralizuar në nivel qendror, ky është një parim që është në kundërshtim të hapur me parimet e integriteteve evropiane. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! A u tërhoqe për kundër replikë, a? Tre minuta i ke, për tre vetë që kanë bërë replikë me ty.

ZENUN PAJAZITI: Po, i nderuar kryesues, po e shfrytëzoj rastin të bëj edhe një sqarim.

E para, dëshiroj të jemi më të hapur edhe kur punojmë edhe nëpër komisione, edhe në seancë. Unë e di që fjalimet tona në seancë meqenëse transmetohen, marrin pak një karakter tjetër. Dëshiroj t'ju them që në asnjë prej këtyre projektligjeve sot, më falni që po kthehem aty, në princip nuk kanë qenë diçka që thelbësisht ndajnë një qëndrim politik të caktuar për një profil tjetër ligji, absolutisht nuk ka pasur të bëjë. Bile, bile, për të shkuar dhe për të qenë më konkret, ndonjëri prej anëtarëve të Komisionit që ka votuar kundër, më pastaj ka thënë që s'e kam ditur që në lexim të dytë mund të bëhen, se nuk kisha votuar kështu, e tjera, e tjera.

Dëshiroj të jem sa më racional dhe dëshiroj t'ju them po ashtu që projektligjet në fjalë janë kryesisht të lidhura me esencën e atyre çka thuhet në Raportin e progresit dhe mendoj që kemi bërë sot një punë të mirë dhe besoj, po ashtu i ftoj deputetët që në grupin e komisionit parlamentar të jenë sa më konkretë dhe t'i bien propozimet e tyre, sepse nëse shkojmë kështu, edhe në leximin e dytë ne të njëjtën mënyrë do të shkojmë me votime.

Unë shpresoj se do të ketë propozime konkrete, në mënyrë që të ndryshojmë aty çka dëshirohet, në mënyrë që të jenë edhe në përputhje me agjendën evropiane. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Ligjet, dihet, kalojnë, secili ka të drejtë në amendamentin e vet dhe votohen amendamentet, shqyrtohen në komisione. Sidoqoftë, debati është i domosdoshëm, është i lejuar me Rregullore të Kuvendit për secilin ligj dhe secilën çështje. Problemi është që të mos tensionohet pa nevojë situata për çështje të ligjit. Fjalën e ka deputeti Muhamet Mustafa.

MUHAMET MUSTAFA: I nderuari zoti kryesues,

Të nderuar kolegë deputetë,

Mendoj se si praktikë është shumë mirë që ne kemi një plan veprimi që reflekton pak më thellë me vërejtjet dhe sugjerimet që jepen lidhur me rezultatet që ne po i arrijmë drejt integriteteve evropiane. Pra, unë e përshëndes si një operacionalizim, tentim për operacionalizim në fakt të detyrave që ne duhet t'i kryejmë, që të kemi vlerësime më pozitive në të ardhmen.

Edhe pse nuk mund të jemi shumë optimistë që kjo që kemi këtu të shkruar në raportin e ardhshëm do të reflektojë, sepse raporti veç do t'ia fillojë për dy-tri javë të shkruhet, por sigurisht puna që do të bëjmë në raportet tjera do të shprehet.

Ajo që është esenciale për neve, e po më duket që është përgjegjësi e jona këtu, është pikërisht pika e parë – demokracia dhe sundimi i ligjit dhe më konkretisht, detyra e parë, të përmirësohet procesi i mbikëqyrjes së ekzekutivit dhe të forcohet roli i Kuvendit.

Në këtë drejtim ne duhet të mendojmë se na pret një punë shumë e madhe, sepse ende jemi shumë larg që Kuvendi në të vërtetë të shndërrohet në organin më të lartë jo vetëm ligjdhënës e ligjvënës, por që siguron transparencë dhe llogaridhënie. Në këtë drejtim ne po ngecim shumë dhe gjuha e këtij programi nuk është e tillë që na siguron kthesë të duhur. Për shembull, ne në një kolonë kemi rubrikat që flasin për atë që thotë Raporti i progresit dhe kemi veprime të propozuara. Veprimet e propozuara faktikisht të shumtën e rasteve përsërisin atë që kemi në rubrikën e parë: çka thotë Raporti i progresit. Ne s'kemi nevojë të përsërisim edhe një herë çka thotë Raporti i progresit.

Ne kemi nevojë që të obligojmë institucionet, të obligojmë Kuvendin, të obligojmë ata që janë përgjegjës që t'i raportojnë këtij Kuvendi çka kanë bërë. Jo që ne përsëri t'i përsërisim detyrat që janë të shtruara në Raportin e progresit – rekomandimet. Ne kemi nevojë që në Kuvend të sjellim raporte që tregojnë çfarë progresi kemi arritur dhe unë mendoj se në punën e mëtejme në këtë program është esenciale që ta ndryshojmë programin në këtë drejtim. Sepse në qoftë se ne vetëm kemi formulime të përgjithësuara dhe nuk e dimë çka po kërkojmë, monitorimin! Që, për shembull, këtu thotë: të merren parasysh rekomandimet, kompetencat e zyrës së personelit. S'ka nevojë... Duhet të raportohet a janë marrë, a është ndryshuar gjendja. Përndryshe, kesi rekomandimesh nuk do të na e ndryshojnë gjendjen.

Ajo që është esenciale për ta ndryshuar rolin e Kuvendit, është vullneti politik këtu, edhe i pozitës, edhe i opozitës. Ne po shohim këta dy-tre muaj, sa u bënë, që kemi një reflektim total të interesave të ngushta politike të cilat reflektohen në Qeveri dhe prej Qeverisë reflektohen në Kuvend. Nuk do të mund të dalim prej kësaj situatë, nuk do të bëhemi demokraci serioze në qoftë se interesat e ngushta politike dhe interesat e partive politike dominojnë në këtë Kuvend.

Prandaj, edhe opozita, edhe pozita, kur janë çështjet kyçe... ne e kemi pasur buxhetin, e kemi pasur nenin 4, i kemi pasur bisedimet me Serbinë, i kemi pasur të gjitha këto, nuk kemi mund të krijojmë një konsensus minimal bazik që iu përgjigjet interesave të qytetarëve të Kosovës. Prandaj, kjo është ajo esenca që duhet ta sendërtojë ky Parlament, ky Kuvend, jo veç të tregojë fuqinë, gjithherë fuqinë e votës, gjithherë atë... por të tentojmë që ne të gjejmë domethënë forcë që të ngrihemi, ta shndërrojmë Kuvendin në një organ që nuk reflekton vetëm fuqinë partiake, po është një organ edhe mbi partiak, që krijon platformë për të sendërtuar interesat jetike të qytetarëve të Kosovës. Dhe, në këtë drejtim unë mendoj se janë të mira propozimet edhe për Ligjin mbi Qeverinë sa më shpejt, sepse aty do të shohim çka ka nevojë të përmirësohet, por edhe ligjet tjera, si Ligji për Prishtinën e tjerat. Ju faleminderit për vëmendje!

KRYESUESI: Faleminderit! Të paraqitur tjerë nuk ka për fjalë. Të nderuar deputetë, vazhdojmë me votimin e Planit të veprimit të Kuvendit për integritet evropian, për vitin 2011.

Në mbledhje janë prezentë 78 deputetë. Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim dhe votojmë tani:

Faleminderit! Konstatohet se me 75 vota “për”, me elektronikë, 1 pa elektronikë – 76, 1 abstenim dhe 4 vota “kundër”, Kuvendi miratoi Planin e veprimit të Kuvendit për integritet evropian, për vitin 2011.

Vazhdojmë me pikën e fundit të rendit të ditës:

11. Miratimi i Rezolutës për angazhimin e Kosovës drejt integritetit të Bashkimit Evropian

Komisioni për Integritet Evropian ka paraqitur për shqyrtim dhe miratim në Kuvend Propozim-rezolutën për angazhimin e Kosovës drejt integritetit në Bashkimin Evropian.

Ftoj kryetarin e komisionit funksional, deputetin Lutfi Haziri, që në emër të komisionit ta prezantojë dhe arsyetojë Propozim-rezolutën.

LUTFI HAZIRI: Faleminderit, zoti kryesues!
Të nderuar kolegë deputetë,
Ministra,

Më lejoni vetëm dy fjali para se ta paraqes Rezolutën, meqë nuk do ta lexoj rezolutën në pjesën e arsyeshmërisë që jepet, sepse ne po bëjmë rikonfirmim të përkushtimit, por dy fjali nga ajo që u tha nga grupet parlamentare.

Plani i veprimit e ka shtyllën e detyrave që i nxjerr për veti Kuvendi, operacionalizimi për institucionet që duhet t'i mbështesë Kuvendi dhe në fund që të monitorojë Kuvendi.

Për të tri shtyllat deri tash ne jemi kualifikuar vetëm si përkushtim deklarativ. Tash e tutje Kuvendi duhet të kalojë në një përkushtim me veprim konkret i cili duhet të realizojë detyrat e veta, duhet t'i monitorojë organet dhe duhet t'i realizojë sfidat që paraqiten. 116 veprime janë detyra dhe angazhime konkrete që çdo ditë në Kosovë ndikojnë në përmirësimin e jetës së qytetarëve, edhe në përmirësimin e sundimit të ligjit dhe të detyrave tjera që i kemi përpara veti.

Natyrisht, ne kemi kërkuar që kryetarët e komisioneve ta parashohin agjendën dhe të fillojnë t'i trajtojnë raportet, qoftë ai i mbikëqyrjes buxhetore që u bë kërkesa tash, në baza të rregullta duhet t'i vlerësojë raportet, auditimet, mbikëqyrjen buxhetore, duhet të paraqes problemet që janë në mënyrë që të realizojë detyrat e veta, siç është Komisioni për Jurisprudencë ose Komisioni për të Drejtat e Njeriut, ose i Punëve të Brendshme, i cili nuk i ka vetëm pesë shtete kundër tash për liberalizimin e vizave, i ka edhe pesë shtete tjera mike të Kosovës që e kanë bllokuar liberalizimin e vizave.

Koordinimi është njëri prej problemeve kryesore që është parë edhe në Qeveri, po tash besohet se Ministria e Integrimeve do të arrijë ta përballojë këtë problem, edhe te Kuvendi, koordinimi i detyrave në ushtrimin e rolit të vet është problemi kryesor, në mes të asaj që është detyrë...për deputetët dhe sekretarin, apo sekretaria e cila po ashtu ka një angazhim konkret në këtë drejtim.

Atëherë, ne po e rikonfirmojmë angazhimin tonë. Arsyeimi që është dhënë në faqen e parë të Rezolutës, është afirmativ, është i mbështetur në vlerat për të cilat Kosova tashmë ka konsensus dhe dëshirojmë që legjislatura e katërt, pra Kuvendi i Republikës së Kosovës,

1. Të rikonfirmojë zotimin e institucioneve të Republikës së Kosovës për përmbushjen e kritereve dhe standardeve të kërkuara për integrim në BE.
2. Të rikonfirmojë gatishmërinë e institucioneve të Republikës për thellimin e bashkëpunimit me BE-në, me synim të fuqizimit të pozitës së Kosovës në procesin e integritimit.
3. Mirëpret Rezolutën e Parlamentit Evropian të 9 korrikut 2010, që fton të gjitha shtetet anëtare të BE-së për njohjen e pavarësisë së Republikës së Kosovës.

Deri tash i vetmi institucion evropian që e ka njohur pavarësinë, e ka bërë ftesë, është Parlamenti Evropian, për dallim nga komisioni dhe institucionet tjera që kanë qëndrim neutral në raport me statusin.

4. Zotohet se do të intensifikojë përpjekjet për përmbushjen e obligimeve që dalin nga dialogu i procesit të stabilizim-asocimit me synim kryesor nënshkrimin e marrëveshjes së stabilizim-asocimit.

5. Shpreh përkushtimin e institucioneve të Kosovës në arritjen e kriterëve politike ekonomike dhe standardeve evropiane.

6. Konsideron se prioritet kryesor për mbushjen e kërkesave për procesin e liberalizimit të vizave, forcimin e marrëdhënieve tregtare me BE-në në të mirë të prodhuesve vendorë, përmirësimin e bashkëpunimit rajonal, forcimin e sundimit të ligjit dhe harmonizimin e legjislacionit me *acquis* komunitaire dhe zbatimin e tij sipas kërkesave të BE-së, si dhe reformimin e administratës publike të Kuvendit të bazuar në parimet e një administrate publike efektive pa ndërhyrje politike.

7. Shpreh gatishmërinë për bashkëpunim më të ngushtë ndërmjet Kuvendit të Republikës së Kosovës dhe Parlamentit Evropian në të gjitha nivelet...

Dhe, këtu është ideja, por kërkesa jonë, meqë Parlamenti Evropian ka lejuar hapjen e zyrës së Kuvendit të Kosovës brenda Parlamentit Evropian, një zyre e vogël e cila do të administronte format e bashkëpunimit dhe përfaqësimit tonë sa më të mirë atje, sepse është mënyrë e vetme që ne mbi bazat ditore si Kuvend brenda Parlamentit Evropian mund ta ushtrojmë detyrën tonë nga atje, po si deputet, natyrisht duke forcuar rolin këtu.

8. Të kërkojë nga të gjitha institucionet e Republikës së Kosovës që të koordinojnë përpjekjet e tyre drejt përmbushjes së rekomandimeve të dala nga Raporti vjetor i progresit për Republikën e Kosovës dhe përfshirjen e veprimeve konkrete në kornizën afatmesme të shpenzimeve, buxhetin vjetor të Republikës së Kosovës dhe agjendën vjetore legjislative.

Janë tri kërkesa themelore, sepse miratimi i buxhetit dhe i KASH-it, edhe i agjendës legjislative u përmendën këtu nga deputetët si çështje që duhet pasur parasysh.

9. Fton Qeverinë e Republikës së Kosovës që rregullisht dhe në mënyrë përmbytëse të njoftojë Kuvendin e Republikës së Kosovës mbi ecurinë e masave të ndërmarra për realizimin e prioritetëve të përmendura.

10. Përkushtohet për realizimin dhe mbikëqyrjen e procesit të zbatimit të obligimeve të sipër përmendura nga institucionet e Republikës së Kosovës dhe përfshirjen e shoqërisë civile.

Kjo rezolutë duhet t'i dërgohet Parlamentit Evropian, parlamenteve të shteteve anëtare të BE-së, qeverive të shteteve anëtare të BE-së dhe institucioneve relevante të BE-së nga ana e Kuvendit të Republikës sonë. Faleminderit shumë!

KRYESUESI: Faleminderit! Sipas radhës, kryetarët ose përfaqësuesit e grupeve parlamentare. PDK-ja, a e dëshiron fjalën? Blerta Deliu!

BLERTA DELIU: Parlamentarët e Partisë Demokratike të Kosovës e mbështesin miratimin e Rezolutës për angazhimin e Kosovës drejt integritit në Bashkimin Evropian. Faleminderit!

KRYESUESI: Zoti Haziri, e doni fjalën më, apo e keni kryer, se ju kanë paraqitur në emër të Grupit Parlamentar? Zoti Sabri Hamiti e ka fjalën!

SABRI HAMITI: Faleminderit, zoti nënkryetar i Kuvendit!

Është e natyrshme që rezolutat e kanë një gjuhë të përgjithësuar, sepse pretendojnë të jenë përtej një afati dhe unë e kuptoj këtë. Megjithatë, meqë kemi të bëjmë me një rezolutë që lidhet me një program të veprimit të Kuvendit që pretendon të ketë edhe afatë, domethënë kemi një lidhje të asaj që quhet synim i përhershëm dhe të asaj që është e afatizuar. Atëherë, në njëfarë mënyre kjo gjuhë që përpiket ta prekë konkretësinë është mirë që të duket dhe në këtë rezolutë. Së paku, në pikën ku mishëron raportet e institucioneve të Kosovës, raportet do t'i quaja unë kushtetuese.

Në këtë vështrim, unë kërkoj një harmonizim të tri pikave të fundit: të 8-shit, 9-shit dhe 10-shit, në mënyrë që mos të dalim, s'po them unë jo seriozë, po të jemi më koherentë me kërkesën, sepse u tha këtu që ky është një tekst i cili do të shkojë edhe në Bashkimin Evropian dhe në adresat e tjera.

Për të qenë koherent në kërkesat e tri pikave të fundit të kësaj rezolute, e 8-ta vetvetiu për pasojë e ndryshon të 9-tën dhe duhet pika 9, të mos thuhet “fton Qeverinë e Republikës”, pra Kuvendi, por “kërkon nga Qeveria e Republikës” dhe tutje teksti mbetet, sepse të ftohet dhe të kërkohet janë dy kategori, shumë dallojnë njëra nga tjetra. E para është dashamirëse, e dyta është obligative. Unë thashë, duhet të ruhen relacionet kushtetuese të pushteteve në Kosovë.

Pika e 10, jo formulimi qysh është por “përkushtohet për realizimin dhe bën mbikëqyrjen”, se tanimë Kuvendi detyrë e ka të bëjë mbikëqyrjen dhe jo të zotohet. Pra, formulimi “përkushtohet për realizimin dhe bën mbikëqyrjen e procesit”, e tjera... Faleminderit, zotëri!

KRYESUESI: Faleminderit, zoti Hamiti! Shpresoj se edhe komisioni dhe kryetari i dëgjuan vërejtjet dhe është mirë të prononcohen lidhur me vërejtjet e zotit Hamiti, që janë thelbësore, mendoj. Në emër të Grupit Parlamentar Vetëvendosje, deputetja Alma Lama e ka fjalën. Po, paraqitu Albin se s'e ke shtypur. Zoti Albin Kurti, atëherë!

ALBIN KURTI: Deputetë të Kuvendit të Kosovës,
Janë dy rrugë për integrimin e Kosovës në Bashkimin Evropian. Rruga e parë është bërja e Kosovës shtet sovran dhe plotësimi i kriterëve që kërkohen përgjatë procesit të integritit deri te anëtarësimi i plotë në Bashkimin Evropian.

Përderisa nuk jemi sovran, kurrë s'do të mund të bëhemi anëtar të BE-së. Këtë na e thonë vetë rregullat e BE-së. BE-ja nuk pranon protektorate, por shtete sovrane. Shembull i Bosnjës që ka ngecur si mos më keq, duhet të na shërbejë si mësim neve.

Më 9 tetor të vitit 2009, ministri i Punëve të Jashtme të Suedisë Karl Bild dhe zëvendëssekretari amerikan i shtetit Xhejms Stainberg e patën shkruar një letër të përbashkët drejtuar popullit të Bosnjës. Ajo letër përmban një fjali vendimtare: A country that does not enjoy the full sovereignty can not be a credible candidate for EU membership. Kjo në përkthim do të thotë: Një vend që nuk gëzon sovranitet të plotë, nuk mund të bëhet kandidat kredibil për anëtarësim në BE.

Pra, jo vetëm që s'mund të anëtarësohemi, por s'mund të bëhemi as kandidat për anëtarësim gjer sa jemi nën sundimin e protektoratit ndërkombëtar dhe nuk i kontrollojmë as kufijtë e as çerekun e territorit. BE-ja e kërkon që ne të bëhemi sovran, por ne as që po e themi këtë gjë në rezolutë.

Rruga e dytë për integrim në BE është që Kosova, natyrisht, serish të bëhet shtet sovran, por edhe t'i bashkohet menjëherë Shqipërisë, ashtu siç iu bashkua Gjermania Lindore asaj Perëndimore. Gjermania Lindore nuk pati plotësuar kurrfarë kriteresh për të hyrë në Bashkimin Evropian. Ajo thjeshtë iu bashkua Gjermanisë Perëndimore, e cila i kishte plotësuar ato kritere.

Edhe Kosova, pasi që të bëhet sovrane, ngjashëm do të mund t'i bashkohej Shqipërisë, e cila do t'i plotësonte kriteret e kushtet për BE. Kësisoj Shqipëria do të përqendrohej në plotësimin e kushteve për BE, ndërsa Kosova në bërjen e vetes së saj sovrane drejt bashkimit me Shqipërinë.

Janë disa probleme themelore me këtë rizotim të Kuvendit të Kosovës për angazhimin drejt integrimit në BE. Së pari, parimet e kriteret e BE-së në Kosovë nuk respektohen shumë më tepër nga Qeveria, sesa nga Kuvendi. Këtë gjë e tregojnë qartë të gjitha raportet e progresit deri më tani, të cilat shumicën e vërejtjeve dhe vërejtjet kryesore ia kanë dedikuar ekzekutivit.

Së dyti, gjithçka po mbetet edhe një herë vetëm fjalë në letër. Kosova nuk vuan nga ligjet e deklaratimet e këqija, sa nga moszbatimi i ligjeve e zotimeve të mira.

Edhe një deklaratë shtesë nuk paraqet përkushtim shtesë. Përkundrazi, deklarimi shtesë po përdoret si zëvendësim për mospërbushje të deklaratimeve të deritanishme.

Ne si deputetë të Kuvendit të Kosovës duhet që më pak t'i përsërisim fjalët, e më shumë t'i mbajmë ato.

Së treti, duke e përdorur Bashkimin Evropian zakonisht si parullë, ne po vazhdojmë të biem në kurthin e hapit të parë. Në vitet e 90-ta thuhej që – vetëm le të shkojnë forcat serbe nga Kosova, se çdo gjë do të rregullohet. Gjatë luftës thuhej që vetëm le të hyjë

NATO, se çdo gjë do të bëhet mirë pastaj. Pas luftës thuhej që porsa të bëhet pavarësia, gjithçka do të na shkojë vaj. Sot kjo po thuhet për integrimet evropiane.

Hapi i parë, në vend që t'i paraprijë hapit të dytë, të tretë e kështu me radhë, në kuadër të një vizioni politik, po bëhet kurthi në të cilin po bie ecja jonë.

Së katërti, jeta e qytetarit nuk duhet të përmirësohet për shkak se BE-ja thotë kështu, por për shkak të vetë qytetarit. Për shembull, sundimin e ligjit nuk ia kemi borxh BE-së, por vetes sonë. Nëse institucionet tona flasin gjithnjë e më shumë për integritet evropian, ndërkohë që jemi gjithnjë e më të varfër dhe gjithnjë e më të papunë, kjo e dëmton kuptimin e integriteteve evropiane dhe i bën institucionet jo përfaqësuese karshi qytetarëve dhe halleve të tyre.

Së pesti, Kosova nuk po e lidhë pavarësinë me sovranitetin dhe nuk po e konsideron shpalljen e pavarësisë si hap drejt sovranitetit, por drejt Bashkimit Evropian. Kjo është mënyra se si do të mbesim pa sovranitet, e rrjedhimisht edhe pa integritet evropian.

Për më tepër, ndërlidhja e këtillë e pavarësisë vetëm me integritet evropian, pra duke folur për kriteret e standardet e jashtme që vazhdimisht duhet t'i plotësojmë, bën që shpallja e pavarësisë në vend që të na i rritë të drejtat dhe para se të na i rritë të drejtat, na i shton veçse obligimet.

Së gjashti, Institucionet mund të zotohen e të kenë detyra për integritet evropian ndërkombëtar, por fjala e fundit i takon popullit të Kosovës dhe Kuvendi i Kosovës duhet ta thotë këtë. Atëherë kur do të jemi afër anëtarësimit, gjithsesi duhet të organizohet referendum gjithëpopullor. Kuvendi duhet ta kuptojë, ta pranojë dhe ta afirmojë këtë gjë.

Së shtati, formulimet e përdorura në këtë rezolutë nuk i përmendin fare shprehjet si barazi e drejtësi, gjuha është gjuhë e të një nënshtruari, e dobët dhe pa kurrfarë mendimi kritik, ndërkohë që dihet se pikërisht mendimi kritik paraqet vlerën themelore evropiane. Me këso rezolute, Bashkimit Evropian po i shpallet dashuri në një mënyrë aspak evropiane. Kjo nuk është rruga më e shkurtër për në Bashkimin Evropian. Përkundrazi, kjo është rruga më e gjatë për në Bashkimin Evropian.

Pa ridefinimin e pranisë së Bashkimit Evropian në Kosovë, nuk do të ndryshojë Kosova për t'u bërë anëtare e Bashkimit Evropian. Sepse duhet të ndryshojë BE-ja brenda Kosovës, në mënyrë që Kosova të mos mbetet jashtë BE-së. Pra, jo të vazhdohet me EULEX-in, meqë BE-ja duhet të na japë përkrahje për zhvillim të qëndrueshëm e jo për stabilitet afatshkurtër. Nga BE-ja kemi nevojë për përkrahje në ekonomi, bujqësi, arsim, shëndetësi e të tjera, e jo për më shumë policë, njësi speciale policore, prokurorë e gjykatës, të cilët duke pasur imunitet prej ligjit, sundojnë me ligjin në emër të sundimit të ligjit.

Njëkohësisht duhet të kërkohet edhe ndryshimi i politikës së BE-së karshi Kosovës e në raport me Serbinë. 22 nga 27 shtete të BE-së e kanë pranuar pavarësinë e Kosovës,

prandaj është e padrejtë që BE-ja në vend që të angazhohet që Serbia të mos e pengojë Kosovën në integrimet ndërkombëtare, po angazhohet që Kosova të mos e pengojë Serbinë si barrë legale dhe juridike në integrimet evropiane.

Të gjitha këto çështje që i ngrita janë aq themelore, sa që nevojitet jo vetëm një rezolutë tjetër, por edhe riorientim thelbësor i politikave qeveritare institucionale.

Për fund, përderisa i shpallim dashuri Evropës pa e respektuar veten, ajo as nuk do të na respektojë neve dhe as nuk do të na e kthejë dashurinë. Faleminderit!

KRYESUESI: Në emër të AAK-së, deputeti Ardian Gjini e ka fjalën!

ARDIAN GJINI: Faleminderit, zoti nënkryetar!

Personalisht mendoj se edhe sikur të mos ishte bërë hiq kjo rezolutë, kurrgjë s'ishte bërë. Krejt kot, Mirëpo, kemi vendosur ta mbështesim dhe po e mbështesim. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Në emër të Grupit Parlamentar, Koalicioni për Kosovën e Re, kush e do fjalën? Nuk ka të paraqitur! S'e do fjalën kurrkush. Grupi Parlamentar SLS, Sasha Milosavljeviq.

SAŠA MILOSAVLJEVIĆ: Hvala, gospodine predsjedavajući!

Parlamentarna Grupa SLS je aktivno učestvovala u izradi Rezolucije kroz Komisiju za evropske integracije i glasaćemo za usvajanje ove rezolucije.

KRYESUESI: Faleminderit! Në emër të Grupit Parlamentar "6+", Duda Balje!

DUDA BALJE: Parlamentarna grupa "6+", posle detaljnijeg razmatranja Rezolucije o angazhovanju Kosova u pravcu integracije u Evropsku zajednicu, u načelu podržava ovu rezoluciju i glasaće za nju. Hvala!

KRYESUESI: Faleminderit! Sipas radhës, deputetët e paraqitur. Është paraqitur deputetja Alma Lama.

ALMA LAMA: Faleminderit, i nderuar kryesues!

Të nderuar deputetë,

Miratimi i një rezolute, ku ky Kuvend në mënyrë afirmative shpreh vullnetin e popullit të Kosovës për integrime në Bashkimin Evropian, është më shumë se një akt formal. Është një akt që na obligon të punojmë dhe angazhohemi për detyrat të cilat i marrim mbi vete me synim për t'iu bashkëngjitur familjes së kombeve të Evropës së Bashkuar.

Qëllimi për të ndërtuar një shtet i cili bazohet në vlerat e lirisë, demokracisë, respektimit të të drejtave të njeriut, lirive themelore dhe sundimit të ligjit, siç thuhet në tekstin që e kemi përpara, është produkt i një vizioni të cilin askush nuk mund ta kundërshtojë.

Standardet e larta të cilat na i ka vendosur përpara BE-ja nuk janë gjë tjetër veçse rruga për të mbërritur tek shteti ligjor, i cili respekton vlerat që i përmendëm më sipër.

Ky Kuvend mund të marrë shumë zotime, mirëpo çështja është se sa do t'i përmbushë ato. Frika ime është se do të biem në kurthin e viteve të shkuara, kur Qeveria dhe Kuvendi i përjetonin integrimet si aventura futuristike e jo si një rrugë që duhet ta shkelësh pa u shmangur, sepse ajo nuk ka alternativë.

Në BE nuk ka alternativë tjetër veç se sundim të rendit dhe të ligjit, gjyqësor të pavarur, demokraci të institucioneve, transparencë maksimale të tyre, respektim të të drejtave të njeriut, kulturë të bashkëpunimit dhe të paqes me fqinjët, zhvillim ekonomik, por mbi bazën e një tregu të konkurrencës së lirë dhe të ndershme.

Ku është Kosova në lidhje me këto standarde? Shumë larg! Aq larg sa nuk ka asnjë arsye për ta gënjyer veten dhe, për më tepër, ata që na kanë zgjedhur. Kosova vazhdon të vuaj nga një qeverisje e papërgjegjshme, e cila armikun më të madh e ka transparencën. Mahninë më të madhe e ka pasurimin e qeveritarëve, ambicien më të madhe e ka asfaltin, ky për shkak të pasurimit, dhe brengën më të madhe e ka si të ruaj karrikën.

Për të gjitha këto, nuk zgjedh mjete, por meqë jemi te integrimet, retorika pro tyre dhe të vepruarit në kundërshtim me vizionin e BE-së është një nga taktikat më të shpeshta.

Me këtë dua të them se miratimi i një rezolute në Kuvend pro integriteteve në BE nuk është ndonjë gjë e madhe. Ajo që ky Kuvend duhet të bëjë, është të vejë para përgjegjësisë ekzekutivin, i cili nuk ka për detyrë vetëm të na sjellë ligje, shpesh të tipit copy-paste, por të kujdeset që ato të implementohen.

Nga ana tjetër, edhe BE duhet të tregojë përkushtimin e saj ndaj Kosovës, në radhë të parë duke e konsideruar atë si një shtet të barabartë me të tjerët dhe duke ia njohur qytetarëve të këtij vendi vuajtjen dhe ferrin nëpër të cilin kaluan vite më parë. Diskriminimi për sa i përket lëvizjes pa viza, ndërkohë që shteteve fqinje të cilat janë shkaktarë të vuajtjeve në rajon, iu mundësua edhe pse ende i kanë të lirë kriminelët e luftës, është një nga pikat më negative për sa i përket raporteve të Kosovës me BE-në, pikë e cila duhet korrigjuar sa më parë dhe kjo duhet të kërkohej me forcë edhe në këtë rezolutë dhe nuk e kuptoj pse nuk është në tekstin të cilin e kemi përpara, pasi që kjo gjë ka qenë e propozuar edhe në Komisionin për integritete.

Nga ana tjetër, misioni i BE-së EULEX-i vazhdon të ketë një performancë të dobët për sa i përket sundimit të ligjit në të gjithë Kosovën, ose në gjithë territorin, por veçanërisht në veri po ballafaqohet me dështimin. Ne si Kuvend, as në këtë rast nuk duhet të rrimë thjeshtë si spektatorë.

Procesi i tretë jo i leverdishëm për ne, në të cilin është pikërisht BE që na e ka futur, është ai i bisedimeve me Serbinë, të cilat bëhen vetëm për përmbushjen e agjendës evropiane të shteteve të tjera dhe jo të vetë Kosovës. Bisedimet e tilla, ashtu sikur se i patëm paralajmëruar në fillim, po rezultojnë me ide të rrezikshme. Pra, institucionet e Kosovës nuk duhet ta shohin BE-në si një kull të fildishtë, me synimin e vetëm për të shkuar aty, por si një partner me të cilin duhet të ndërtojnë marrëdhënie reciproke dhe kontraktuale.

Në fund, dua të them se Kosova duhet të fillojë ta shohë veten edhe në dritën e integritetit e të bashkimit me Shqipërinë, pa ndonjë frikë apo paranojë pasi bashkimi e integrimi janë pikërisht vizioni i 27 kombeve të ndryshme të BE-së që sot janë bashkë. Ndërsa, Shqipëria dhe Kosova janë në avantazh në lidhje me këto filozofi, pasi bëhet fjalë për një komb të vetëm. Nëse mund të përdorim një krahasim, ato janë dy pjesë të një treni të cilët janë nisur drejt të njëjtit destinacion. Bashkimi i tyre përgjatë rrugës do të ishte më i logjikshmi dhe më i leverdishmi, mirëpo kjo gjë kërkon vizion të qartë, përkushtim të vazhdueshëm dhe mbi të gjitha vullnet politik, të cilat ne si Lëvizje “Vetëvendosje” e kemi. Faleminderit!

KRYESUESI: Deputeti Zenun Pajaziti e ka fjalën! Faleminderit, deputete Lama!

ZENUN PAJAZITI: Faleminderit, zoti kryesues!

Po pretendoj që të merrem kryesisht me tekstin e Rezolutës, normal që jam në frymën e aprovimit, siç u deklarua nga ana e grupit parlamentar. Sigurisht, së shpejti ne do ta kemi... jemi ofruar në raportin e radhës të progresit, do të kemi debate në këtë Kuvend, do të shohim edhe raste të veçanta, ku shtete të veçanta sigurisht do të nxirren edhe praktika nga shtetet e regjionit, ku agjenda e integriteteve evropiane ose shtetet të cilat kanë aderuar në BE dukshëm esencialisht kanë ndërruar jetën e qytetarëve të tyre dhe po ashtu kanë ndryshuar rangun e tyre në listën e shteteve me zhvillim ekonomik.

Më lejoni të përqendrohem në tekstin e Rezolutës, në pikën 6, ku thuhet se konsiderohet prioritet kryesor përmbushja e kërkesave për procesin e liberalizimit të vizave. Mendoj se kjo do të jetë krejtësisht e veçantë pa i përfshirë çështjet tjera që kanë të bëjnë me forcimin e sundimit të ligjit, legjislacionin... adaptimin e legjislacionit tonë me Acqi-në, pastaj edhe me reformimin e administratës publike e tjera. Të gjitha këto janë pjesë e kriterëve të BE-së dhe po ashtu janë të përfshira në një mënyrë a një tjetër në pika tjera.

Mendoj që liberalizimi i vizave, duke qenë se po ashtu nuk është, edhe pse konsiderohet si pjesë e procesit të integriteteve evropiane, është një proces paralel, mendoj se duhet ta trajtojmë si të tillë dhe po ashtu ta inkurajojmë Qeverinë që të mbajë një agjendë të veçantë për procesin e liberalizimit të vizave dhe po ashtu deri sa të mos e marrim udhërrëfyesin për procesin e liberalizimit të vizave ose një dokument si do ta quajë BE, ne duhet njëanshëm të punojmë në përmbushjen e kriterëve për liberalizimin e vizave, edhe pse disa prej kriterëve janë të njëjta me ato të integriteteve evropiane. Pra, dëshiroj që edhe në tekstin e Rezolutës ta mbajmë si pikë krejtësisht të veçantë mbështetjen në procesin e liberalizimit të vizave. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Po, zoti Lutfi Haziri e ka fjalën!

LUTFI HAZIRI: Atëherë, më lejoni që në emër të komisionit për aq sa mund të flas, meqë janë këtu kolegët deputetë, kanë punuar të gjithë. Rezoluta në emër të legjislaturës IV të Kuvendit të Republikës së Kosovës rikonfirmon angazhimet. Për dallim nga e kaluara e afërt, këtu është thënë dhe duhet të veprohet, duhet ne ta ushtrojmë detyrën tonë, rolin tonë në realizimin e detyrave që ka Kuvendi, detyrave që kanë institucionet që

i ka themeluar Kuvendi, të rritë kapacitetet monitoruese në ministri, jo vetëm duke ftuar ministrat në raportim dhe dëgjim, por duke iu shkuar ministrave në zyre dhe duke i parë realisht cili është realizimi dhe reagimi i tyre në raport me kërkesën e Kuvendit.

Unë pajtohem me disa nga rekomandimet që u thanë këtu, që u saktësuan këtu, sepse logjika, kërkesa është e njëjtë. Natyrisht, edhe vetë zoti Kurti e përmendi që kërkesat e tij dhe qëndrimi i tij sa i përket Rezolutës implikon ndryshime të tërësishme politike, sistemore dhe natyrisht është kërkesë e cila kuptohet, nëse e shohim nga ky kënd, nëse e shohim si deputetë, tash nëse më lejohet rasti të them, ajo që është problem, nëse pyetëm unë tash: ku është Kosova në raport me BE-në, unë mund të them lirisht që askund. Po, nëse e pyesim anën e kundërt, realisht ne duhet t'i realizojmë detyrat tona, pjesën e angazhimeve tona, edhe njëanshëm në shumicën e rasteve, në mënyrë që të krijohet ambienti, sepse ne jemi rast i veçantë, kemi terminologji të veçantë, kemi mekanizëm të veçantë, kemi detyra të veçanta dhe kemi kërkesa të veçanta. Ky fakt nuk buron sot. Ky fakt trashëgohet dhe është pjesë e angazhimeve tona.

Ajo që duhet t'i bindim qytetarët tanë është që, jo që është kullë e fildishtë, po Brukseli nuk është spital për shtete të sëmura. Shtetet e sëmura që kanë pasur aspirata më herët dhe që kanë përfituar, janë integruar dhe po vazhdojnë të shërohen nga brenda, ndërsa me zgjerim po rriten kërkesat që nuk po pranohet në asnjë mënyrë që t'i bashkohen familjes evropiane të gjitha ato që quhen shtete të sëmura, por Kosova këtë rast duhet të shëndoshet, duhet të jetë e shëndetshme dhe e shëndoshë, në mënyrë që kërkesën legjitime ta detyrojë ta çojë sipas kërkesës, sepse fundja është aspiratë e gjithë neve, po aspirata nuk domethënë që është e pranueshme për palën tjetër. Mirëpo, unë besoj shumë që kjo agjendë nëse këtë vit rritet në dinamikë dhe kërkohet një monitorim më i madh, ushtrohet një monitorim më i madh, do të realizohen shumë detyra që do të rezultojnë pozitivisht. Nën dy, pse Kuvendi do t'i adresojë një rezolutë? Sepse Parlamenti evropian e njeh pavarësinë e Kosovës. Deputetët e qytetarët evropianë të shteteve të caktuara kanë votuar dhe e kanë pranuar pavarësinë e Kosovës, ashtu siç është kërkuar nga ne. Komisioni Evropian ka status neutral. Institucionet tjera kanë qëndrim tjetër. 5 shtete nuk e kanë pranuar, kanë thënë që s'e pranojmë në këtë fazë, kemi arsye politike, dhe shumë çështje tjera. Por, Parlamenti Evropian, si përfaqësues i popullit të shteteve dhe kombeve evropiane, e ka pranuar. Atëherë, rikonfirmimi ynë shkon edhe në relevancë me Parlamentin Evropian dhe me delegatë, me deputetët e popujve që kanë votuar me shumicë dhe e kanë bindur këtë institucion për të na pranuar ne. Atëherë, ne jemi Kuvendi i Kosovës dhe duhet të sillemi në mënyrë kolegjiale me kolegët tanë, të cilët janë të gatshëm për të punuar dhe shtyrë agjendën për interes të Kosovës, qoftë ai në raport me shtetin e vet ose në raport me Komisionin Evropian, si institucion i përbashkët i shteteve që janë anëtare atje.

Hapja e një zyre teknike atje, e cila do ta ndihmonte këtë agjendë në Bruksel, është teknike, nuk është politike, por agjenda jonë politike shkon atje duke mos harxhuar kohë ne për t'u bartur. Personeli atje do ta ndihmonte që agjendën tonë ta shtyjë te delegacionet, te grupet politike.

Ajo që ne kemi parë në Bruksel, asnjëra prej grupeve tona politike nuk ka marrëdhënie të plota kolegjiale politike me grupet politike në Parlament Evropian.

Unë i përkas LDK-së, e cila është anëtare vëzhguese e partive popullore evropiane. Ne duhet ta rrisim dinamikën tonë të kontakteve. Partitë tjera, sipas përcaktimit të ideologjisë i kanë grupet e veta. Ne nuk kemi ndërtuar raporte të tilla ku ndikojmë në grupe politike atje.

Nën dy, ajo që është vërejtur, shihet nga Brukseli që në Kosovë ka deklarim për BE-në, nuk ka angazhim. Ky është problemi kryesor. Nëse arrijmë ne ta thyejmë bindjen dhe të shohim veprimin konkret, atëherë besoj se do të arrijmë ta shtyjmë këtë proces mjaft dukshëm, mjaft mirë dhe në interes të njerëzve të Kosovës. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Nuk ka tjerë të paraqitur!

Të nderuar deputetë, në vazhdim kërkohet deklarimi me votim për miratimin e Rezolutës për angazhimin e Kosovës drejt integritit në Bashkimin Evropian.

Në mbledhje janë 83 deputetë prezentë. Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim dhe votojmë tani, kuptohet, me plotësimet, veçanërisht ato të zotit Hamiti që i bëri. Faleminderit!

Konstatohet që me 73 vota “për”, 7 “abstenime”, 1 “kundër”, Kuvendi miratoi Rezolutën për angazhimin e Kosovës drejt integritit në Bashkimin Evropian.

Faleminderit! Mirupafshim në seancën e ardhshme!

Përgatiti:

Njësia e Transkripteve